



**PROFILIZIMI
I PERSONAVE TË ZHVENDOSUR
BRENDA VENDIT NË KOSOVË**

Shqyrtimi i kahjes për zgjidhje të qëndrueshme për PZHBV-të në Kosovë

Janar 2018

Shtypur nga UNHCR.

Financuar nga Ministria e Kosovës për Komunitete dhe Kthim (MKK), bashkë-financuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR) dhe Këshilli Danez për Refugjatët (Danish Refugee Council). Shërbimi i Përbashkët për Profilizim të PZHBV (Joint IDP Profiling Service) ka mbështetur plotësisht procesin anketues.

Të dhënat janë mbledhur në nëntor 2016.

Raporti është përgatitur në shtator 2017.

Grupi menaxhues i profilizimit është përbërë nga: Këshilli Danez për Refugjatët (DRC), Agjencia e Kosovës për Statistika (AKS), Ministria e Kosovës për Komunitete dhe Kthim (MKK), Komesariati i Serbisë për Refugjatët dhe Migrimin (KSRM), Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për Refugjatët (UNHCR)

PROFILIZIMI I PERSONAVE TË ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT NË KOSOVË

**Shqyrtimi i kahjes për zgjidhje të qëndrueshme për PZHBV-të në
Kosovë**

Janar 2018

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

Lista e ankronimeve dhe shkurtesave 7

HYRJE 8

KONTEKSTI I ZHVENDOSJES DHE ARSYET PËR NJË PROFILIZIM 8

MENAXHIMI I PROFILIZIMIT DHE HAPAT PËRGATITOR 9

METODOLOGJIA 10

POPULLSIA E SYNUAR 10

METODAT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE 11

Anketa e ekonomive familjare

Diskutimet në fokus grupe

Kufizimet

TË GJETURAT MBI PZHBV-të SHQIPTARË 14

TË GJETURAT KRYESORE 14

PËRSHKRIMI I MOSTRËS 15

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES 16

Të dhënat themelore të popullsisë

Nivelet e shkrim-leximit dhe arsimimit

Modeli i zhvendosjes

STANDARDI I JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION 18

Kushtet e banimit

Qasja në arsim

Qasja në kujdesin shëndetësor

Dokumentacioni personal

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET 20

Qasja në punësim

Aranzhimet e punësimit dhe sektori

Kush janë të papunësuarit?

GJENDJA EKONOMIKE 23

Burimet e të ardhurave

Shpenzimet

Faktorët e mirëqenies ekonomike të ekonomisë familjare

Strategjitë e përbaljes ekonomike

QASJA NË MEKANIZMAT PËR KTHIMIN E BANESËS, TOKËS DHE PRONËS 27

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës

Qasja në pasuri

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT 29

Hyrje

Zgjidhja e qëndrueshme pavarësisht kushteve

Konsiderata për të qëndruar apo kthyer nën kushte të caktuara

Plane konkrete për zhvendosje

GJETJET PËR PZHBV-të ROM/ASHKALI/EGJIPTIAN 34

TË GJETURAT KRYESORE 34

PËRSHKRIMI I MOSTRËS 35

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES 36

Të dhënat themelore të popullsisë

Nivelet e shkrim-leximit dhe arsimimit

Modeli i zhvendosjes

STANDARDI I JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION 38

Kushtet e banimit

Qasja në arsim

Qasja në kujdesin shëndetësor

Dokumentacioni personal

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET 41

Qasja në punësim

Aranzhimet e punësimit dhe sektori

Kush janë të papunësuarit?

GJENDJA EKONOMIKE 43

Burimet e të ardhurave

Shpenzimet

Faktorët e mirëqenies ekonomike të ekonomisë familjare

Strategjitë e përbaljes ekonomike

QASJA NË MEKANIZMAT PËR KTHIMIN E BANESËS, TOKËS DHE PRONËS 45

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës
Qasja në pasuri

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT 46

Hyrje
Zgjidhja e qëndrueshme pavarësisht kushteve
Konsiderata për të qëndruar apo kthyer nën kushte të caktuara
Plane konkrete për zhvendosje

GJETJET MBI PZHBV-të SERB 48

TË GJETURAT KRYESORE 48

PËRSHKRIMI I MOSTRËS 49

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES 50

Të dhënat themelore të popullsisë
Nivelet e shkrim-leximit dhe arsimimit
Modeli i zhvendosjes

STANDARDI I JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION 53

Kushtet e banimit
Qasja në arsim
Qasja në kujdesin shëndetësor
Dokumentacioni personal

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET 55

Qasja në punësim
Aranzhimet e punësimit dhe sektori
Kush janë të papunësuarit?

GJENDJA EKONOMIKE 59

Burimet e të ardhurave
Shpenzimet
Faktorët e mirëqenies ekonomike të ekonomisë familjare
Strategjitë e përbaljes ekonomike

QASJA NË MEKANIZMAT PËR KTHIMIN E BANESËS, TOKËS DHE PRONËS 63

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës
Qasja në pasuri

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT 64

Hyrje
Zgjidhja e qëndrueshme pavarësisht kushteve
Konsiderata për të qëndruar apo kthyer nën kushte të caktuara
Plane konkrete për zhvendosje

KONKLUZIONET 68

KTHIMI OSE INTEGRIMI LOKAL - VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZGJIDHJEVE TË PREFERUARA 68

TË QËNDRUESHME DHE SFIDAVE

VEÇORITË SPECIFIKE DHE DOBËSITË E POPULLATËS SË ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT 74

Arsimi
Të hyrat
Kushtet e jetesës
Qasja në pronë në vendin e origjinës

REKOMANDIMET 80

LISTA E SHTOJCAVE 83

Lista e shtojcave
Shtojca 1 - Pyetësori i anketës
Shtojca 2 - Përmbledhja e të dhënave
Shtojca 3 - Modeli i zhvendosjes
Shtojca 4 - Tabela shtesë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Situata me të cilën përballen individët që u larguan nga vendbanimi i tyre i përhershëm në Kosovë si rezultat i ngjarjeve që ndodhën në vitet 1998-1999 dhe në vitin 2004 është një zhvendosje e tejzgjatur. Aktorët përkatës nga institucionet dhe nga bashkësia ndërkombëtare, kanë pranuar për të ndërmarrë hapa për të përkrahur arritjen e zgjidhjes së qëndrueshme të preferuar nga personat e zhvendosur brenda Kosovës.

Mbështetur në këtë, mostra e bazuar në anketim të profilizimit është bërë në vitin 2016 nën drejtimin e një organi udhëheqës të përbërë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim e Kosovës, Komisariati për Refugjatë dhe Migrim i Republikës së Serbisë, UNHCR dhe Këshilli Danez për Refugjatë (Grupi për Menaxhimin e Profilizimit). Mbështetje e mëtejshme është ofruar nga Shërbimi i Përbashkët për Profilizim të PZHBV (JIPS), si dhe një numër i bartësve aktiv në Kosovë që kontribuan me këshilla të ekspertëve (Grupi Punues për Profilizim).

Profilizimi është rezultat i një procesi tërësisht konsultativ i filluar në vitin 2013 dhe i cili synoi t'iu ofrojë vendimmarrësve një analizë të bazuar në evidencë të gjendjes së zhvendosjes sipas Kornizës së IASC për Zgjidhjet e Qëndrueshme. Kriteret e Kornizës së IASC janë konsideruar në zhvillimin e një ankete të përbërë nga pyetësorë në nivel të ekonomive familjare dhe individë, si dhe në diskutimet e fokus grupeve.

Një nga arritjet e procesit ishte krijimi i vlerësimit bazë të numrit të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV) në Kosovë, të cilat u miratuan nga Grupi për Menaxhimin e Profilizimit (grupet e popullsisë të paraqitura sipas rendit alfabetik):

- ▶ **Shqiptarët: 1,167 ekonomi familjare ose 5,879 individë**
- ▶ **Romët / ashkalinjtë / egjiptianët: 137 ekonomi familjare ose 638 individë**
- ▶ **Serbët: 3,872 ekonomi familjare ose 16,383 persona që banojnë në banesa private dhe 140 ekonomi familjare që banojnë në qendrat kolektive**

Metodat standarde u zbatuan nga JIPS për të arritur mostra komplete sistematike për të tri grupet e popullsisë, gjë që çoi në **1,327 ekonomi familjare** ose **4,932 individë** të përfshirë në anketimin e profilizimit. Janë mbledhur të dhëna për karakteristikat kryesore demografike dhe socio-ekonomike të popullsisë së anketuar, për qasjen e tyre në të drejtat dhe shërbimet, si dhe preferencat e tyre për vendbanimin e tyre të përhershëm dhe sfidat me të cilat ndeshen në arritjen e zgjidhjes së tyre të qëndrueshme.

Të dhënat e mbledhura nxjerrin në pah modelet e mëposhtme të zhvendosjes:

- ▶ PZHBV-të shqiptarë u zhvendosën kryesisht nga Mitrovica e Veriut (78%). Për shumicën (93%), zhvendosja fillestare u bë në vitin 1999, gjë që rezultoi me pothuajse një të pestën e popullsisë, e cila ka lindur në zhvendosje.
- ▶ PZHBV-të rom/ashkali/egjiptianë u zhvendosën kryesisht nga rajoni i Mitrovicës dhe nga Prishtina (57% e kombinuar). Për shumicën (94%), zhvendosja fillestare u bë në vitin 1999, gjë që rezultoi në mbi 30% të popullsisë, e cila ka lindur në zhvendosje.
- ▶ PZHBV-të serbë janë zhvendosur nga vende të ndryshme në Kosovë (në jug të lumit Ibër). Për shumicën (88% e atyre që banojnë në strehim privat dhe 92% të atyre që banojnë në qendrat kolektive), zhvendosja fillestare ndodhi në vitin 1999, gjë që rezultoi në 15% të popullatës në banesa private dhe 9% në qendrat kolektive, të lindur në zhvendosje.

Të dhënat e mbledhura gjithashtu tregojnë më poshtë tendencat lidhur me lokacionin e preferuar të qëndrimit të ardhshëm:

- ▶ Shumica e PBZHV shqiptarë (62%) preferojnë të kthehen në vendin e origjinës, përderisa integrimi lokal preferohet nga 22% e ekonomive familjare të anketuara. Përqindjet e ekonomive familjare që do të konsideronin kthimin dhe integrimin lokal nën kushte të caktuara janë 66% dhe 58%, respektivisht.
- ▶ Shumica dërmuese e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë (80%) preferojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes, ndërsa kthimi në vendin e origjinës preferohet te nën 5% të ekonomive familjare të anketuara. Përqindjet e ekonomive familjare që do të konsideronin kthimin dhe integrimin lokal nën kushte të caktuara, janë 76% dhe 4%, respektivisht.
- ▶ Shumica dërmuese e PZHBV serbë (93% e atyre në banesa private dhe 83% e atyre në qendra kolektive) preferojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes, ndërsa kthimi në vendin e origjinës preferohet nga 1,4% dhe 1,5% të ekonomive familjare të anketuara në grupet përkatëse. Përqindjet e ekonomive familjare që do të konsideronin integrimin lokal nën kushte të caktuara janë 83% dhe 91%; respektivisht; përqindjet e ekonomive familjare që do të konsideronin kthimin në kushte të caktuara janë 6% dhe nën 3%, respektivisht.

Sa i përket kushteve të radhitura sipas popullsisë të anketuara, si të favorshme për ta, për të marrë parasysh kthimin ose integrimin lokal, mbështetja për strehim është treguar si forma kryesore e asistencës e nevojshme për ekonomitë familjare që dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës dhe për ata që dëshirojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes. Llojet e mbështetjes së nevojshme janë të ndryshme, që nga riparimet deri në ndërtimin e plotë të banesave dhe alokimin e tokës.

Së fundi, gjetjet tregojnë se si përballet popullata e anketuar me sfidat e lidhura me zhvendosjen, megjithëse në aspekte disi të ndryshme dhe/ose në nivele të ndryshme, të cilat deri tani i kanë penguar ata të arrijnë një zgjidhje të qëndrueshme.

- ▶ Në përgjithësi, shkalla e ndjekjes së shkollimit është më e ulët se ajo e raportuar për popullsinë e përgjithshme të Kosovës dhe gratë kanë qasje më të ulët në arsim kundrejt meshkujve. Vështirësi veçanërisht të mëdha lidhur me arsimin vërehen në mesin e popullatës rom/ashkali/egjiptiane, me një normë analfabetizmi prej 18%, një përqindje shumë e madhe e individëve që nuk kanë përfunduar arsimim formal (41% e meshkujve dhe 54% e grave) që arrin 75 % në mesin e popullsisë së moshës 60 vjeç e lart, dhe shkallë më të ulët të ndjekjes së shkollimit se sa ato të raportuara nga grupet e tjera të anketuara.
- ▶ Një pjesë e ekonomive familjare në secilin grup të anketuar u gjetën të qëndronin në kushte jo adekuate, pra strehim të përkohshëm, vendbanime joformale ose qendra kolektive (12% në mesin e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptiane dhe të gjithë serbët në qendrat kolektive) dhe janë vërejtur norma të ulëta të pronësisë në krahasim me ato për popullsinë e përgjithshme të Kosovës (56% në mesin e PZHBV shqiptarë, 39% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 33% në mesin e PZHBV serbë në vendbanim privat dhe 0% në mesin e PZHBV serbë në qendrat kolektive). Veçanërisht u vunë re kushtet e vështira për banim për një numër të banesave që nuk ishin të lidhura me sistemin e kanalizimit (17% në mesin e PZHBV shqiptarë, 34% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 27% në mesin e PZHBV serbë në qendrat kolektive) ose që nuk kishin ujë të pijshëm (12% në mesin e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian dhe 27% në mesin e PZHBV-ve serbë në qendrat kolektive).
- ▶ Një pjesë e ekonomive familjare në secilën nga grupet e anketuara raportuan se kanë vështirësi për të pasur qasje në kujdesin shëndetësor kur kanë nevojë (7% në mesin e PZHBV shqiptarë, 17% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 12% në mesin e PZHBV serbë në strehim privat dhe 42% në mesin e PZHBV serbë në qendrat kolektive).
- ▶ Situata ekonomike e popullsisë së anketuar është mjaft e pasigurt, me një pjesë të konsiderueshme të ekonomive familjare që mbështeten kryesisht tek përfitimet sociale si burim i të ardhurave (8% në mesin e PZHBV shqiptarë, 67% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 13% në mesin e PZHBV serbë në vendbanime private dhe 27% PZHBV serbë në qendrat kolektive), dhe nuk përfshinte asnjë person të punësuar në mesin e anëtarëve të tyre (40% në mesin e PZHBV-ve shqiptarë, 80% në mesin e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian, 40% personat e zhvendosur në qendrat kolektive), me shkallë të lartë të papunësisë (41% në mesin e PZHBV shqiptarë, 84% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 43% në mesin e PZHBV serbë në vendbanime private dhe 62% në mesin e PZHBV serbë në qendra kolektive) dhe në përmasa substanciale të punësuarit që fitojnë më pak se 300 euro në muaj (50% në mesin e PZHBV shqiptarë, 100% në mesin e PZHBV rom/ashkali/egjiptianë, 66% në mesin e PZHBV serbë në vendbanime private dhe 82% në mesin e PZHBV serbë në qendrat kolektive).
- ▶ Në total, 928 ekonomi familjare treguan se posedojnë një ose më shumë prona në vendin e origjinës, dhe u vërejtën sfida në qasjen e tyre, me 530 prona të raportuara si të uzurpuara dhe 801 si të dëmtuara ose të shkatërruara. Nga ky numër i ekonomive familjare, një numër i vogël raportuan se kishin rifituar qasjen në pronën e tyre pas paraqitjes së kërkesës për ripozitim (11% në mesin e PZHBV shqiptarë dhe 4% në mesin e PZHBV serbë në vendbanim privat).

LISTA E AKRONIMEVE DHE SHKURTESAVE

ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BP	Banim Privat
DFG	Diskutimi i Fokus Grupit
DRC	Këshilli Danez për Refugjatë
EF	Ekonomitë Familjare
GMP	Grupi për Menaxhimin e Profilizimit
GPP	Grupi Punues i Profilizimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
JIPS	Shërbimi i përbashkët i profilizimit të PZHBV
KB	Kombet e Bashkuara
KIRS	Komesariati për Refugjatë dhe Migrim i Republikës së Serbisë
Korniza e IASC	Komiteti i Përhershëm Ndër-Institucional i Kombeve të Bashkuara, Korniza për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PZHBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
QK	Qendrat Kolektive
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi
UNHCR	Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

HYRJE

KONTEKSTI I ZHVENDOSJES DHE ARSYET PËR NJË PROFILIZIM

Popullatat që janë zhvendosur me forcë si pasojë e ngjarjeve që kanë ndodhur në mes të viteve 1998-1999 dhe në vitin 2004 në Kosovë, janë duke u përballur me një situatë të tejzgatur të zhvendosjes. Sigurimi i zgjidhjeve të qëndrueshme ka qenë një shqetësim kryesor për autoritetet dhe bartësit ndërkombëtar të detyrave. Deri më tani fokusi kryesisht ka qenë tek të kthyerit (në Kosovë dhe brenda saj), ndërsa më pak fokus ka pasur në zgjidhjet e tjera. Aprovimi i një qasjeje më gjithëpërfshirëse për trajtimin e zhvendosjes do të fuqizonte kapacitetet politikë-bërëse. Për këtë qëllim, një kontribut kyç do të mund të jepet përmes të kuptuarit më të mirë të situatës së zhvendosjes së brendshme, si në aspektin e vlerësimit të masës në të cilën janë arritur zgjidhje të qëndrueshme ashtu edhe të marrjes parasysh të qëllimeve të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit (PZHBV-të) në ndjekjen e zgjidhjes së tyre të preferuar e të qëndrueshme.

Zhvendosja brenda Kosovës është bërë kryesisht sipas modelit në vijim (grupet e popullsisë janë paraqitur sipas rendit alfabetik):

- ▶ Shqiptarët kanë lëvizur nga katër komunitat veriore, e Leposaviqit, Mitrovica e veriut, Zubin Potoku dhe Zveçan, kryesisht në jug të Mitrovicës dhe në Prishtinë;
- ▶ Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian¹ lëvizën nga zona të ndryshme për në lagjet me shumicë të komuniteteve rom/ashkali/egjiptian;
- ▶ Serbët lëvizën nga zona të ndryshme për në a) katër komunitat veriore, përkatësisht në Leposaviq, Mitrovicën e veriut, Zubin Potok dhe Zveçan, apo b) komunitat tjera me shumicë serbe, si Graçanica dhe Shtërpca.

¹ Përderisa romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët janë përkatësi etnike të veçanta, ata kanë shumë gjëra të ngjashme sa i përket karakteristikave kulturore, si dhe sfidave me të cilat janë duke u përballur. Në bazë të kësaj, ata zakonisht konsiderohen si një grup nga akterët kosovarë dhe ndërkombëtar për qëllime të politikë-bërjes. Për këtë arsye, Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptianë konsiderohen si një grup i vetëm i anketuar në këtë profilizim.

Marrja e informacioneve mbi sfidat specifike me të cilat përballen grupet e ndryshme të PZHBV në Kosovë është dakorduar si një prioritet nga autoritetet, agjencitë e OKB-së dhe OJQ-të. Në veçanti, Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 e hartuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) në Kosovë rekomandon, ndër të tjera: i. realizimin e një ankete të personave të zhvendosur në Kosovë, dhe ii. hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për zgjidhje të qëndrueshme. Përveç kësaj, Plani i Veprimit i Strategjisë parasheh hartimin e një kornize ligjore mbi zhvendosjen brenda vendit.

Profilizimi i popullsisë së zhvendosur në Kosovë është iniciuar për të informuar për punën në politikën për zgjidhje të qëndrueshme, duke përfshirë strategjinë e zgjidhjeve të qëndrueshme të përmendur më lart të planifikuar nga MKK-ja, përmes ofrimit të një analize të bazuar në dëshmi të situatës së zhvendosjes, sipas Kornizës së IASC për Zgjidhje të Qëndrueshme për PZHBV-të².

Korniza e IASC identifikon parimet kryesore që duhet të udhëheqin kërkimin për zgjidhje të qëndrueshme dhe përcakton që "një zgjidhje e qëndrueshme arrihet kur PZHBV-të nuk kanë më nevoja specifike për asistencë dhe mbrojtje që ndërlidhen me zhvendosjen e tyre dhe personat e tillë mund t'i gëzojnë të drejtat e njeriut pa diskriminim që rezultojnë nga zhvendosja e tyre". Më tutje, ajo përkrah tri rrugët për zgjidhje të qëndrueshme - riintegrimi i qëndrueshëm, riintegrimi lokal apo integrimi në ndonjë pjesë tjetër të vendit³.

² Komiteti i Përhershëm Ndër-Institucional i Kombeve të Bashkuara, Korniza për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur Brenda Vendit, 2010 (në dispozicion në <https://interagencystandingcommittee.org/other/documents-public/iasc-framework-durable-solutions-internally-displaced-persons>).

³ Për arsye të këtij raporti, kurdo që i referohemi Kornizës së IASC, fjala "shtet" duhet të interpretohet ashtu që i referohet Kosovës. Framework is made, the term "country" must be interpreted as referring to Kosovo.

Sipas Kornizës së IASC, vetëm lëvizja fizike në vetvete nuk përbën zgjidhje të qëndrueshme dhe mund të përdoren një numër i kriterëve "për të përcaktuar masën në të cilën është arritur një zgjidhje e qëndrueshme"⁴. Këto përfshijnë: sigurinë afatgjatë dhe lirinë e lëvizjes; standardi adekuat i jetesës, duke përfshirë në minimum qasjen në ushqim, ujë, kujdes shëndetësor adekuat dhe arsimim themelor; qasje në punësim dhe kushtet e jetesës; dhe qasje në vendbanim adekuat, të tokës dhe mekanizmave të kthimit të pronës. Për referencë më të lehtë, në gjithë raportin, shënimet nga Korniza IASC janë vendosur në kuti për të prezentuar pjesë me tematika të ndryshme.

Duke pasur parasysh këtë, objektivat e dakorduar të këtij veprimi të profilizimit kanë për qëllim:

- ▶ **Krijimin e një profili demografik të bazuar në mostër, të popullsisë së zhvendosur brenda Kosovës, të ndarë sipas moshës, gjinisë, lokacionit dhe diversitetit.**
- ▶ **Realizimin e një analize gjithëpërfshirëse të situatës së zhvendosjes sa i përket integritetit social dhe ekonomik të personave të zhvendosur; sfidave dhe cenueshmërive të ndërlidhura me zhvendosjen; resurset dhe kapacitetet; gëzimin e të drejtave dhe qasjes në shërbimet; si dhe qëllimet dhe planet në të ardhmen.**
- ▶ **Përmirësimin e aftësisë së institucioneve për avokimin dhe dizajnimin e programimit të përbashkët për mbështetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për PZHBV-të nëpërmjet identifikimit të cenueshmërive të tyre specifike dhe koordinimit të përmirësuar të analizave humanitare dhe zhvillimore.**

⁴ Në nivel global, procesi ndër-institucional është në zbatim e sipër për të operacionalizuar Kornizën për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur Brenda Vendit 2010 të IASC duke zhvilluar një grup të treguesve që mund të përdoren për të matur progresin drejt zgjidhjeve të qëndrueshme për PZHBV-të. Korniza përcakton kriteret e njohura gjerësisht që mund të përdoren "për të përcaktuar masën në të cilën një zgjidhje e qëndrueshme është arritur". Nën udhëzimin e Raportuesit Special për të Drejtat Njerëzore të PZHBV-ve dhe në bashkëpunim me një grup të gjerë të akterëve zhvillimor, humanitar dhe për ndërtimin e paqes dhe Joint IDP Profiling Service, projekti ka për qëllim të zhvillojë mjete për qasje gjithëpërfshirëse por praktike për analizimin e zgjidhjeve të qëndrueshme në situatat e zhvendosjes.

MENAXHIMI I PROFILIZIMIT DHE HAPAT PËRGATITOR

Diskutimet mbi nevojën për një profilizim të situatës së zhvendosjes brenda vendit në Kosovë janë iniciuar në vitin 2013 nga UNHCR, DRC dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim e Kosovës. Përgjatë zhvillimit të diskutimeve, u krijuan dy organe për të drejtuar dhe udhëhequr procesin: Grupi për Menaxhimin e Profilizimit për mbikëqyrjen e tërë ushtrimit, me përgjegjësi specifike të menaxhimit gjatë procesit, dhe Grupi Punues për Profilizim që ofron kontribut dhe ekspertizë.

Grupi për Menaxhimin e Profilizimit (GMP) i përbërë nga (sipas rendit alfabetik):

- ▶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
- ▶ Këshilli Danez për Refugjatë (DRC)
- ▶ Komesariati për Refugjatë dhe Migrim i Republikës së Serbisë (KIRS)
- ▶ Ministria për Komunitete dhe Kthim në Kosovë (MKK)
- ▶ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)

Grupi Punues për Profilizim (GPP) përveç anëtarëve të GMP, ka në përbërje edhe organizatat dhe agjencitë në vijim me të cilat punon apo kanë përgjegjësi në lidhje me PZHBV-të (sipas rendit alfabetik):

- ▶ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF)
- ▶ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA)
- ▶ Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM)
- ▶ Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Misioni në Kosovë (OSCE)
- ▶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP)

Joint IDP Profiling Service (JIPS) mbështeti ushtrimin në tërësi, qoftë përmes angazhimit në kapacitetin këshillues apo duke mbështetur drejtpërdrejt zbatimin në secilin nga hapat e përshkruar më poshtë.

Një procesi i gjerë i konsultimit u zhvillua para implementimit të ushtrimit të profilizimit, për të siguruar që merret parasysh inputi nga një shumëllojshmëri e bartësve relevant të detyrave. Gjeneri në vijim një përmbledhje të hapave kryesor:

- ▶ Siç u përmend më lart, diskutimet mbi nevojën për një profilizim të situatës së zhvendosjes në Kosovë kanë filluar në fund të vitit 2013 dhe kanë përfshirë MKK, UNHCR dhe DRC.
- ▶ GMP dhe GPP u konsolidua nga fundi i vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015.
- ▶ Në fund të vitit 2014, UNHCR kontrakttoi ASK për finalizimin e metodologjisë dhe mjeteve për mbledhjen e të dhënave.
- ▶ Në fillim të vitit 2015, UNHCR financoi një pilot ushtrim për mbledhjen e të dhënave.
- ▶ Në vitin 2015, JIPS angazhoi një koordinator të profilizimit teknik nga Statistics Norvegjia, i cili mbështeti GMP në zhvillimin e metodologjisë dhe dakordimin për vlerësimet bazë për popullatat e zhvendosura të mbuluara nga ushtrimi.
- ▶ Në vitin 2016 janë ndarë fondet nga MKK dhe DRC-së i është besuar zbatimi i një projekti për ushtrimin e profilizimit duke filluar nga muaji mars. Mjetet për mbledhjen e të dhënave u zhvilluan dhe testuan në verën e vitit 2016 dhe anketa e ekonomive familjare, pastrimi dhe futja e të dhënave u realizuan në vjeshtën e vitit 2016.
- ▶ Në dhjetor të vitit 2016 u mbajt një punëtori për të prezantuar gjetjet fillestare tek të gjithë anëtarët e GPP. Të gjeturat u diskutuan dhe u ofrua inputi për të udhëzuar analizën e të dhënave.
- ▶ Si rezultat i rekomandimeve të dakorduara gjatë punëtorisë, DRC mbajti diskutime në fokus grupe me mbështetjen e UNHCR në muajin janar dhe në fillim të muajit shkurt të vitit 2017 për të plotësuar të gjeturat e anketave në tema të përzgjedhura.
- ▶ Ky raport u hartua në bazë të konsultimeve të hollësishme me të gjithë anëtarët e GPP të mbajtura mes muajit shkurt dhe gusht të vitit 2017.

METODOLOGJIA

Ushtrimi i profilizimit ofron një analizë të kushteve të popullsisë së zhvendosur shqiptare, rom/ashkali/egjiptiane dhe serbe në Kosovë. Të gjeturat në zona të ndryshme krahasohen me ato në dispozicion për popullsinë e përgjithshme të Kosovës kurdo që është e mundur në mënyrë që të theksohen cenueshmëritë specifike të ndërlidhura me zhvendosjen që pengojnë progresin e çdo popullate të synuar drejt zgjidhjeve të qëndrueshme, sipas Kornizës së IASC.

Ushtrimi i profilizimit bazohet kryesisht në anketën e ekonomive familjare të bazuar në mostër (pyetëtori i anketës së ekonomive familjare dhe atyre individuale mund të gjendet në shtojcën 1), të plotësuar nga të dhëna cilësore të mbledhura nëpërmjet diskutimeve në fokus grupe mbi temat e përzgjedhura, si dhe një shqyrtim i të dhënave sekondare në dispozicion mbi grupet e synuara dhe popullsinë e përgjithshme të Kosovës. Mostra është projektuar për të ofruar analiza krahasuese në mes të grupeve të zhvendosura të popullatës (dhe jo si një pasqyrë e popullatës së zhvendosur si tërësi).

Siç u përmend më herët, zhvillimi i metodologjisë, vlerësimi i të dhënave bazë të popullsisë për grupet e synuara, përkufizimi i treguesve dhe mjeteve për mbledhjen e të dhënave, si dhe interpretimi fillestar i të gjeturave kryesore dhe zhvillimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve u realizuan me bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet anëtarëve të GMP dhe GPP.

POPULLSIA E SYNUAR

Popullatat e mbuluara në këtë ushtrim janë shqiptarë, rom/ashkali/egjiptianë dhe serb të zhvendosur brenda Kosovës si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë viteve 1998—1999 dhe 2004. Me qëllim të profilizimit, kjo popullsi u nda në tri grupe të synuara si në vijim (të paraqitura sipas rendit alfabetik):

- ▶ **Grupi A – PZHBV-të shqiptarë**
- ▶ **Grupi B – PZHBV-të nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian**
- ▶ **Grupi C – PZHBV-të serb⁵**

⁵ Për shkak të tipareve specifike të Grupit C, të cilat janë paraqitur në mënyrë të hollësishme në kapitullin përkatës të këtij raporti, janë identifikuar edhe nën-grupe tjera për qëllime të analizës më të saktë, përkatësisht: familjet që jetojnë në banesa private dhe familjet që jetojnë në qendra kolektive.

METODAT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE

Anketa e ekonomive familjare

Vlerësimet bazë/pikënisje të popullatës për anketën e ekonomive familjare u bënë së bashku nga GMP, anëtarët e të cilit kontribuuan me burime të të dhënave. Krahasimi dhe konsolidimi i të gjitha burimeve në dispozicion si një përpjekje e përbashkët siguroi transparencë gjatë procesit dhe mundësoi përcaktimin e këtyre vlerësimeve të grupeve të popullatës:

- ▶ **PZHBV-të shqiptarë:** 1,167 households or 5,879 individuals
- ▶ **PZHBV-të nga komunitetet rom/ashkali/egjiptian:** 137 ekonomi familjare apo 638 individë
- ▶ **PZHBV-të serbë:** 3,872 ekonomi familjare apo 16,383 individë që jetojnë në banesa private dhe 140 ekonomi familjare që jetojnë në qendra kolektive

Mostrat për PZHBV-të shqiptarë dhe serbë u morën në mënyrë të rastësishme nga JIPS nga baza/pikënisja e përcaktuar, e cila u shkëmbye si listë e anonimizuar e ofruar nga burimet përkatëse, duke marrë parasysh komunat me përqendrim më të lartë të personave të zhvendosur. Për shkak të numrit të vogël të PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian dhe banorëve të qendrave kolektive, u synuan/targetuan të gjitha ekonomitë familjare të listuara.

Janë marrë mostrat nga gjithsej **1,327 ekonomi familjare**. Madhësia e mostrës së shpërndarë sipas grupit të popullatës siç është llogaritur dhe mbledhur fillimisht është paraqitur në tabelën 1.

	Madhësia e grupit të synuar (Ekonomitë familjare)	Madhësia e mostrës së synuar (Ekonomitë familjare)	Madhësia e mostrave të mbledhura (Ekonomitë familjare)	Madhësia e mostrave të mbledhura (Individët)
PZHBV-të shqiptarë	1,167	510	502	2,249
PZHBV-të nga komunitetet rom/ashkali/egjiptian	138	138	123	491
PZHBV-të serbë në banesa private	3,872	600	567	1,907
PZHBV-të serbë në qendra kolektive	140	140	135	285
Gjithsej	5,317	1,388	1,327	4,932

Tabela 1: Vlerësimet bazë/pikënisje të popullsisë dhe mostrat për grup të synuar

Mostra e ekonomive familjare të PZHBV serbë në banesa private është shpërndarë ndërmjet dy shtresave gjeografike për të lejuar krahasimin brenda grupit. Shtresa A ka përfshirë: Leposaviqin, veriun e Mitrovicës, Zubin Potokun dhe Zveçanin. Shtresa B ka përfshirë: Fushë Kosovën, Graçanicën, Gjilanin, Kamenicën, Kllokotin, Lipjanin, Parteshin, Ranilugun, Shtërpcën dhe Vitinë. Janë aplikuar ponderimet në këto dy shtresa kur janë përdorur si mostër e përgjithshme e PZHBV-ve serbë në banesa private.

Tabela e mëposhtme paraqet shpërndarjen e çdo mostre të grupit të synuar, sipas lokacionit:

Komuna	EF-të e PZHBV shqiptarë	EF-të e PZHBV serbë në BP	EF-të e PZHBV serbë në QK	EF-të e PZHBV RAE
Deçan	1	0	0	0
Ferizaj	1	0	0	1
Fushë Kosovë	3	10	0	11
Gjakovë	0	0	1	5
Gjilan	0	3	0	0
Graçanicë	2	146	8	26
Kamenicë	0	6	0	3
Klllokot	0	5	0	0
Leposaviq	0	11	24	5
Lipjan	0	10	0	5
Mitrovicë	435	130	1	39
Novobërdë	0	4	0	0
Obiliq	0	0	0	13
Partesh	0	6	0	0
Pejë	0	0	0	3
Prishtinë	45	0	0	0
Ranillug	0	5	0	0
Skënderaj	1	0	0	0
Shtërpçë	2	75	87	9
Vushtrri	12	0	0	0
Zubin Potok	0	11	14	0
Zveçan	0	145	0	3
Total EF-të	502	567	135	123

Tabela 2: Shpërndarja e mostrës sipas komunave (EF-të = ekonomitë familjare; BP = banesa private; QK-të = qendrat kolektive)

DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE

Siç u rekomandua nga GPP pas prezantimit të të gjeturave preliminare të anketës, diskutimet në fokus grup (DFG-të) u realizuan në mënyrë që të plotësohen të dhënat në dispozicion mbi lokacionin e preferuar të banimit dhe marrëdhëniet e komunitetit.

Fokus grupet mbuluan të gjithë popullatat e synuara dhe u organizuan për i) personat e moshës 18 deri 29 dhe ii) personat e moshës 30 dhe më shumë, në mënyrë që të kuptohen dallimet në përvojat e zhvendosjes ndërmjet gjeneratave. Tabela në vijim është përmbledhje e DFG-ve të realizuara:

Popullata e synuar	Lokacioni	Numri i përgjithshëm i DFG
PZHBV-të shqiptarë	Zona e Mitrovicës Jugore	2
	Zona e Prishtinës	1
PZHBV-të nga Komunitetet rom/ashkali/egjiptian	Fushë Kosovë	1
PZHBV-të serbë në banesa private	Zona e Mitrovicës Veriore	2
	Zona e Graçanicës	2
PZHBV-të serbë në qendra kolektive	Katër komunitet veriore	1
	Zona e Shtërpçës	2
TOTAL		11

Tabela 3: Përmbledhje e diskutimeve në fokus grupe

Pjesëmarrësit në diskutim në fokus grup nga PZHBV serbë në banesa private dhe në qendra kolektive janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KIRS, përderisa pjesëmarrësit nga PZHBV shqiptarë dhe PZHBV rom/ashkali/egjiptianë janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga DRK.

KUFIZIMET

Kufizimet metodologjike të ndërlidhura me procesin e mostrimit dhe disponueshmërinë e të dhënave sekondare janë përshkruar më poshtë.

Janë hasur sfida në lokalizimin e PZHBV-ve shqiptarë dhe atyre rom/ashkali/egjiptianë, të cilat kanë rezultuar në përdorimin e metodave shtesë të mostrimit - në rend të parë teknikës "snowballing"⁶. Përveç teknikës "snowballing", janë marrë parasysht të dhënat edhe nga DRC dhe Agjencia Kosovare e Pronës⁷ për të lokalizuar ekonomitë familjare në mostrat e PZHV-ve shqiptarë, përderisa të dhënat nga KIRS janë përdorur për të lokalizuar ekonomitë familjare në mostrat e PZHV-ve rom/ashkali/egjiptianë. Shumica e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë janë identifikuar në Mitrovicën Jugore, me një numër më të vogël në Prishtinë; mostra shqiptare në këtë mënyrë kryesisht përfaqëson PZHBV-të që jetojnë në mjedise urbane të Mitrovicës Jugore.

Kufizimi i dytë ndërlidhet me disponueshmërinë dhe mbulimin e të dhënave sekondare mbi popullsinë e përgjithshme në Kosovë që janë përdorur përgjatë gjithë analizës si term i krahasimit për të kuptuar cenueshmëritë specifike për zhvendosjen e popullsisë së synuar. Burimet në vijim janë marrë parasysht për këtë qëllim:

- ▶ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, si dhe publikimet tjera nga ASK
- ▶ UNICEF 2013—2014 Multiple Indicator Cluster Surveys (Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë)
- ▶ UNDP 2015 Mosaic

Duhet të theksohet që jo të gjithë treguesit e trajtuar mund të gjindeshin në burime të tilla dhe se të dhënat nga Regjistrimi i vitit 2011 dhe anketat tjera të ASK-së nuk mbulojnë katër komunat veriore me shumicë serbe.

⁶ Teknika "snowballing" është metoda përmes së cilës ekonomitë familjare të mostrës identifikojnë ekonomi shtesë për t'u anketuar.

⁷ Ju lutemi vini re që me miratimin e Ligjit 05-L-010 në nëntor të vitit 2016, Agjencia Kosovare e Pronës është ri-emëruar në "Agjencioni Kosovar për Krahasim dhe Verifikim të Pronës".

TË GJETURAT MBI PZHBV-TË SHQIPT

TË GJETURAT KRYESORE

Të dhënat themelore demografike dhe modeli i zhvendosjes

- ▶ Një përqindje më e lartë e PZHBV-ve shqiptarë të anketuar në krahasim me mesataren në Kosovë janë të moshës 60 vjeç dhe më shumë (16% kundrejt 10%) në kohën e anketimit.
- ▶ Nivelet e analfabetizmit të raportuara janë mbi dyfish më të mëdha tek gratë shqiptare të PZHBV (3%) se sa tek burrat (1%), dhe gratë kanë në përgjithësi qasje më të ulëta të arsimit.
- ▶ Të anketuarit kanë raportuar të jenë zhvendosur kryesisht nga Mitrovica Veriore (78%).
- ▶ Totali i 93% të ekonomive familjare të synuar raportuan të jenë zhvendosur në vitin 1999; kështu që pothuajse një e pesta e popullatës ka lindur në kushte të zhvendosjes. Si shtesë 89% raportuan të kenë lëvizur disa herë para se të arrijnë në lokacionin aktual të vendbanimit, ku gati një e katërta e totalit kanë jetuar më pak se 5 vite në lagjet e tyre aktuale.

Standardi i jetesës

- ▶ Në total 56% e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë raportuan se janë pronarë të vendbanimit të tyre aktual, kundrejt një shkalle prej 96% nga popullsia e përgjithshme në Kosovë.
- ▶ Në total 17% e vendbanimeve nuk janë të lidhura në sistemin e kanalizimit.
- ▶ Tek popullsia e anketuar e moshës shkollore mund të vërehet numri më i ulët i pjesëmarrjes në arsimit se sa tek popullsia e përgjithshme e Kosovës e moshës së njëjtë në të gjitha nivelet e arsimit; si është vërejtur një hendek gjinor që favorizon djemtë më shumë se vajzat dhe që rritet në mënyrë progresive nga arsimi fillor në arsimin e mesëm të lartë.
- ▶ Nga ekonomitë familjare të anketuara, 7% e kanë raportuar të kenë pasur vështirësi në qasjen në kujdesin shëndetësor për shkak të pamundësisë për të përballuar shpenzimet dhe për shkak të largësisë së strukturave shëndetësore nga vendet e tyre të banimit.

Punësimi dhe cenueshmëria ekonomike

- ▶ Shkalla e papunësisë e PZHBV-ve shqiptarë të anketuar është 41%, kundrejt 27.5% në mesin e popullsisë së përgjithshme në Kosovë. Shkalla tek gratë është më e lartë për nëntë pikë përqindje se sa tek burrat, dhe arrin 57% tek të rinjtë.
- ▶ Pagat dhe mëditjet raportohen të jenë burimi kryesor i të ardhurave për përqindje shumë të ngjashme të ekonomive familjare të anketuar dhe popullsinë e përgjithshme të Kosovës (55% dhe 57%, respektivisht), përderisa pensionet raportohen si burimi kryesor i të ardhurave për më shumë se një të katërtën e PZHBV-ve shqiptarë (kundrejt 11% tek popullsia e përgjithshme).

- ▶ Në total 50% e të anketuarve të punësuar raportuan se fitojnë 300 Euro ose më pak në muaj, kundrejt mesatares në Kosovë në mes të 300 Euro dhe 400 Euro; për 28% nga individët e punësuar të anketuar, të hyrat mujore janë 200 Euro ose më pak.
- ▶ Në total 40% e ekonomive familjare të synuara kanë raportuar se nuk kanë persona me të ardhura, përderisa ushqimi paraqet në mesatare 55% të shpenzimeve totale mujore (kundrejt mesatares 42% për popullsinë e përgjithshme në Kosovë).

Qasja në mekanizmat për kthim të banimit, tokës dhe pronës

- ▶ Nga ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar, 83% kanë raportuar se i kanë lënë pasuritë e tyre në vendin e tyre të origjinës; 93% e tyre raportuan se posedojnë dokumente relevante të pronës.
- ▶ Në total 162 ekonomi familjare raportuan se prona/t në vendin e origjinës janë uzurpuar, përderisa 210 janë raportuar si të dëmtuara dhe që kanë nevojë për rindërtim/riparim.
- ▶ Mekanizmat për kthimin e pronës ekzistojnë, dhe 34% e ekonomive familjare të synuara me pronë në vendin e origjinës kanë raportuar të kenë paraqitur padi për kthim të pronës. Në 15 raste, ekonomia familjare ka raportuar se ka rifituar qasjen në pronën e tyre.

Lokacioni i preferuar i banimit

- ▶ Zgjidhja e preferuar e qëndrueshme në lidhje me vendin e banimit është integrimi lokal për 22% të ekonomive familjare të anketuara dhe kthimi në vendin e origjinës për 62%.
- ▶ Nëse do të ishte ofruar mbështetje kryesisht në lidhje me banimin, 58% e PZHBV-ve shqiptarë theksuan se do të shqyrtonin qëndrimin në lokacionin e tyre aktual dhe 66% do të shqyrtonin kthimin në vendin e tyre të origjinës (njëri opsion nuk përjashton tjetrin).

PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Mostra e PZHBV-ve shqiptarë përbëhet nga 502 ekonomi familjare apo 2,249 individë. Ekonomitë familjare të anketuara ishin të shpërndara kryesisht në jugun e Mitrovicës (435 ekonomi familjare) dhe Prishtinë (45 ekonomi familjare) – për shpërndarjen e detajuar të mostrës referojuni tabelës 2 në kapitullin Hyrës.

Kurdo që të gjeturat përfitohen nga një nën-mostër e popullsisë së synuar të PZHBV-ve shqiptarë (p.sh. për shkak të atyre të cilët nuk janë përgjigjur), kjo edhe do të tregohet, duke përfshirë madhësinë e nën-mostrës në formë të numrit të ekonomive familjare krahas përqindjeve.

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES

Të dhënat themelore të popullsisë

TPiramida në vijim e popullsisë ilustron shpërndarjen sipas moshës dhe gjinisë të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar⁸.

Në krahasim me të dhënat në dispozicion mbi popullsinë e përgjithshme në Kosovë⁹, tek popullsia e anketuar mund të vërehet:

- ▶ Një përqindje më e ulët e personave nën moshën 14 vjeçare (18% kundrejt 28%)
- ▶ Një përqindje më e lartë e personave mbi moshën 60 vjeçare (16% kundrejt 10%)

Siç paraqitet në tabelën më poshtë, madhësia mesatare të ekonomisë familjare të PZHBV-ve shqiptarë të synuar ishte 4.4 pjesëtarë, përderisa mesatarja në Kosovë në vitin 2013 ishte 5.71¹⁰.

8 Të dhënat i referohen 2,242 të anketuarve nga totali 2,249 individ në mostër.

9 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

10 Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës për Vitin 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Është konstatuar që 18% e ekonomive familjare PZHBV shqiptare të anketuar kanë në krye të familjes një femër.

Pjesëtarët e ekonomisë familjare	Ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptarë
1	4%
2	14%
3	13%
4	21%
5	23%
6	13%
7+	14%
TOTAL	100%

Tabela 4: Shpërndarja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë sipas madhësisë

Kur merret parasysh raporti i varësisë sipas moshës, PZHBV-të shqiptarë të anketuar tregojnë një raport prej 41%, përderisa mesatarja në Kosovë është 50%¹¹. Raporti i varësisë sipas moshës paraqet raportin ndërmjet popullsisë produktive në moshë të punës (15-64 vjeç) dhe popullsisë që nuk e ka moshën e punës (0-14 dhe 65+ vjeç) që konsiderohen të varur. Sa më i lartë raporti, aq më shumë personat e varur duhet të mbështeten nga anëtarët produktiv të ekonomisë familjare.

11 Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 1: Popullsia e anketuar e PZHBV-ve shqiptarë sipas gjinisë dhe moshës

Nivelet e shkrim-leximit dhe arsimimit

Përqindja e individëve mbi moshën 15 vjeçare që janë deklaruar si analfabet është 2% (1% tek burrat dhe 3% tek gratë). Niveli mesatar i analfabetizmit tek popullsia e përgjithshme në Kosovë e moshës 10 vjeçare apo më shumë është 3.85%¹².

Një shqyrtim i nivelit më të lartë arsimor shpalos se, tek të gjitha grup moshat, shumica e 1,389 PZHBV-ve shqiptar të moshës 18 vjeçare e më lart, të cilët kanë ofruar informacione në lidhje me këtë temë (nga totali prej 1,703 në këtë grup moshë në mostër) kanë raportuar që kanë së paku diplomë të shkollës së mesme.

Grup moshë mbi 60 vjeç tregon nivele të përgjithshme të ulëta të arsimimit, ku 8% prej tyre kanë theksuar se nuk kanë vijuar asnjë shkollim formal dhe 12% prej tyre kanë raportuar se kanë përfunduar klasën e katërt. Duhet marrë parasysh se, një numër i individëve nga grup moshat e tjera gjithashtu kanë theksuar që kanë vijuar vetëm katër vitet e para të shkollës fillore. Për të gjitha grup moshat, këta individë janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme së bashku me ata të cilët kanë theksuar se nuk kanë vijuar shkollimin fare. Përderisa gati përqindjet e njëjta e burrave dhe grave (20% dhe 19% respektivisht) kanë diplomë universitare, gratë kanë tendencë të kenë përfunduar nivelet e ulëta të arsimimit.

12 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 2: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV-të shqiptarë të anketuar sipas grup moshës




Figura 3: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV-të shqiptarë të anketuar sipas gjinisë

Modeli i zhvendosjes

PZHBV-të shqiptarë të anketuar raportuan se ishin zhvendosur kryesisht nga Mitrovica Veriore (78%) dhe, në kohën e anketës, kryesisht jetuan në jugun e Mitrovicës (87%) dhe, në masë më të vogël, në Prishtinë dhe Vushtrri (për një përmbledhje të detajuar të modelit të zhvendosjes së popullsisë së anketuar, referojuni shtojcës 3).

Popullata e anketuar ka raportuar që janë zhvendosur kryesisht në vitin 1999 (93%), dhe kështu pothuajse një e pesta e popullsisë (19% nga 2,008 të anketuar nga totali 2,249 në mostër) është lindur në kushte të zhvendosjes.

Në total 11% e ekonomive familjare të anketuara¹³ të cilët ofruan informatë për numrin sa herë kanë ndërruar vendin kanë raportuar se janë zhvendosur drejtpërdrejt në vendin aktual të banimit, ndërsa 37% kanë raportuar se kanë ndërruar lokacionet dy deri në tre herë, 35% katër deri në pesë herë dhe 17% gjashtë apo më shumë herë (të gjitha shifrat përfshijnë lëvizjen fillestare të zhvendosjes). Në përgjithësi, 24% e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë kanë jetuar më pak se 5 vite në lagjet e tyre aktuale në kohën e anketimit.

13 Të dhënat i referohen 499 ekonomive familjare nga gjithsejtë 502 në mostër.

STANDARDI I JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION

Kushtet e banimit

Nga ekonomitë familjare të PZHBV të anketuar, 59% jetojnë në shtëpi individuale, ndërsa pjesa e mbetur kryesisht jetojnë në apartamente. Në total 56% kanë raportuar se kanë në pronësi vendbanimin e tyre aktual, kundrejt një shkalle prej 96% tek popullsia e përgjithshme në Kosovë¹⁴, përderisa pjesa e mbetur raportoi se kryesisht jetojnë me qira (27%).

Nga popullata e synuar, 86% jetojnë në zona urbane, dhe të gjitha lokacionet janë lehtësisht të qasshme me rrugë të asfaltuara. Shumica e ekonomive familjare jetojnë qoftë në apartamente apo shtëpi (95% kombinuar) me mure solide.

PZHBV-të shqiptarë	
Uji i rrjedhshëm	99%
Energjia elektrike	97%
Plin	2%
Sistemi i kanalizimit	83%

Tabela 5: Përqindja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë me qasje të raportuar në shërbimet e radhitura

Pothuajse jo të gjitha banesat kanë ujë të rrjedhshëm dhe energji elektrike. Sfidat dalin në lidhje me qasjen në sistemin e kanalizimit për 17% të ekonomive familjare.

14 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 4: Kohëzgjatja e qëndrimit të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar në lagjet aktuale

Qasja në arsim

Qasja në arsim është shqyrtuar në raport me ndjekjen e rregullt të shkollës (që nënkupton 5 ditë në javë). Tabela e mëposhtme paraqet normat e disagreguara sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë për 245 fëmijë të moshës fillore dhe 158 fëmijë/të rinj të shkollës së mesme për të cilët të dhënat janë mbledhur (nga totali 273 në mostër), dhe nënvizon ndjekje më të ulët tek vajzat se sa tek djemtë me rritje në shkollën e mesme.

Tek popullsia e përgjithshme në Kosovë e moshës së njëjtë, shkalla e ndjekjes është 98% për shkollën fillore dhe 91% për shkollën e mesme¹⁵.

	Meshkuj	Femra
Shkalla e ndjekjes tek shkolla fillore	83%	79%
Shkalla e ndjekjes tek shkolla e mesme	78%	70%

Tabela 6: Shkalla e ndjekjes së shkollës për PZHBV-të shqiptarë të anketuar sipas nivelit (fillor dhe të mesëm) dhe gjinisë

Qasja në kujdesin shëndetësor

Nga ekonomitë familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë, 7% kanë raportuar se nuk kanë qenë në gjendje të kenë qasje në kujdesin shëndetësor kur kanë pasur nevojë gjatë periudhës gjashtë muaj para intervistës. Shumica e këtyre ekonomive familjare jetojnë në zona rurale. Arsytet e raportuara për mos qasje në kujdesin shëndetësor ndërlidhen me mundësinë e përballimit të shpenzimeve dhe distancën. Sipas një ankete të fundit mbi kënaqshmërinë me shërbimet publike të realizuar nga UNDP¹⁶, pamundësia e përballimit të shpenzimeve radhitet nga popullsia e përgjithshme e Kosovës në krye të listës së faktorëve që pengojnë qasjen në kujdesin shëndetësor.

15 UNICEF Kosovo (UNSCR 1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Kosovë (UNSCR 1244). Monitorimi i Situatës së Fëmijëve dhe Grave - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014).

16 UNDP 2015 Mosaic.

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Të gëzuarit e një standardi të duhur të jetesës pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur zgjidhje të qëndrueshme gëzojnë, pa diskriminim, një standard adekuat të jetesës, përfshirë së paku strehimin, kujdesin shëndetësor, ushqimin, ujin dhe mjetet tjera të mbijetesës.

Kriteri: Qasja në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme kanë qasje në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për qasje në shërbimet publike, rikthimin e pronës dhe posedimeve, votim apo ndjekjen e qëllimeve tjera të ndërlidhura me zgjidhjet e qëndrueshme.

Dokumentacioni personal

Nga mostra e përgjithshme e PZHBV-ve shqiptarë katër individë raportuan se nuk posedojnë asnjë formë të dokumentacionit personal. Totali i 11% raportuan se nuk posedojnë as pasaportë e as letërnjoftim - edhe pse raportohet që posedojnë çertifikatë të lindjes. Nga keta individ 98% e tyre ishin nën moshën 24 vjeçare dhe shumica (88%) theksuan që kanë planifikuar të aplikojnë për dokumentacion personal.

Duke marrë parasysh se, 82% e individëve në posedim të letërnjoftimit kanë raportuar që ky dokument është lëshuar nga Kosova, ndërsa 3.5% janë lëshuar nga Serbia.

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET

Duke pasur parasysh disponueshmërinë e programeve publike të mirëqenies, aftësia për të përmbushur nevojat socio-ekonomike të PZHBV-ve shqiptarë shqyrtohet nga perspektivat e qasjes si në tregun e punës edhe mirëqenie. Ky kapitull shqyrton qasjen e mostrës së synuar në tregun e punës dhe kushtet e punësimit në krahasim me popullsinë e përgjithshme në Kosovë. Gjendja e përgjithshme ekonomike e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë, përfshirë qasjen e tyre në përfitimet sociale, gjendet në kapitullin tjetër.

Qasja në punësim

Qasja në punësim analizohet nëpërmjet treguesve në vijim:

- ▶ Pjesëmarrja e fuqisë punëtore, që nënkupton përqindjen e popullsisë ekonomikisht aktive në moshë të punës (ata që janë ose duke punuar ose duke kërkuar punë);
- ▶ Shkalla e punësimit, që nënkupton përqindjen e popullsisë në moshë të punës e cila është e punësuar; dhe
- ▶ Shkallën e papunësisë, që nënkupton përqindjen e fuqisë punëtore që aktualisht nuk është e punësuar dhe është duke kërkuar punë.

T

ë tre treguesit marrin parasysh popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç), që për popullsinë e anketuar të PZHBV shqiptarë përbën 1,593 individ, 1,587 nga të cilët ofruan informata në këtë temë. Duhet të theksohet që termi "punësim" mund të përbëjë situata të ndryshme të punësimit, si punësimi joformal dhe nën-punësimi. Prandaj, do të shqyrtohen edhe kushtet e punësimit.

Siç mund të vërehet në tabelën e mëposhtme, përderisa më shumë PZHBV shqiptarë në moshë pune marrin pjesë në fuqinë punëtore në krahasim me popullsinë¹⁷ e përgjithshme, një përqindje më e lartë e tyre nuk janë në gjendje të gjejnë punësim. Dallimi buron nga pjesëmarrja e rritur e PZHBV femra në fuqinë punëtore (31%) në krahasim me atë të femrave në popullsinë e përgjithshme (18%), përderisa pjesëmarrja e meshkujve në fuqinë punëtore është mjaft e ngjashme tek PZHBV-të e anketuar dhe popullsia e përgjithshme.

Përderisa shkalla e papunësisë së të rinjve të moshës 15-24 (411 individ nga mostra, 409 nga ata ofruan informatë në këtë temë) është e krahasueshme me atë të popullsisë së përgjithshme në Kosovë, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është shumë më e lartë. Vlen të theksohet gjithashtu shkalla e konsiderueshme më e lartë e papunësisë e këtij grupi në krahasim me popullsinë e përgjithshme në moshë të punës nga mostra (57% kundrejt 41%).

17 Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Mosha 15-64		Mashkuj	Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Shqiptar	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	55%	31%	43%	1587
	Shkalla e punësimit	34%	17%	25%	1587
	Shkalla e papunësisë	38%	47%	41%	683
Popullata e Kosovës	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	58%	19%	39%	/
	Shkalla e punësimit	43%	13%	28%	/
	Shkalla e papunësisë	26%	32%	28%	/

Tabela 7: Qasja në punësim e individëve në moshë të punës (15-64 vjeç) tek PZHBV-ve shqiptarë dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës sipas gjinisë¹⁸

18 Kolona "Totali N/Emëruesi" tregon emëruesit të përdorur për përqindjet e llogaritura: për llogaritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallën e punësimit, nën-mostra (emëruesi) relevante përfshinë 1,587 individë në moshë të punës (15-64 vjeç); për shkallën e papunësisë, nën-mostra relevante (emëruesi) përfshinë 683 individë që marrin pjesë në fuqinë punëtore.

Mosha 15-64		Mashkuj	Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Shqiptar	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	28%	22%	25%	409
	Shkalla e punësimit	14%	8%	11%	409
	Shkalla e papunësisë	52%	65%	57%	103
Popullata e Kosovës	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	39%	18%	33%	/
	Shkalla e punësimit	15%	4%	10%	/
	Shkalla e papunësisë	47%	65%	52%	/

Tabela 8: Qasja në punësim e të rinjve (15-24 vjeç) tek të anketuarit të PZHBV-ve shqiptarë dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës sipas gjinisë

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Qasja në mjetet e jetesës dhe punësimi

Punësimi dhe mjetet e jetesës në dispozicion për PZHBV-të duhet t'iu lejojë atyre që të përmbushin nevojat e tyre themelore socio-ekonomike.

Aranzhimet e punësimit dhe sektori

Nga 352 PZHBV shqiptarë që ofruan informatë mbi llojin e kontratës së tyre aktuale, - të cilët përfaqësojnë 87% nga 397 individë, të cilët kanë raportuar se janë të punësuar - 78% theksuan të kenë kontratë me shkrim, përderisa shkalla korresponduese për popullsinë e përgjithshme në Kosovë është 73.7%¹⁹. Prevalenca e kontratave me shkrim tek popullata e anketuar është më e lartë tek femrat (81%) se sa tek meshkujt (76%).

Nga 356 individë të cilët ofruan më shumë informata mbi kushtet e punësimit të tyre, 88% raportuan se janë të punësuar me orar të plotë, duke mos dhënë në këtë mënyrë indikacione të fuqishme të nën-punësimit.

19 Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Mund të vërehet pak dallim ndërmjet përqindjes së meshkujve të punësuar (89%) dhe femrave (86%). Pjesa e mbetur e këtij grupi është e shpërndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet punësimit me orar të pjesshëm (4%), punësimit sezonal (4%) dhe punësimit të parregullt (4%).

	Popullsia e përgjithshme në Kosovë		PZHBV-të Shqiptarë (total)
	Punonjësit	Punonjëset	
Më pak se 100 Euro	0.2%	0.3%	2%
101-150 Euro	1.0%	1.3%	7%
151-200 Euro	5.9%	7.3%	19%
201-250 Euro	12.2%	11.0%	10%
251-300 Euro	19.0%	17.4%	12%
301-400 Euro	30.4%	32.8%	22%
400+ Euro	31.3%	30.0%	28%
Total %	100%	100%	100%
Total N	/	/	278

Tabela 9: Shtrirja e pagesave mujore për PZHBV-të shqiptarë²⁰ të punësuar dhe popullsinë e përgjithshme në Kosovë²¹

20 Të dhënat i referohen 278 individëve të cilët kanë ofruar informacione lidhur me pagat e tyre nga 397 të PZHBV-ve shqiptarë të punësuar.

21 Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 5: Aranzhimi i punës i PZHBV-ve shqiptarë të punësuar që janë anketuar

Një dispersion më i madh i gamës së pagave vërehet tek PZHBV-të shqiptarë në krahasim me popullsinë e përgjithshme në Kosovë. Totali i 50% e 278 të anketuarve të cilët ofruan informata për pagat e tyre raportuan që marrin paga nën 300 Euro në muaj, ku 28% marrin 200 Euro apo më pak në muaj, ndërsa shumica e pagave në Kosovë janë ndërmjet 300 dhe 400 Euro. Dallimi në shumat e raportuara të pagave ndërmjet meshkujve dhe femrave të PZHBV-ve shqiptarë është i vogël, ku femrat fitojnë përafërsisht 5 Euro më pak se meshkujt.

PZHBV-të shqiptarë që raportojnë se janë të punësuar duket të jenë të shpërndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet sektorit publik dhe privat (47% dhe 51% përkatësisht). Megjithatë, ky dallim rritet tek të rinjtë e punësuar: 38% janë të punësuar në sektorin publik në krahasim me 59% të tyre të punësuar në sektorin privat. Për më tepër, përqindja e PZHBV-ve shqiptarë femra që punojnë në sektorin publik është 10 pikë në përqindje më e lartë se sa në sektorin privat përderisa për PZHBV shqiptarë meshkuj trendi është i kundërt.

Kush janë të papunësuarit?

Përderisa popullsia e papunësuar tashmë është shqyrtuar duke konsideruar karakteristikat kryesore demografike, si gjinia dhe moshja, këtu shqyrtohet më tej sipas niveleve të arsimit, si dhe faktorëve më strukturor siç është kohëzgjatja e qëndrimit në lokacionin aktual. Të gjithë këta faktorë janë kontrolluar në një analizë të regresionit, e cila mbështet përfundimet në vijim:

- ▶ **Shkallët e papunësisë tek PZHBV-të shqiptarë femra janë më të larta se tek meshkujt, me nëntë pikë përqindje tek popullsia e përgjithshme në moshë të punës (47% dhe 38%, përkatësisht) dhe me 13 pikë përqindje tek të rinjtë (65% dhe 52%, përkatësisht).**
- ▶ **Shkallët e papunësisë tek të rinjtë janë në mënyrë të konsiderueshme më të larta se sa tek popullsia në moshë të punës në mostrën e synuar: 57% kundrejt 41%. Megjithatë, në krahasim me popullsinë e përgjithshme të Kosovës (52.4%), diferenca është më e ulët.**
- ▶ **Papunësia zvogëlohet me rritjen e nivelit arsimor - nga 69% në mesin e atyre me arsimim fillor deri në 32% në mesin e atyre me kolegji apo arsim të lartë. Trendi i njëjtë është njëlloj i dukshëm tek popullsia e përgjithshme në Kosovë.**




Figura 6: PZHBV të popullatës shqiptarë të punësuar të anketuar, sipas sektorit të punës

- ▶ Shkalla e papunësisë arrin pikën më të ulët tek ata që kanë jetuar në lokacionin aktual të banimit mes 11 deri 15 vite (36%, përderisa është më e lartë tek ata që kanë jetuar në lokacion të njëjtë për periudha më të shkurtra apo më të gjata.

		Shkalla e papunësisë	
PZHBV Shqiptar	Fillor		69%
	Mesëm		43%
	Kolegj ose më lartë		32%
Popullata e Kosovës	Fillor		33%
	Mesëm		30%
	Kolegj ose më lartë		18%

Tabela 10: Shkallët e papunësisë të PZHBV shqiptarë të anketuar dhe popullsia e përgjithshme në Kosovë²² sipas nivelit të arsimit.

Përveç analizës së mësipërme, doli se 41% e të papunëve raportuan që nuk janë të regjistruar në ndonjë zyre për të papunë. Nuk janë vërejtur dallime të veçanta ndërmjet të rinjve dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës në këtë drejtim.

Së fundmi është shqyrtuar perceptimi i të papunëve në lidhje me arsyen kryesore për mos punësim, ku 93% të të anketuarve cituan si arsye atë se 'numër tepër i madh i personave janë duke kërkuar punë'.

22 Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

GJENDJA EKONOMIKE

Gjendja ekonomike e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptare të synuara shqyrtohet duke konsideruar burimet kryesore të të ardhurave, si dhe shpenzimet.

Burimet e të ardhurave

RTë anketuarve u është kërkuar që të radhisin burimin më të rëndësishëm dhe burimin e dytë më të rëndësishëm të të ardhurave për ekonomitë e tyre familjare. Siç ilustron në tabelën e mëposhtme, përderisa pagat dhe mëditjet janë raportuar si burimi kryesor i të ardhurave për përqindje shumë të ngjashme të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar dhe popullsisë së përgjithshme në Kosovë²³, bfitimet nga bizneset përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave për mbi dyfish më shumë tek popullsia e përgjithshme në Kosovë. Për më tepër, pensionet raportohen të jenë burimi kryesor i të ardhurave për më shumë se një të katërtën e ekonomive familjare të synuara, në krahasim me 11% të popullsisë së përgjithshme në Kosovë; megjithatë, kjo duhet të nënkuptohet në bazë të shpërndarjes sipas moshës mostrës së PZHBV-ve, përqindja më e lartë e popullsisë që janë mbi moshën 60 vjeç në moster (16% kundrejt 10% tek popullsia e përgjithshme në Kosovë) nuk mjafton të vertetohet ndryshimin.

23 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës




Figura 7: Shkallët e papunësisë tek PZHBV-të shqiptarë të anketuar sipas kohëzgjatjes së qëndrimit në lokacionin aktual

Sa i përket burimit sekondar të të ardhurave, 63% e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptare të anketuara raportuan se nuk kanë ndonjë burim sekondar, përderisa 21% raportuan se pranojnë një formë të përfitimeve sociale. Megjithatë, siç u tha më herët, përfitimet sociale paraqiten si burimi primar i të ardhurave nga vetëm 8% e të anketuarve.

Bazuar në të gjeturat nga kapitulli paraprak në lidhje me qasjen në punësim, mund të përfundohet që 40% e ekonomive familjare të synuara nuk kanë ndonjë person me të ardhura, përderisa pjesa tjetër prej 60% raportuan që kanë një deri në tre anëtarë të punësuar. Këto përqindje reflektojnë dhe konfirmojnë mënyrën se si ekonomitë familjare radhitën mbështetjen e tyre në burimet e të ardhurave, me një 34% të kombinuar që paraqitën pensionet ose përfitimet sociale si burimet kryesore të tyre të të ardhurave dhe një 60% të kombinuar që paraqitën pagat, mëditjet apo fitimet nga bizneset si burimin e tyre kryesor të të ardhurave.




Figura 8: Përqindjet e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë sipas numrit të pjesëtarëve të punësuar

	PZHBV-të Shqiptarë	Popullsia e përgjithshme në Kosovë
Pagat	47%	51%
Mëditjet jo të rregullta (të ardhurat nga veprimtaritë e përkohshme)	8%	6%
Bujqësia	0%	5%
Fitimet nga biznesi (përfshirë ndërmarrjet nga EF)	5%	11%
Pensionet	26%	11%
Përfitimet sociale	8%	4%
Remitencat	0%	8%
Tjera	4%	4%
Nuk ka burim të të ardhurave	2%	0%

Tabela 11: Burimi kryesor i të ardhurave për ekonomitë familjare - PZHBV-të shqiptarë të anketuar në krahasim me popullsinë e përgjithshme në Kosovë

Shpenzimet

PZHBV-të shqiptarë raportuan se shpenzojnë një mesatare mujore prej 403 Euro për ekonomi familjare²⁴ dhe një mesatare mujore prej 102 Euro për person²⁵. Shifra e fundit është në përputhje me shpenzimet për kokë banori në dispozicion për popullsinë e përgjithshme në Kosovë (119 Euro)²⁶.

24 Qiraja nuk përfshihet në shpenzimet e përgjithshme pasi që vetëm disa ekonomi familjare kanë raportuar që i paguajnë ato, e cila do të mund të shtrembëronte totalin. Ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptarë që raportuan se paguajnë qiranë paraqesin një kosto mesatare mujore prej 122 Euro.

25 Kur llogariten shpenzimet mesatare është e rëndësishme që të silllet vëmendja në konceptin e devijimit standard (sasia që shpreh se për sa pjestarët e një grupi dallojnë nga vlera mesatare për grupin; sa më të shpërndara të dhënat, devijimi më i lartë). Devijimi standard në këtë rast është 93 Euro, që është afër mesatares (102 Euro). Kjo zbulon se shtrirja e shpenzimeve për kokë banori ndryshon në masë të madhe, duke aluduar kështu në gjendje mjaft të ndryshme ekonomike, siç shqyrtohet në seksionin pasues.

26 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës. (Qiraja këtu është e përfshirë në shpenzimet për banim, por raportohet se përbën një shpenzim vetëm për një pakicë të vogël të popullsisë. Prandaj, kjo nuk pritet të prek mesataren e popullsisë).

Duke marrë parasysh përqindjen e shpenzimeve mujore të dedikuara për ushqim, që është një përcaktues i fleksibilitetit ekonomik, një shkallë mesatare prej 55% vërehet për popullsinë e anketuar, kundrejt një shkalle mesatare 42% të llogaritur për popullsinë e përgjithshme në Kosovë²⁷. Tsa më i madh raporti i ushqimit, aq më i vogël është fleksibiliteti ekonomik që pritet ta ketë ekonomia familjare.

27 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 9: Shpërndaja e shpenzimeve mujore për kokë banori të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar – e paraqitur sipas llojit në Euro dhe si përqindje e totalit

Faktorët e mirëqenies ekonomike të ekonomisë familjare

Analiza e gjendjes ekonomike e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë ka zbuluar një ndryshim të madh tek popullsia e anketuar. Për të kuptuar më mirë se çka i karakterizon ekonomitë familjare që jetojnë në gjendje të ndryshme ekonomike, u formuan katër nën-grupet në bazë të shpenzimeve të raportuara (shih kutinë mbi grupimin e shpenzimeve për detaje).

Të kuptuarit e asaj se çka i karakterizon këto grupe mund të ndihmojë të kuptuarit se kush është popullata më e cenueshme ekonomikisht. Janë shqyrtuar faktorët në vijim: rëndësia e punësimit, kohëzgjatja e qëndrimit në lokacionin aktual, niveli i arsimimit i kryefamiljarit të ekonomisë familjare dhe pronësia aktuale e banesës. Këto janë të gjeturat:

- ▶ **Ndikim i kufizuar i pagave në mirëqenien e ekonomive familjare:** SPërqindje të konsiderueshme të ekonomive familjare në grupet me shpenzime mesatare dhe më të larta kanë raportuar se nuk kanë asnjë pjesëtar të punësuar (40% dhe 38%, përkatësisht) dhe që pranojnë përfitime sociale të cilat janë treguar nga 41% dhe 23% të këtyre grupeve, përkatësisht.
- ▶ **Polarizim më i fuqishëm ekonomik tek ekonomitë familjare që kanë jetuar pese dhe 15 vite në lokacionin aktua²⁸:** një përqindje më e madhe e ekonomive familjare në grupin me shpenzimet më të

28 Të gjitha referencat për më pak se 12 vite duhet të tregohen duke përcaktuar vendin e fundit të zhvendosjes pas lëvizjes origjinale e cila ka ndodhur në mes të viteve 1998 dhe 1999 ose në vitin 2004.

ulëta konstatohet të kenë jetuar në lokacionin aktual mes pesë dhe 15 viteve (23%), në krahasim me ata që kanë arritur rishtazi (16%) dhe ata që kanë jetuar në vendin e njëjtë për më shumë se 16 vite (18%). Në të njëjtën kohë, ekonomitë familjare në grupin me shpenzimet më të larta gjithashtu përbëjnë një përqindje më të madhe të atyre që kanë jetuar në lokacionin aktual mes pesë dhe 15 vite (mes 19% dhe 21%). Në përgjithësi, kjo tregon që ekonomitë familjare të PZHBV-ve që kanë lëvizur rishtazi në lokacionin aktual, apo kanë jetuar aty për më shumë se 16 vite, janë më të koncentruar në grupin me shpenzime mesatare, ndërsa ekonomitë familjare që kanë jetuar në lokacionin aktual mes pesë dhe 15 vite shpalosin një polarizim më të fuqishëm kur bëhet fjalë për mirëqenien ekonomike (shih Tabelën I, shtojca 4).

- ▶ **Ndikimi pozitiv i nivelit të arsimit të kryefamiljarit të ekonomisë familjare në mirëqenien ekonomike:** Ekonomitë familjare kryefamiljari i të cilave ka diplomë kolegji tregojnë gjasa më të vogla që të bien brenda grupit me shpenzimet më të ulëta (12% kundrejt 20% dhe 19% në mesin e atyre me arsim të mesëm dhe fillor, respektivisht) (shih tabelën I, shtojca 4).
- ▶ **Nuk ka ndikim të pronësisë së banimit në lokacionin aktual në mirëqenien e ekonomisë familjare:** Nuk është vërejtur ndonjë lidhje ndërmjet mirëqenies ekonomike të ekonomive familjare dhe asaj nëse ato kanë në pronësi apo janë me qira në banimin e tyre aktual.

PZHBV-të shqiptarë	0 pjesëtarë të punësuar	1 pjesëtar i punësuar	2 pjesëtarë të punësuar	3 pjesëtarë i punësuar	Total %	Total N
Grupi me shpenzimet më të ulëta	53%	34%	9%	4%	100%	102
Grupi i dytë më i ulët	34%	46%	14%	6%	100%	172
Grupi me shpenzime mesatare	38%	38%	15%	9%	100%	136
Grupi me shpenzimet më të larta	40%	42%	13%	4%	100%	90

Tabela 12: Numri i pjesëtarëve të punësuar të ekonomive familjare të PZHBV-e shqiptarë të anketuar sipas grupit të shpenzimeve

Grupimi i shpenzimeve

Janë formuar katër grupe të mirëqenieve të ndryshme ekonomike në bazë të shpenzimeve ditore të ekonomive familjare për kokë banori. Informacionet mbi shpenzimet janë ofruar nga pothuajse e gjithë mostra e synuar (500 ekonomi familjare nga 502). Grupi më i ulët përbëhet nga ekonomitë familjare shpenzimet e të cilave janë nën kufirin e varfërisë prej 1.90 USD në ditë (që korespondon me 1.79 Euro në momentin e shkrimit, siç është përcaktuar nga Banka Botërore në vitin 2015 në aspektin e fuqisë blerëse – shih <http://www.worldbank.org/en/topic/poverty/brief/global-poverty-line-faq>). Ekonomitë familjare të mbetura ndahen në tri grupe të gamave të barabarta, siç paraqitet në tabelën më poshtë. Totali i 20% e ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë bien në grupin me shpenzimet më të ulëta.

	PZHBV-të shqiptarë
Grupi me shpenzimet më të ulëta: Shpenzojnë më pak se 1.79€ për kokë banori/ditë	20%
Grupi i dytë më i ulët: Shpenzojnë ndërmjet 1.8 dhe 2.9€ për kokë banori/ditë	34%
Grupi me shpenzime mesatare: Shpenzojnë ndërmjet 3 dhe 4.6€ për kokë banori/ditë	27%
Grupi me shpenzimet më të larta: Shpenzojnë më shumë se 4.6€ për kokë banori/ditë	18%
Total %	100%
Total N (ekonomi familjare)	500

Tabela 13: Shpërndarja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë sipas niveleve të shpenzimeve (për kokë banori në ditë)

Strategjitë e përbaljes ekonomike

Ekonomitë familjare janë pyetur në lidhje me perceptimin e tyre mbi gjendjen e tyre ekonomike, duke shikuar nëse kanë pasur vështirësi të paguajnë qiranë apo në përgjithësi të përbushin nevojat e tyre themelore. Nga 27% e PZHBV-ve shqiptare që jetojnë me qera, 70% e tyre ishte dashur të huazojnë para në 6 muajt e fundit me qëllim që të paguajnë qiranë. Përbushja e nevojave themelore raportohet të jetë një sfidë për rreth 44% e të gjitha ekonomive familjare. Këto ekonomi familjare kanë treguar se mekanizmi kryesor përbaljes i tyre është 'huamarrja nga miqtë/ të afërmit ose anëtarët e tjerë të komunitetit '(p.sh. pronarët e shitoreve).

QASJA NË MEKANIZMAT PËR KTHIMIN E BANESËS, TOKËS DHE PRONËS

Në Kosovë kthimi i pronës menaxhohet nga Agjencioni Kosovar për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, e cila është e mandatuar për pranimin, përpunimin dhe zgjidhjen e kërkesave që lidhen me pronat e paluajtshme. Lloji i pronës i zotëruar në vendin e origjinës nga ana e popullatës së anketuar, si dhe niveli i qasjes në to, janë hulumtuar në vijim.

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës

Të gjitha ekonomitë familjare të synuara nga PZHBV-të shqiptare kanë informuar nëse kanë pronë në vendin e origjinës. Nga ata 83% kanë raportuar se posedojnë së paku një pasuri. Në përgjithësi 73% nga ky grup i 418 i ekonomive familjare treguan se kanë vend banimi, për 26% e tyre tokë jobujqësore, dhe për 18% tokë bujqësore, siç përmbledhet në vijim.

	%	Numri
EF me shtëpi të lëna pas	73%	368
EF me tokë bujqësore të lënë pas	18%	91
EF me tokë jobujqësore të lënë pas	26%	133
Gjithsej EF me pronë të lëna pas	83%	418*

Tabela 14: Ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptare (EF) me pronë në vendin e origjinës sipas llojit të pasurisë

* Disa ekonomi familjare raportuan se kanë lënë pas më shumë se një pasuri. Kështu që shuma e përgjithshme numerike dhe përqindja korrespondon me numrin/përqindjen e ekonomive familjare që raportojnë të paktën një pasuri në vendin e origjinës (418 ekonomi familjare ose 83% nga totali) dhe jo me shumën e gjithë numrave/përqindjeve të radhitura më sipër sipas llojit të pasurive.

Ekonomitë familjare të anketuara përshkruan gjendje të ndryshme të pronës që, ata kanë lënë pas në vendin e origjinës, si në tabelën më poshtë. Nga informata del në pah se në kohën e anketimit 162 ekonomi familjare raportuan se prona/t e tyre si të uzurpuara, 210 raportuan se ato kanë nevojë për rindërtim/riparim, dhe 18 ekonomi familjare raportuan të mos jenë në dijeni për gjendjen e pasurisë së tyre.

Qasja në pasuri

Nga 418 ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar e që deklarojnë se kanë lënë pas pasuri, 93% kanë raportuar se posedojnë dokumente të pronësisë së pronave të tyre në vendin e origjinës, qofshin ato banesa apo toka. Nga ekonomitë familjare me pasuri në vendin e origjinës, 34% raportuan se kanë parashtruar një kërkesë për kthimin e tyre në posedim.

	Numri (EF)	Përqindja (%)
EF me pasuri (një ose më shumë) në vendin e origjinës	418	83% e mostrës së përgjithshme
EF me dokumente të pronësisë (për të paktën një nga pasuritë e tyre)	390	93% e EF-ve me pasuri të lëna pas
EF që kanë paraqitur kërkesë/kërkesa për kthim në posedim	142	34% e EF-ve me pasuri të lëna pas
EF kërkesa e të cilave është zbatuar	15	11% e EF-ve që kanë paraqitur kërkesë

Tabela 15: Rishikimi i pronësisë në vendin e origjinës, posedimi i dokumentacionit të pronësisë dhe kërkesat e paraqitura sic janë raportuar nga ekonomitë familjare PZHBV- të e anketuar shqiptar (EF)

Nga kërkesat e parashtruara, 23% janë raportuar se janë pranuar (gjithsej 32 kërkesa) dhe 30% janë duke u procesuar. Duhet theksuar se pranimi i një kërkesë nuk është i njëjtë me zbatimin e saj. Në total janë raportuar se janë zbatuar 15 kërkesa, ku ekonomitë familjare tani kanë qasje në pronë.

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: mekanizmat efektiv dhe të arritshëm për rikthimin e banesës, tokës dhe pronës

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme kanë qasje në mekanizmat efektiv për rikthimin me kohë të banesës, tokës dhe pronës së tyre, pavarësisht nëse ata kthehen apo zgjedhin të integrohen në nivel lokal apo të vendosen diku tjetër në vend.

Procesi përmes të cilit kryhet rikthimi i banesës, tokës dhe pronës si dhe kompensimi i ndërlidhur mund të jetë kompleks dhe të konsumoj shumë kohë. Jo domosdoshmërisht duhet që ky proces të përfundoj plotësisht para se të mund të thuhet se PZHBV-të kanë gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Faktor përcaktues është se ata kanë qasje në një mekanizëm efektiv dhe të arritshëm për rikthimin dhe kompensimin e pronave (duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, ndihmën ligjore falas) dhe të kenë mundësi që të banojnë në mënyrë të sigurt gjatë kësaj periudhe të përkohshme.




Figura 10: Ekonomitë familjare të PZHBV-ve të anketuar shqiptarë (EF) me pasuri të lëna prapa sipas kushteve të raportuara të pronës (EF-të të paraqitura si numër)

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT

Hyrje

Ky kapitull shqyrton planet dhe qëllimet e PZHBV-ve të anketuar shqiptarë në lidhje me zgjidhjen e tyre të qëndrueshme të preferuar sa i përket vend-ndodhjes së banimit në të ardhmen, në bazë të tri opsioneve të marra në konsideratë nga Korniza e IASC:

- ▶ **Kthimi në vendin e origjinës**
- ▶ **Integrimi në vendin e zhvendosjes (vendndodhja aktuale)**
- ▶ **Vendbanim në një vend të tretë (brenda apo jashtë Kosovës)**

Sipas Kornizës së IASC, vetëm një lëvizje e thjeshtë fizike, në vetvete, nuk përbën një zgjidhje të qëndrueshme. Prandaj këto tri shtigje për zgjidhje të qëndrueshme duhet të udhëhiqen nga parimet themelore dhe kriteret e përcaktuara në Kornizë, të cilat mund të përdoren për përcaktimin e shkallës në të cilën është arritur një zgjidhje e qëndrueshme.

Gjithashtu duhet mbajtur në mend se këto vendime dhe qëllimet që kanë të bëjnë me vendndodhjen e vendbanimit nuk janë bërë në vakum, por janë të ndërthurura ngushtë me faktorët tjerë vendimtarë siç janë punësimi dhe mundësitë në arsimim, qasja në pronë, fleksibiliteti ekonomik, marrëdhëniet e komunitetit dhe perceptimet mbi qetësinë dhe sigurinë.

Anketa e profilizimit dhe DFG i janë qasur temës së qëllimeve dhe planeve për të ardhmen nga tri perspektiva, duke pyetur ekonomitë familjare:

- ▶ Cili është opsioni i tyre i preferuar për vendndodhjen e përhershme të qëndrimit;
- ▶ Cilat kushte ata i konsiderojnë të nevojshme për t'u kthyer apo integruar në nivel lokal, dhe si i prioritojnë ato;
- ▶ Në qoftë se ata tashmë kanë plane konkrete për ta ndërruar vendin e tyre të banimit brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Duke parë konsideratat për vendndodhjen e ardhshme të banimit, është me rëndësi të theksohet se të gjitha ekonomitë familjare janë pyetur nëse do të konsideronin të qëndronin, si dhe nëse do të vënin nën konsideratë të kthehen nën kushte të caktuara; kjo do të thotë se ekonomitë familjare mund t'i marrin nën konsideratë të dy opsionet, dhe se njëri nuk përjashton tjetrin.

Zgjidhja e qëndrueshme pavarësisht kushteve

Ekonomitë familjare PZHBV shqiptare të anketuara janë pyetur në lidhje me vendndodhjen e tyre të preferuar të vendbanimit, pavarësisht kushteve. Në total 492 nga totali 502 i ekonomive familjare në mostër kanë ofruar këto përgjigje si në vijim:

- ▶ Integrimi lokal në vendin e zhvendosjes - 22%
- ▶ Kthimi në vendin e origjinës - 62%
- ▶ Zhvendosja në një vend të tretë brenda Kosovës - 4%
- ▶ Zhvendosja jashtë Kosovës - 10%

Eksplorimi se çfarë i karakterizon ekonomitë familjare që preferojnë të qëndrojnë dhe ato që preferojnë të kthehen ofron disa indikacione mbi atë se çfarë ndikon në këtë vendim:

- ▶ **Prona në vendin e origjinës ka ndikim deri në një masë mbi preferencën për t'u kthyer:** 68% e ekonomive familjare me të paktën një banesë në vendin e origjinës preferojnë të kthehen, ndërsa përqindja në mesin e ekonomive familjare pa një banesë në vendin e origjinës është 47%.

- ▶ **Qasja më e mirë në mjetet e jetesës ka ndikim deri në një masë mbi preferencën për të qëndruar:** Kur lëvizet nga grupet me shpenzimet më të ulëta tek ato me shpenzimet më të larta, një përqindje në rritje progresive preferon të qëndrojë: 18% në grupin me shpenzimet më të ulëta dhe 28% në grupin me shpenzimet më të larta (shih Tabelën II Shtojca 4).
- ▶ **Pronësia aktuale e një vend banimi nuk duket të jetë faktor vendimtar:** Ndër ekonomitë familjare që preferojnë të qëndrojnë, 76% e tyre kanë në pronësi vend banimin e tyre aktual. Megjithatë, në mesin e ekonomive familjare që dëshirojnë të kthehen në vendin e tyre të origjinës, 53% e tyre po ashtu kanë në pronësi banesën e tyre aktuale (shih tabelën II Shtojca 4).
- ▶ **Qasja në tregun e punës në vendndodhjen aktuale nuk duket të jetë një faktor vendimtar:** Kur krahasojmë ekonomitë familjare të PZHBV-ve që nuk kanë ndonjë anëtar të familjes të punësuar me ata që kanë të paktën një anëtar të punësuar, përqindje shumë të ngjashme preferojnë të qëndrojnë (20% dhe 24%, respektivisht) dhe të kthehen (61% dhe 64%, respektivisht). Integrimi në tregun e punës në vendndodhjen aktuale së këndejmi nuk ndikon mbi preferencën për të qëndruar apo për tu kthyer. Kjo duhet kuptuar duke marrë parasysh faktin se



Figura 11: Ekonomitë familjare të PZHBV-ve shqiptar të anketuara, të cilat do të konsideronin të qëndrojnë në vendndodhjen aktuale sipas kushtit të favorshëm parësor

shumica e ekonomive familjare të anketuara (67%) janë zhvendosur nga veriu i Mitrovicës në jug të Mitrovicës, gjë që rezulton në udhëtim relativisht më të lehtë deri në vendin e punës (shih tabelën II Shtojca 4).

► **Kohëzgjatja e qëndrimit në lagjen aktuale nuk duket të jetë një faktor vendimtar:** janë hasur përqindje të ngjashme të ekonomive familjare që preferojnë të qëndrojnë apo të kthehen pa marrë parasysh se sa shkurtë apo gjatë familja ka jetuar në vendndodhjen aktuale. Megjithatë, një përqindje relativisht më e madhe (30%), preferon të qëndrojë në mesin e ekonomive familjare që kanë banuar në lagjen e tyre aktuale më shumë se 16 vjet (në krahasim me 18% -22% në mesin e atyre që kanë qëndruar më pak në vendndodhjen e tyre aktuale). Ky konstatim duhet të nuancohet nga reagimet e marra në DFG, ku pjesëmarrësit kanë deklaruar se një nga faktorët që ndikon në vendimin e tyre për tu kthyer është edhe fakti që në qoftë se familja e tyre përbëhet nga fëmijë dhe të rinj të cilët kanë lindur qoftë në vendin e zhvendosjes apo kanë krijuar një rrjet të fortë në vendin e zhvendosjes, dhe të cilët kësaj do të përballëshin me sfida më të mëdha për tu riintegruar në vendin e origjinës.

Konsiderata për të qëndruar apo kthyer nën kushte të caktuara

Në përgjithësi 501 nga 502 e ekonomive familjare të anketuara deklaruan kur i pyetëm se a do të konsideronin të qëndrojnë në vendndodhjen aktuale nëse do të ekzistonin kushte të caktuara, dhe 58% nga ata u përgjigjën pozitivisht. Kushtet për të cilat u referuan ata kryesisht në lidhje me marrjen e një forme të mbështetjes për banim, si dhe një mundësi konkrete të punësimit.

Nga 291 ekonomi familjare që konsiderojnë qëndrimin, 72% kanë në pronësi banesat e tyre. Prandaj nuk është për t'u habitur që faktori i favorshëm për qëndrimin është i lidhur me banimin në 54% të rasteve të kombinuara (që ka të bëjë me rindërtimin e shtëpisë ekzistuese dhe sigurimin e një vend banimi në tokën e tyre).

Përveç faktorëve të përmendur më lart që ndikojnë në vendimin për të qëndruar, përvoja e incidenteve të sigurisë dhe perceptimi i sigurisë në vendin aktual të banimit janë konsideruar gjithashtu në përcaktimin e qëndrueshmërisë të integritetit lokal. Nga ekonomitë familjare të anketuara 1.4% kanë raportuar se kanë përjetuar incidente të sigurisë, siç janë dhuna dhe kërcënimet, brenda 6 muajve para kësaj ankete. Siguria e perceptuar në aspektin e lirisë së lëvizjes është hulumtuar në lidhje me qarkullimin brenda lagjes së tyre




Figura 12: Perceptimi i ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptarë të anketuar mbi sigurinë gjatë lëvizjes nëpër lagje dhe zona më gjërë

dhe më gjerë brenda komunës/zonës. Nga PZHBV-ve të anketuar 92% raportuan se ndjehen shumë të sigurt në nivel lagjeje dhe 87% në nivel komunal dhe komunat përreth.

Eksplorimi i kushteve të prioritizuara për integrim lokal në kombinim me ndjenjën e raportuar të sigurisë, gjatë qarkullimit më të gjerë brenda zonës më të gjerë, mund të japë një tregues të perspektivave të qëndrueshme për integrim lokal. Është vërejtur se në mesin e atyre që do të konsideronin të qëndronin në vendndodhjen aktuale, 138 ekonomi familjare (47% e grupit që konsiderojnë integrimin lokal) e kushtëzojnë këtë me marrjen e mbështetjes së ndërlidhur me banim, ndërsa gjithashtu tregojnë se ndjehen "shumë të sigurt" brenda komunës së tyre dhe atyre përreth.

Në përgjithësi 498 nga 502 ekonomi familjare të anketuara u përgjigjën kur u pyetën të tregojnë se a do të konsideronin kthimin në vendin e origjinës në qoftë se do të ekzistonin kushte të caktuara, dhe 66% nga ata ofruan përgjigje pozitive. Ngjashëm me atë që është vërejtur në lidhje me ata që konsideronin integrimin lokal, faktori kryesor i favorshëm për të konsideruar kthimin është i lidhur me banimin për 80% nga keto 331 ekonomi familjare (që ka të bëjë me kthim, rindërtimin ose sigurimin e një vendi të banimit), ndërsa çështja e

sigurisë është përmendur nga 12% e tyre. Të gjithë pjesëmarrësit DFG po ashtu vlerësuan banimin lartë në mesin e kushteve të nevojshme për ta për të zgjedhur kthimin si zgjidhjen e tyre të preferuar të qëndrueshme.

Nga ekonomite familjare që konsideronin kthimin, 70% e raportuan se kishin vizituar vendin e tyre të origjinës brenda 12 muajve të kaluar. Nga keto 231 ekonomi familjare, 44% e tyre raportuan se kishin diskutuar kthimin e tyre potencial me fqinjët dhe në të shumtën e rasteve (90%) deklaruan se reagimi i fqinjëve ishte pozitiv. Nga këto 92 ekonomi familjare, 58 prej tyre raportuan se kanë një vend banimi në vendin e origjinës dhe se janë të gatshëm të kthehen në qoftë se marrin mbështetje për rindërtim dhe/ose kthimin e tij. Mbi këto baza, duket se ekziston një perspektivë praktike e kthimit në perceptimin e 11% të mostrës së përgjithshme.

Njohja e gjuhës serbe mund të ndikojë në mundësinë e komunikimit me komunitetet në vendin e origjinës pas kthimit, pasi kjo do të ndodhë në zonat me shumicë serbe dhe gjuha shqipe është gjuha amtare e PZHBV-ve të anketuar. U vu re se kjo ndryshonte në masë të madhe në mes të gjeneratave: ku 57% e PZHBV-ve të moshës 32 dhe mbi si dhe 18% e atyre të moshës mes 15 dhe 31 vjeçare raportuan se flasin gjuhën serbe.



Figura 13: Ekonomitë familjare të anketuara të PZHBV-ve shqiptarë që do të konsideronin kthimin në vendin e origjinës sipas kushtit të favorshëm parësor

Plane konkrete për zhvendosje

Nga PZHBV-ve të anketuara, 10% (46 EF) raportuan se kanë bërë plane që të largohen nga vendndodhja aktuale brenda gjashtë muajve të ardhshëm pas anketës. Nga këto ekonomi familjare, 16 prej tyre kanë raportuar se kanë planifikuar të zhvendosen ose brenda lagjes apo komunës së njëjtë ndërsa 19 prej tyre kanë raportuar se janë në proces të kthimit në vendin e origjinës.

Pronësia e banimit aktual nuk duket të jetë një faktor vendimtar, pasi ekonomitë familjare pak a shumë janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në mes të atyre me qera dhe atyre që kanë në pronësi banesën e tyre. Arsyet e raportuara për zhvendosjen e planifikuar kanë të bëjnë kryesisht me "mundësitë më të mira të punësimit" në lokacionin e ri dhe, në një masë më të vogël, me një "shtëpi më të mirë" në lokacionin e ri dhe dëshirën për tu "kthyer në shtëpi" në rast të kthimit në vendin e origjinës. Një ekonomi familjare raportoi dëbimin si arsye të largimit.

GJETJET PËR PZHBV-të ROM, ASHKALI

GJETJET KRYESORE

Të dhënat themelore demografike dhe modeli i zhvendosjes

- ▶ Shkalla e analfabetizmit e raportuar ndër PZHBV-të rom/ashkali/egjiptian të anketuar (18%) është më e lartë se ajo e popullatës së përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane (13%) dhe ajo e popullsisë së përgjithshme të Kosovës (3.85%). Anketa tregon se femrat kanë shkollim më të ulët se burrat në të gjitha grupmoshat.
- ▶ Pjesa e konsiderueshme e individëve të anketuar kanë raportuar se nuk kanë përfunduar asnjë cikël formal të arsimit, përqindja që ka arritur 75% mes popullatës të grup moshës prej 60 vjeçare e më lart.
- ▶ Përafërsisht gjysma e ekonomive familjare të anketuara kanë raportuar se janë zhvendosur nga rajoni i Mitrovicës (33%) dhe nga Prishtina (24%).
- ▶ Totali i 94% i ekonomive familjare të synuara raportuan se janë zhvendosur për herë të në vitin 1999, dhe 71% kanë raportuar se kanë lëvizur të paktën për një herë të dytë pas zhvendosjes origjinale para se të vijnë në vendin e tyre aktual të banimit, 80% e gjithsej tyre kanë jetuar më shumë se 16 vite në lagjen e tyre aktuale dhe 31% e tyre kanë lindur në vendin e zhvendosjes.

Standardi i jetesës

- ▶ Në përgjithësi 39% e ekonomive familjare rome/ashkali/egjiptiane raportuan se kanë në pronësi banesën e tyre aktuale, kundrejt një norme prej 83% në mesin e popullatës së përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane dhe një normë 96% në mesin e popullatës së përgjithshme të Kosovës.
- ▶ Nga ekonomitë familjare të anketuara, 12% banojnë në strehimore të improvizuar, dhe kryesisht janë të vendosur në Gjakovë, Graçanicë, Leposaviq dhe Obiliq. Totali i 17% e vendbanimeve (të vendosura në zonat e Graçanicës dhe Obiliqit) nuk janë të qasshme përmes rrugës së asfaltuar. Në 12% të rasteve, më shumë se një ekonomi familjare ndajnë të njëjtën hapësirë të jetesës. Në përgjithësi 34% e vendbanimeve nuk janë të lidhura me sistemin e kanalizimit dhe 12% nuk kanë ujë të rrjedhshëm.
- ▶ Në mes të popullsisë të anketuar të moshës shkollore paraqitet një normë më të ulët e vijueshmërisë në shkollë sesa tek popullata e përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane dhe tek popullata e përgjithshme e Kosovës në të gjitha nivelet e arsimit, si dhe një hendek gjinor që favorizon djemtë më shumë se vajzat dhe që rritet në mënyre progresive nga arsimit fillor tek arsimit i mesëm.
- ▶ Nga ekonomitë familjare të anketuara, 17% raportuan se kanë pasur vështirësi të qasen kujdesit shëndetësor për shkak të pamundësisë për të mbuluar shpenzimet.

Punësimi dhe cenueshmëria ekonomike

- ▶ Papunësia e raportuar është më e lartë në mesin e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të anketuar (84%) në krahasim me popullatën e përgjithshme të Kosovës (33%), dhe kjo arrin 92% në mesin e grave dhe 87% në mesin e të rinjve.

ALI DHE EGJIPTIAN

- ▶ Nga ekonomitë familjare të anketuara, 67% paraqitën ndihmat sociale si burim i tyre kryesor i të ardhurave (kundrejt normës prej 4% mes popullsisë së përgjithshme të Kosovës), ndërsa 17% paraqitën pagat ose mëditjet (kundrejt normës prej 57% mes popullsisë së përgjithshme të Kosovës).
- ▶ 25 individë të punësuar deklaruan të hyra 162 Euro në muaj mesatarisht, në krahasim me mesataren në Kosovë 300 Euro dhe 400 Euro.
- ▶ Totali i 80% e ekonomive familjare të synuara raportuan se nuk kanë ndonjë anëtar me të ardhura, ndërsa ushqimi përfaqëson mesatarisht 59% të shpenzimeve të përgjithshme mujore (kundrejt mesatares prej 43% për popullsinë e përgjithshme të Kosovës).

Qasja në mekanizmat për kthimin e banesës, tokës dhe pronës

- ▶ Nga ekonomitë familjare PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të anketuar, 38 kanë raportuar se kane lënë pasuritë në vendin e origjinës (31% e totalit), dhe 17 nga ata kanë raportuar se posedojnë dokumentet e pronësisë.
- ▶ Pesë ekonomi familjare kanë raportuar se prona në vendin e tyre të origjinës ishte zënë në mënyrë të paligjshme, ndërsa 19 ekonomi familjare kanë raportuar pronën e tyre si të dëmtuar dhe në nevojë për rindërtim/riparim.
- ▶ Mekanizmat e kthimit të pronës janë në vend, mirëpo vetëm një ekonomi familjare (nga 38 të cilët raportuan se posedojnë pronë në vendin e origjinës) ka raportuar se ka paraqitur kërkesë për kthim të pronës.

Lokacioni i preferuar i banimit

- ▶ Zgjidhja e qëndrueshme e preferuar në lidhje me vendbanimin është integrimi lokal për 99 ekonomi familjare dhe kthimi në vendin e origjinës për gjashtë ekonomi familjare.
- ▶ Përqindjet e ekonomive familjare që do të konsideronin integrimin lokal apo kthimin në qoftë se do të ekzistonin kushte të caktuara janë pothuajse identike (93 dhe pesë ekonomi familjare, respektivisht) me ato që kanë të bëjnë me zgjidhje të qëndrueshme të preferuar pamvarësisht kushteve. Ofrimi i mundësive të punësimit (në 44% të rasteve) ose banimi në tokën komunale (në 27% të rasteve) janë indikuar si kushte të favorshme për integrim lokal; mbështetja në banim është ndikuar nga të gjitha pesë ekonomitë familjare që konsideronin kthimin.

PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Mostra e PZHBV-ve të komunitetit rom/ashkali/egjiptian përbëhet prej 123 ekonomive familjare ose 491 individëve. Ekonomitë familjare të PZHBV-ve të anketuar janë shpërndarë kryesisht në Mitrovicën Jugore (39 ekonomi familjare) dhe në Graçanicë (26 ekonomi familjare) dhe, në një masë më të vogël, në Obiliq (11 ekonomi familjare) dhe në Fushë Kosovë (13 ekonomi familjare) - për një shpërndarje të detajuar të mostrës ju lutem referojuni Tabelës 2 në Kapitullin e hyrjes.

Sa herë që gjetjet përgjatë gjithë këtij kapitulli i referohen një nën-mostre të popullatës së targetuar rom/ashkali/egjiptiane (p.sh. për shkak të atyre të cilët nuk janë përgjigjur), kjo do të tregohet, duke përfshirë edhe madhësinë e nën-mostrës në formë të numrit të ekonomive familjare krahas përqindjeve. Duke pasur parasysh madhësinë e kufizuar të kësaj mostre, disa tema nuk mund të eksplorojnë në po aq detaje sa është bërë me grupet tjera të synuara. Kurdo që nëngrupet e disagreguara/zbërthyer bëhen shumë të vogla për t'u analizuar, vetëm paraqitet numri i ekonomive familjare.

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES

Të dhënat themelore të popullsisë

Piramida e mëposhtme e popullsisë ilustron shpërndarjen sipas moshës dhe gjinisë të PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të anketuar.

Kur krahasohet me popullatën e përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane²⁹ dhe popullsinë e përgjithshme të Kosovës³⁰, del si në vijim:

- ▶ Një përqindje më e ulët e personave të moshës nën pesë vjeç (7% kundrejt 12.2% dhe 8.6%, respektivisht)
- ▶ Përqindje e personave mbi moshën 60 vjeçare (5%) e krahasueshme me popullatën e përgjithshme RAE (6%), por për gjysmë më e vogël se sa përqindja ekuivalente në popullsinë e përgjithshme të Kosovës (10%).

Popullata e anketuar paraqet diversitet të madh në konstelacionet e ekonomive familjare, meqë është gjetur një shpërndarje e drejtë e barabartë e ekonomive familjare në tërë shkallën, nga ekonomitë familjare me një-anëtarë deri tek ekonomitë familjare me 7+ anëtarë. Në harmoni me madhësitë e ndryshme të ekonomive familjare, madhësia mesatare e ekonomisë familjare

29 UNICEF Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo (UNSCR 1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (UNSCR1244). Monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe grave - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014).

30 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

është katër anëtarëshe, ndërsa mesatarja për popullatën e përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane është 5.9³¹.

Anëtarët e ekonomive familjare	PZHBV-të rom/ashkali/egjiptian	Popullsia e përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane
1	16%	4%
2	13%	8%
3	16%	6%
4	16%	9%
5	14%	16%
6	11%	27%
7+	13%	30%
Total	100%	100%

Tabela 16: Shpërndarja e PZHBV-ve të popullsisë rome/ashkali/egjiptiane të anketuar sipas madhësisë së ekonomisë familjare

Nga ekonomitë familjare të anketuara rome/ashkali/egjiptiane, 8% janë gjetur të kenë një femër si kryefamiljar.

Kur merret në konsideratë raporti i varësisë së moshës, PZHBV-të rome/ashkali/egjiptiane të anketuar tregojnë një raport të njëjtë si mesatarja e Kosovës (50%)³². Raporti i varësisë së moshës tregon raportin ndërmjet popullsisë produktive të moshës së punës (15-64 vjeçare), dhe popullsisë të moshës e cila nuk është në moshë të punës (0-14 dhe 65+ vjeçare), të cilët konsiderohen vartës. Sa

31 UNICEF Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo (UNSCR 1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (UNSCR1244). Monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe grave - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014)

32 Anketa e Fuqisë Punëtore 2016 në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës.




Figura 14: Popullsia e PZHBV-ve të anketuar rom/ashkali/egjiptian sipas gjinisë dhe moshës

më i lartë raporti, aq më shumë personat e varur duhet të mbështeten nga anëtarët produktiv të ekonomisë familjare.

Nivelet e shkrim-leximit dhe arsimit

Përqindja e individëve të anketuar mbi moshën 15 vjeçare të cilët kanë deklaruar veten si analfabetë është 18% (13% në mesin e burrave dhe 24% në mesin e grave). Shkalla e analfabetizmit e popullsisë së përgjithshme rom/ashkali/egjiptiane në Kosovë është 13%³³, ndërsa ajo e popullsisë së përgjithshme të Kosovës mbi 10 vjeçe është 3.85%³⁴.

33 UNDP 2016 Human Development Report (Raporti i Zhvillimit Njerëzor), citim i të dhënave të vitit 2014 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

34 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Njëshqyrtim mbi nivelin më të lartë të arsimit të përfunduar nga 282 PZHBV rom/ashkali/egjiptian të grup moshave prej 18 e më lart (nga totali prej 317 në këtë grup moshë në mostër) të cilët kanë ofruar informacione lidhur me këtë çështje shpalos një përqindje të konsiderueshme të individëve të cilët kanë raportuar se nuk kanë pasur një arsimim formal, përqindja e cila rritet nga ajo më e ulëta deri tek më e larta të grup moshave. Duhet marrë parasysh se, një numër i individëve kanë theksuar që kanë vijuar vetëm katër vitet e para të shkollës fillore, dhe ato janë të paraqitura in grafikonet e mëposhtme së bashku me ato të cilët nuk kanë përfunduar një arsimim formal. Në mes të gjithë grup moshave, femrat kanë raportuar nivele më të ulëta të arsimit se meshkujt, me 45% të cilët nuk kanë përfunduar një arsimim formal (kundrejt 41% të meshkujve) dhe 26% të cilët kanë përfunduar shkollën fillore (kundrejt 39% të meshkujve).




Figura 15: Niveli më i lartë i përfunduar i arsimit nga PZHBV-të e anketuar rom/ashkali/egjiptian sipas grupmoshës




Figura 16: Niveli më i lartë i përfunduar i arsimit nga PZHBV-të e anketuar rom/ashkali/egjiptian sipas gjinisë

Modeli i zhvendosjes

PZHBV-të rom/ashkali/egjiptian të sunuar raportuan se kryesisht janë zhvendosur nga rajoni i Mitrovicës (40 ekonomi familjare) dhe nga Prishtina (29 ekonomi familjare); në kohën e anketimit ata ishin kryesisht duke banuar në Mitrovicën Jugore dhe Graçanicë dhe, në një masë më të vogël, në Obiliq dhe Fushë Kosovë (për një pasqyrë të detajuar mbi modelin e zhvendosjes së popullatës të anketuar referojuni Shtojcës 3).

Popullata e anketuar raportuan se kryesisht ishin zhvendosur gjatë vitit 1999 (94%), ndërsa një përqindje e vogël (3%) ishin zhvendosur gjatë vitit 2004. Prandaj pjesa më e madhe e ekonomive familjare kanë jetuar në vendet e zhvendosura për rreth 17 vite, ku 31% e individëve (nga 451 respondentë nga totali 491 në mostër) kanë lindur në vendin e zhvendosjes.

Në total 29% e mostrës kane raportuar se janë zhvendosur drejtpërdrejt në vendin aktual të banimit, ndërsa 56% kanë lëvizur dy-tre herë, 13% kanë lëvizur kater-pese herë dhe 2% kanë lëvizur gjashte herë ose më shumë (të gjitha shifrat përfshijnë lëvizjen origjinale të zhvendosjes). Shumica (80%) nga së PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të ekonomive familjare të cilët kanë jetuar në lagjen e tyre aktuale për më shumë se 16 vite në kohën e shkruarjes.

STANDARDI I JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION

Kushtet e banimit

Nga ekonomitë familjare të anketuara të PZHBV-të rom/ashkali/egjiptian, 67% banojnë në shtëpitë individuale, ndërsa pjesa tjetër banojnë kryesisht në apartamente (14%), si dhe në strehime joformale/të improvizuara (12%) - zgjidhja e fundit është hasur kryesisht në vendet si Gjakovë, Graçanicë, Leposaviq dhe Obiliq.

Pronësia e banimit është mjaft e ndryshme në mesin e popullatës mostër, pasi 39% raportuan se kanë në pronësi vendbanimin e tyre aktual, 30% jetojnë në strehuara pa qira dhe 16% jetojnë me qira. Në mesin e popullsisë së përgjithshme rom/ashkali/egjiptiane në Kosovë, një anëtar i ekonomisë familjare ka në pronësi banesën e tyre në 83% të rasteve³⁵, ndërsa në mesin e popullatës së përgjithshme përqindja është 96%³⁶.

Nga popullata e synuar, 62% banojnë në lokacione urbane dhe 38% në mjedise rurale. Shumica e ekonomive familjare janë lehtësisht të arritshme me rrugë të asfaltuara, me përjashtim të 17% që gjenden në zonat e Obiliqit dhe Graçanicës.

35 UNICEF Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo (UNSCR 1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (UNSCR1244). Monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe grave - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishhtë 2013-2014).

36 Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Ndarja e hapësirës së jetesës nga më shumë se një ekonomi familjare është hasur në 12% të rasteve.

Jo të gjitha banesat kanë pasur energji elektrike. Vështirësi paraqiten sa i përket ujit të rrjedhshëm në 12% e ekonomive familjare dhe qasjes në sistemin e kanalizimit në 34% të rasteve.

	PZHBV-të rom/ ashkali/egjiptian
Ujë i rrjedhshëm	88%
Energji elektrike	96%
Ngrohje	80%
Plin	0%
Sistem të kanalizimit	66%

Tabela 17: Përqindja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV rom/ashkali/egjiptian me qasje të raportuar në shërbimet e radhitura në vendin e banimit të tyre

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Të gëzuarit e një standardi të duhur të jetesës pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur zgjidhje të qëndrueshme gëzojnë, pa diskriminim, një standard adekuat të jetesës, përfshirë së paku strehimin, kujdesin shëndetësor, ushqimin, ujin dhe mjetet tjera të mbijetesës.

Kriteri: Qasja në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme kanë qasje në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për qasje në shërbimet publike, rikthimin e pronës dhe posedimeve, votim apo ndjekjen e qëllimeve tjera të ndërlidhura me zgjidhjet e qëndrueshme.




Figura 17: Pronësia e banimit nga PZHBV-të e anketuar dhe popullsisë së përgjithshme rome/ashkali/egjiptiane

Qasja në arsim

Qasja në arsim është eksploruar në lidhje me vijueshmërinë e rregullt në shkollë (që do të thotë pesë ditë në javë). Tabela e mëposhtme paraqet normat e disagreguara sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë për 106 fëmijë të moshës fillore për të cilët të dhënat janë mbledhur (nga totali 113 në mostër) dhe 38 fëmijë/të rinj të shkollës së mesme, dhe ajo nxjerr në pah:

- ▶ Në përgjithësi norma më të ulëta të vijueshmërisë në mesin e popullatës së anketuar sesa popullata e përgjithshme rom/ashkali/egjiptiane (85% për shkollën fillore, 53% shkollën e mesme³⁷) dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës (98% dhe 91%, respektivisht³⁸).
- ▶ Norma më të ulëta të vijueshmërisë në mesin e vajzave sesa djemve, e shprehur edhe më shumë në shkollën e mesme.

Është raportuar se 70% e fëmijëve vijnë shkollat që ofrojnë kurrikulën në gjuhë serbe dhe 25% vijnë shkollat që ofrojnë kurrikulën në gjuhën shqipe.

	Meshkuj	Femra
Norma e vijueshmërisë në shkollën fillore	75%	66%
Norma e vijueshmërisë në shkollën e mesme	67%	53%

Tabela 18: Normat e vijueshmërisë në shkollë të PZHBV të anketuar rom/ashkali/egjiptian sipas nivelit dhe gjinisë

Qasja në kujdesin shëndetësor

Nga ekonomive familjare të PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të anketuar, 17% raportuan se nuk kanë pasur mundësi të qasen në kujdes shëndetësor kur kanë pasur nevojë. Shumica e këtyre ekonomive familjare jetojnë në zonat rurale. Arsyeja kryesore e raportuar për mos mundësinë për t'u qasur në kujdesin shëndetësor lidhet me mundësinë për t'i përballuar shpenzimet. Sipas një sondazhi të fundit të kënaqshmërisë mbi shërbimet publike të kryer nga UNDP³⁹, popullsia e përgjithshme

37 UNICEF Roma, Ashkali and Egyptian Communities in Kosovo (UNSCR 1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë (UNSCR 1244). Monitorimi i gjendjes së fëmijëve dhe grave - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-2014).

38 E njëjtë.

39 UNDP 2015 Mosaic.

e Kosovës gjithashtu radhitë pamundësinë për t'i përballuar shpenzimet në krye të listës së faktorëve që pengojnë qasjen në kujdesin shëndetësor.

Dokumentacioni personal

Nga mostra e përgjithshme, shtatë individ raportuan se nuk posedonin asnjë formë të dokumentacionit personal.

Një e katërta e PZHBV-e të anketuar rom/ashkali/egjiptian raportuan se nuk posedojnë pasaportë apo Dokument Identifikimi - edhe pse raportuan të posedojnë një certifikatë lindjeje. Nga keta individ 90% ishin nën moshën 14 vjeç dhe raportuan se kishin planifikuar të aplikonin për dokumente personale.

Duhet pasur parasysh se, 60% të individëve në posedim të letërnjoftimeve kanë raportuar se dokumenti është lëshuar nga Kosova, ndërsa 52% i janë lëshuar nga Serbia, çka tregon se një pjesë e popullatës së anketuar është në posedim të dokumenteve të identifikimit të lëshuara nga të dyja Kosova dhe Serbia.

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET

Duke pasur parasysh disponueshmërinë e programeve të mirëqenies publike, aftësia për të përmbushur nevojat socio-ekonomike të PZHBV rom/ashkali/egjiptian është hulumtuar nga perspektiva e qasjes si në tregun e punës ashtu dhe në mirëqenie. Ky kapitull shqyrton qasjen e mostres se synuar në tregun e punës dhe kushtet e punësimit në krahasim me popullsinë e përgjithshme rom/ashkali/egjiptiane të Kosovës dhe/ose popullsinë e përgjithshme të Kosovës, në bazë të disponueshmërisë së burimeve. Gjendja e përgjithshme ekonomike e ekonomive familjare të PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian, duke përfshirë qasjen e tyre në përfitimet sociale, vijon në kapitullin e ardhshëm.

Qasja në punësim

Qasja në punësim është analizuar përmes treguesve të mëposhtëm:

- ▶ Pjesëmarrja e fuqisë punëtore, që do të thotë përqindja e popullsisë në moshë pune ekonomikisht aktive (ata të cilët ose janë duke punuar ose duke kërkuar punë)
- ▶ Shkalla e punësimit, që do të thotë përqindja e popullsisë në moshë pune të cilët janë të punësuar
- ▶ Shkalla e papunësisë, që do të thotë përqindja e fuqisë punëtore që nuk është aktualisht e punësuar dhe është në kërkim për një vend pune

Siç u përmend, të tre treguesit kanë marrë në konsideratë popullsinë e moshës së punës (15-64 vjeç), që për popullatën e PZHBV-ve të anketuar rom/ashkali/egjiptian korrespondon me 329 individë.

Moshë: 15–64			Mashkuj		Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Rom/Ashkali/ Egjiptian	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore		66%		27%	49%	329
	Shkalla e punësimit		12%		2%	8%	329
	Shkalla e papunësisë		82%		92%	84%	161
Popullata e Kosovës	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore		58%		19%	39%	/
	Shkalla e punësimit		43%		13%	28%	/
	Shkalla e papunësisë		26%		32%	28%	/

Tabela 19: Qasja në punësim e PZHBV-ve të anketuar rom/ashkali/egjiptian për grupin e moshës së punës (15-64 vjeç) dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës⁴⁰

40 Kolona "Totali N/Emëruesi" tregon emëruesit të përdorur për përqindjet e llogaritura: për llogaritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallën e punësimit, nën-mostra (emëruesi) relevante përfshinë 329 individë në moshë të punës (15-64 vjeç); për shkallën e papunësisë nën-mostra relevante (emëruesi) përfshinë 161 individë që marrin pjesë në fuqinë punëtore.

Moshë: 15–24			Male		Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Rom/Ashkali/ Egjiptian	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore		40%		29%	35%	85
	Shkalla e punësimit		6%		3%	5%	85
	Shkalla e papunësisë		84%		91%	87%	30
Popullata e Kosovës	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore		39%		18%	33%	/
	Shkalla e punësimit		15%		4%	10%	/
	Shkalla e papunësisë		47%		65%	52%	/

Tabela 20: Qasja në punësim e PZHBV-ve të rinjtë (15-24 vjeç) të anketuar rom/ashkali/egjiptian dhe popullsisë së përgjithshme të Kosovës. Shënim: Numri i vogël i mostrës së të rinjve PZHBV duhet të kihet në mend

Për shkak të numrit të vogël të individëve që janë gjetur të jenë ekonomikisht aktiv, analiza nuk mund të shkojë përtej statistikave themelore, dhe të eksplorojë detaje rreth asaj se çka karakterizon të punësuarit dhe të papunët.

Sipas treguesve të tabelës me poshte, përdërisa pjesëmarrja në fuqinë punëtore e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian është më e lartë se ajo e popullsisë së përgjithshme të Kosovës⁴¹, një përqindje shumë më e lartë prej tyre nuk janë në gjendje të gjejnë punësim.

Duke marrë parasysh të rinjtë (të moshës 15-24; 85 individë në mostër), si pjesëmarrja në fuqinë punëtore edhe shkalla e papunësisë është dukshëm më e lartë se sa në mesin e popullatës së përgjithshme në Kosovë, posaçërisht në raport me gratë.

Aranzimet e punësimit dhe sektori

Numri faktik i individëve nga mostra e PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian të cilët kanë raportuar se janë të punësuar në kohën e anketës është 25 nga 329 personat e moshës së punës. Prandaj, nuk është e mundur të kryhet një analizë kuptimplote statistikore e këtij grupi në lidhje me aranzhimet dhe kushtet e tyre të punës. Megjithatë, në lidhje me 25 të punësuarit mund të theksohet si në vijim:

- ▶ Ata janë pak a shumë të shpërndarë në mënyrë të barabartë mes atyre me orar të plotë, me kohë të pjesshme, punë sezonale dhe punësim të rastit.
- ▶ Ata janë të angazhuar në sektorin publik dhe në sektorin privat.
- ▶ Paga mesatare mujore e raportuar është 162 euro, ndërsa paga mesatare mujore në Kosovë është ndërmjet 300 dhe 400 euro⁴².
- ▶ Në përgjithësi nëntë persona raportuan se kanë një kontratë të shkruar.

41 Anketa e Fuqisë Punëtore 2016 në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

42 Anketa e Fuqisë Punëtore 2016 në Kosovë, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Qasja në mjetet e jetesës dhe punësim

Punësimi dhe jetesa në dispozicion për PZHBV-të duhet të lejojë që ata të përmbushin të paktën nevojat e tyre kryesore socio-ekonomike.

Kush janë të papunët?

Ndërsa popullsia e papunë tashmë është hulumtuar duke shqyrtuar karakteristikat kryesore të të dhënave demografike, siç janë gjinia dhe mosha, këtu ajo eksplorohehet më tej sipas niveleve të arsimit, duke lejuar nxjerrjen e konkluzioneve të mëposhtme:

- ▶ Shkalla e përgjithshme e papunësisë është jashtëzakonisht e lartë, si në mesin e popullsisë së përgjithshme në moshë pune (84%) po ashtu në mesin e të rinjve (87%).
- ▶ PZHBV-të gra rom/ashkali/egjiptiane kanë shkallë më të lartë të papunësisë sesa meshkujt, me 10 pikë përqindje në mesin e popullatës së përgjithshme në moshë pune (92% dhe 82%, respektivisht) dhe me shtatë pikë përqindje në mesin e të rinjve (91% dhe 84%, respektivisht).
- ▶ Shkalla e papunësisë në mesin e personave me nivele të ndryshme të arsimit (fillor dhe shkollë të mesme) nuk ndryshon dukshëm, ku kualifikimi më i lartë arsimor nga shumica e popullsisë në moshë pune është diploma e shkollës fillore.

Përveç analizës së mësipërme, 76% e të papunëve kanë raportuar se nuk janë regjistruar në ndonjë zyrë të papunësuarve.

Së fundi, është hulumtuar perceptimi i të papunësuarve për arsyet kryesore që ata nuk kanë gjetur punësim, ku 48% e të anketuarve si arsye kanë përmendur se "ka tepër njerëz që janë në kërkim të një vendi pune", 23% kanë treguar se 'arsimimi/kualifikimi i tyre nuk korrespondon me vendet e punës në dispozicion' (në përputhje me të gjeturat në nivelet e ulëta të arsimimit të vërejtura), dhe 15% ia atribuojnë atë 'mungesës së lidhjeve personale'.

GJENDJA EKONOMIKE

Gjendja ekonomike e PZHBV ekonomive familjare të synuara rom/ashkali/egjiptiane është hulumtuar duke shikuar në burimet kryesore e të ardhurave, si dhe në shpenzimet e tyre.

Burimet e të ardhurave

Të anketuarve ju është kërkuar të listojnë burimin më të rëndësishëm dhe burimin e dytë më të rëndësishëm të të ardhurave për ekonomitë familjare të tyre. Sipas tabelës më poshtë, 67% e ekonomive familjare të PZHBV rom/ashkali/egjiptian raportuan se mbështeten kryesisht në përfitime sociale, kundrejt 4% në mesin e popullatës së përgjithshme të Kosovës, ndërsa pagat ose mëditjet janë treguar si burim primar i të ardhurave nga 17% të ekonomive familjare të anketuara (kundrejt 57% nga popullsia e përgjithshme), ku dy herë më shumë (11% kundrejt 6%) u janë referuar mëditjeve të parregullta në krahasim me pagat⁴³.

43 Të gjitha të dhënat mbi popullsinë e përgjithshme të Kosovës janë marrë nga Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

	PZHBV rom/ashkali/ egjiptian	Popullsia e përgjithshme e Kosovës
Pagat	6%	51%
Rrogat e parregullta (të ardhurat nga aktivitete të përkohshme)	11%	6%
Bujqësia	0%	5%
Fitimet nga biznesi (përfshirë ndërmarrjet e EF)	1%	11%
Pensionet	9%	11%
Përfitime sociale	67%	4%
Remitancat	0%	8%
Të tjera	1%	4%
Nuk ka burim të ardhurave	7%	0%

Tabela 21: Burimi kryesor i të ardhurave për ekonomitë familjare - PZHBV të anketuar rom/ashkali/egjiptian në krahasim me popullsinë e përgjithshme të Kosovës

Në përputhje me mbështetjen e fortë në përfitimet sociale dhe shkallët e larta të papunësisë të paraqitura më parë, është vënë re se pak më shumë se 80% e ekonomive familjare të PZHBV rom/ashkali/egjiptian të anketuar nuk kishin anëtar me të ardhura, kurse vetëm pak mbi 16% kanë raportuar që kanë një anëtar të punësuar dhe vetëm pak mbi 3% kanë raportuar se kanë dy anëtarë të punësuar.




Figura 18: Përqindjet e ekonomive familjare të zhvendosura dhe të anketuara PZHBV rom/ashkali/egjiptian sipas numrit të anëtarëve të punësuar

Shpenzimet

Roma/Ashkali/Egyptian IDPs reported spending a monthly average of EUR 258 per household⁴⁴ and a monthly average of EUR 79 per person⁴⁵. The general Kosovo population average for the latter is EUR 119⁴⁶.

Nëse shikojmë përqindjen e shpenzimeve mujore dedikuar për ushqim, e cila është një përcaktues i fleksibilitetit ekonomik, është vënë re një normë mesatare prej 59% për popullatën e anketuar, kundrejt mesatares prej 42% të llogaritur për popullsinë e përgjithshme të

44 Qiraja nuk përfshihet në shpenzimet e përgjithshme pasi që vetëm disa ekonomi familjare kanë raportuar që i paguajnë ato, e cila do të mund të shtrembëronte totalin. Ekonomitë familjare të PZHBV-ve rom/ashkali/egjiptian që raportuan se paguajnë qiranë paraqesin një kosto mesatare mujore prej 60 Euro.

45 Kur llogariten shpenzimet mesatare është e rëndësishme që të silllet vëmendja në konceptin e devijimit standard (sasia që shpreh se për sa pjestarët e një grupi dallojnë nga vlera mesatare për grupin; sa më të shpërndara të dhënat, devijimi më i lartë). Devijimi standard në këtë rast është 110 Euro, që është afër mesatares (79 Euro). Kjo zbulon se shtrirja e shpenzimeve për kokë banori ndryshon në masë të madhe, duke aluduar kështu në gjendje mjaft të ndryshme ekonomike, siç shqyrtohet në seksionin pasues.

46 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Kosovës për statistika. (Qiraja përfshihet këtu në shpenzimet e banimit, por është raportuar të përbëjë një shpenzim vetëm për një pakicë të vogël të popullsisë. Prandaj kjo nuk pritet të ndikojë mesataren e popullsisë).

Kosovës⁴⁷. Sa më i lartë të jetë raporti i ushqimit aq më pak fleksibilitet ekonomik pritet të ketë ekonomia familjare.

Strategjitë e përbaljes ekonomike

Ekonomitë familjare janë pyetur edhe për perceptimin vetanak të gjendjes së tyre ekonomike, duke shikuar në atë nëse ata kishin sfida të paguajnë qiranë ose në përgjithësi për të përmbushur nevojat themelore. Nga 16% të PZHBV rom/ ashkali / egjiptian që banonin me qira, 83% raportuan se u është dashur të marrin hua në gjashtë muajt e kaluar për të paguar qiranë. Përmbushja e nevojave themelore është raportuar të jetë sfidë nga përafërsisht 44% e ekonomive familjare të synuara. Në total 56% e ketyre ekonomive familjare tregun se mekanizmi kryesor i zgjedhur për përbalimin është 'huamarrja nga miqtë / të afërmit apo nga anëtarë të tjerë të bashkësisë', përderisa 22% kanë indikuar 'përpiqemi për të gjetur punë shtesë'.

47 Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2016, Agjencia e Kosovës për statistika.




Figura 19: Gjithsej shpenzimet mujore për kokë banori të PZHBV të anketuar rom/ashkali/egjiptian – të paraqitura sipas llojit në euro dhe si përqindje e totalit për kokë banori

QASJA NË MEKANIZMAT PËR KTHIMIN E BANESËS, TOKËS DHE PRONËS

Në Kosovë kthimi i pronës menaxhohet nga Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, e cila është e mandatar për pranimin, përpunimin dhe zgjidhjen e kërkesave që lidhen me pronat e paluajtshme. Lloji i pronës i zotëruar në vendin e origjinës nga ana e popullatës së anketuar, si dhe niveli i qasjes në to, janë hulumtuar në vijim.

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës

Nga të synuarit e ekonomive familjare të PZHBV rom/ashkali/egjiptian, 31% (38 ekonomi familjare) kanë raportuar se posedojnë të paktën një pasuri në vendin e origjinës. Për shumicën (21 ekonomi familjare) kjo është banesa.

Totali i 17 nga 38 ekonomi familjare të cilët raportuan se e kanë lene pronën në vendin e tyre të origjinës deklaruan se i kanë dokumentet e pronësisë, dhe një ekonomi familjare raportoi se e kanë bërë kërkesën për rimarrje. Nuk është marrë ndonjë informatë nëse kërkesa është pranuar ose për arsyen e 16 ekonomive familjare tjera të cilat nuk kanë kryer kërkesë për rimarrje.

	Numri (EF)	Përqindja e mostrës së përgjithshme (123 EF)
EF me asete (një ose më shumë) në vendin e origjinës	38	31% nga totali i mostrës 123 EF
EF me dokumente të pronësisë	17	45% nga totali i 38 EF të cilët posedojnë pronë

Tabela 22: Posedimi i pronave në vendin e origjinës dhe i dokumenteve të pronësisë sic u raportua nga PZHBV të anketuar rom/ashkali/egjiptian të ekonomive familjare (EF)

Në mesin e ekonomive familjare të cilat kanë raportuar gjendjen e pasurive të mbetura në vendin e origjinës (24 në përgjithësi), pesë ekonomi familjare kanë raportuar pronën e tyre si të uzurpuar, ndërsa 19 ekonomi familjare kanë raportuar pronën e tyre si të dëmtuar dhe në nevojë për rindërtim/riparim.

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: mekanizmat efektiv dhe të arritshëm për rikthimin e banesës, tokës dhe pronës

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme kanë qasje në mekanizmat efektiv për rikthimin me kohë të banesës, tokës dhe pronës së tyre, pavarësisht nëse ata kthehen apo zgjedhin të integrohen në nivel lokal apo të vendosen diku tjetër në vend.

Procesi përmes të cilit kryhet rikthimi i banesës, tokës dhe pronës si dhe kompensimi i ndërlidhur mund të jetë kompleks dhe të konsumoj shumë kohë. Jo domosdoshmërisht duhet që ky proces të përfundoj plotësisht para se të mund të thuhet se PZHBV-të kanë gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Faktor përcaktues është se ata kanë qasje në një mekanizëm efektiv dhe të arritshëm për rikthimin dhe kompensimin e pronave (duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, ndihmën ligjore falas) dhe të kenë mundësi që të banojnë në mënyrë të sigurt gjatë kësaj periudhe të përkohshme.

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT

Hyrje

Ky kapitull shqyrton planet dhe qëllimet e PZHBV-ve të anketuar rom / ashkali/ egjiptian në lidhje me zgjidhjen e tyre të qëndrueshme të preferuar sa i përket vendndodhjes së banimit në të ardhmen, në bazë të tri opsioneve të marra në konsideratë nga Korniza e IASC:

- ▶ **Kthimi në vendin e origjinës**
- ▶ **Integrimi në vendin e zhvendosjes (vendndodhja aktuale)**
- ▶ **Vendbanim në një vend të tretë (brenda apo jashtë Kosovës)**

Sipas Kornizës së IASC, vetëm një lëvizje e thjeshtë fizike, nuk përbën në vetvete një zgjidhje të qëndrueshme. Prandaj këto tri shtigje për zgjidhje të qëndrueshme duhet të udhëhiqen nga parimet themelore dhe kriteret e përcaktuara në Kornizë, të cilat mund të përdoren për përcaktimin e shkallës në të cilën është arritur një zgjidhje e qëndrueshme.

Gjithashtu duhet mbajtur në mend se këto vendime dhe qëllimet që kanë të bëjnë me vendndodhjen e vendbanimit nuk janë bërë në vakum, por janë të ndërthurura ngushtë me faktorët tjerë vendimtarë siç janë punësimi dhe mundësitë në arsimim, qasja në pronë, fleksibiliteti ekonomik, marrëdhëniet e komunitetit dhe perceptimet mbi qetësinë dhe sigurinë.

Anketa e profilizimit dhe DFG i janë qasur temës së qëllimeve dhe planeve për të ardhmen nga tri perspektiva, duke pyetur ekonomitë familjare:

- ▶ Cili ishte opsioni i tyre i preferuar për vendndodhjen e përhershme të qëndrimit;
- ▶ Cilat kushte ata i konsideronin të nevojshme për t'u kthyer apo integruar në nivel lokal, dhe si i prioritozonin ato;
- ▶ Nëse ata tashmë kishin plane konkrete për ta ndërruar vendin e tyre të banimit brenda gjashtë muajve të ardhshëm.

Duke shikuar në konsideratat për vendndodhjen e ardhshme të banimit, është me rëndësi të theksohet se të gjitha ekonomitë familjare janë pyetur nëse do të konsideronin të qëndronin, si dhe nëse do të merrnin

në konsideratë kthimin nën kushte të caktuara; kjo do të thotë se ekonomitë familjare mund t'i marrin në konsideratë të dy opsionet, dhe se njëri nuk përjashton tjetrin.

Zgjidhja e qëndrueshme e preferuar pavarësisht kushteve

Ekonomitë familjare të anketuara PZHBV roma/ashkali/ egjiptian janë pyetur në lidhje me vendndodhjen e tyre të preferuar të vendbanimit, pavarësisht kushteve. Ata kanë ofruar këto përgjigje si në vijim:

- ▶ Integrimi lokal në vendin e zhvendosjes - 99 ekonomi familjare (80%)
- ▶ Kthimi në vendin e origjinës - gjashtë ekonomi familjare
- ▶ Zhvendosja në një vend të tretë brenda Kosovës - dy ekonomi familjare
- ▶ Zhvendosja jashtë Kosovës - nëntë ekonomi familjare

Konsiderata për tu kthyer apo qëndruar nën kushte të caktuara

Nga ekonomive familjare të anketuara, 76% (93 ekonomi familjare) do të konsideronin mbetjen në vendndodhjen e tanishme, nëse kushtet e caktuara do të plotësohen. Me thellësisht, 44% prej tyre i kanë prioritarizuar mundësitë e punësimit (këto 41 ekonomi familjare kryesisht ose kishin në pronësi banesat e tyre të tanishme ose ishin strehuar falas) dhe 27% kanë prioritarizuar ofrimin e banimit në tokën komunale (kryesisht këto 25 ekonomi familjare ose banonin me qira ose ishin të strehuara falas). Duhet të theksohet se marrja në konsideratë e qëndrimit në vendndodhjen e tanishme nuk do të thotë domosdoshmërisht qëndrim në banesën e tanishme por më saktë mbetjen në lokacionin e njëjtë.

Përveç faktorëve të përmendur më lartë të punësimit dhe banimit që ndikojnë në vendimin për të qëndruar, përvoja e incidenteve të sigurisë dhe perceptimi i sigurisë në vendin aktual të banimit janë konsideruar gjithashtu në përcaktimin e qëndrueshmërisë së integrimit lokal. Nga ekonomitë familjare të anketuara, 5% kanë raportuar të kenë përjetuar incidente të sigurisë, të tilla si dhuna dhe kërcënime, brenda gjashtë muajve para anketës. Siguria e perceptuar në kuptim të lirisë së lëvizjes është hulumtuar

në lidhje me qarkullimin brenda vetë lagjes dhe më gjerë brenda komunës dhe komunave në rrethinë. Siguria e perceptuar është vlerësuar lartë nga rreth një e treta e të anketuarve, si në nivel të lagjes ashtu edhe në nivel më të gjërë, ndërsa përafërsisht dy të tretat kanë raportuar se ndihen mesatarisht të sigurt. Duhet të theksohet se ky grup i fundit i të anketuarve janë të shpërndarë nëpër shumicën e komunave të synuara, domethënë: Fushë Kosovë, Graçanicë, Kamenicë, Lipjan, Mitrovicë Jugu, Obiliq, Shtërpçë dhe Zveçan.

Kohëzgjatja e qëndrimit në vendndodhjen e tanishme mund të ndikojë gjithashtu në konsideratën për t'u integruar në nivel lokal. Është vërejtur se 83% (78 ekonomi familjare) e ekonomive familjare të cilat do të konsideronin integrimin lokal, kanë jetuar më shumë se 16 vjet në vendndodhjen e tanishme.

Nga 121 ekonomi familjare të cilët kanë theksuar se a do të konsideronin kthimin në vendin e origjinës, pesë u përgjigjën në mënyrë pozitive. Kushtet e treguara si të favorshme kishin të bënin me ndonjë lloj të mbështetjes së banimit.




Figura 20: Ndjenja e raportuar e sigurisë e PZHBV të anketuar rom/ashkali/egjiptian, kur lëvizin në lagje dhe zonën më gjerë

GJETJET MBI PZHBV-të SERB

GJETJET KYQE

Të dhënat themelore demografike dhe modeli i zhvendosjes

- ▶ Në mesin PZHBV-ve serbë që jetojnë në qendra kolektive, 30% e meshkujve dhe 37% e femrave janë mbi 60 vjeç në kohën e intervistimit.
- ▶ Totali i 43% e ekonomive familjare në qendrat kolektive dhe 28% e ekonomive familjare në banesa private janë me kryefamiljare femra.
- ▶ Pjesa më e madhe e PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private banojnë në zonat e Graçanicës, jug të Mitrovicës, Shtërpcë dhe Zvečan, dhe kanë raportuar se janë zhvendosur kryesisht nga zonat e Ferizaj, jugu i Mitrovicës, Obiliq, Prishtinë dhe Vushtrri. Shumica e të PZHBV-ve serbë të anketuar në qendrat kolektive banojnë në zonat e Leposaviqit, Shtërpcës dhe Zubin Potokut, dhe kanë raportuar se janë zhvendosur kryesisht nga zonat e Ferizajit dhe Prizrenit.
- ▶ Në total 88% e ekonomive familjare të PZHBV të anketuar në banesa private dhe 92% e atyre në qendra kolektive kanë raportuar të jenë zhvendosur për herë të parë në vitin 1999. Në përgjithësi, 15% e PZHBV në banesa private dhe 9% e PZHBV në qendra kolektive kanë lindur në këtë mënyrë në kushte të zhvendosjes. Shumica e ekonomive familjare (71% dhe 78% respektivisht) kanë raportuar që kanë jetuar më shumë se 16 vjet në lagjen e tyre të tanishme në kohën e raportimit.

Standardi i jetesës

- ▶ Nga PZHBV të anketuar serbë në banesa private, 33% raportuan të kenë në pronësi banesat e tyre aktuale, ndërkohë që të gjithë banorët e qendrës kolektive janë të strehuar pa qera në ndërtesa që në mesatare paraqesin sfida më të mëdha se sa shtëpitë private: 27% e ekonomive familjare në qendra kolektive nuk kanë ujë të rrjedhshëm dhe një përqindje e barabartë nuk janë të lidhur me sistemin e kanalizimit.
- ▶ Në total 12% e ekonomive familjare të anketuara në banesa private dhe 42% e atyre në qendrat kolektive raportuan se kanë problem për t'u qasur në kujdesin shëndetësor.

Punësimi dhe cenueshmëria ekonomike

- ▶ Shkallët e papunësisë janë 48% në mesin e PZHBV në banesa private (duke arritur 71% në mesin e të rinjve) dhe 62% në mesin e banorëve të qendrës kolektive.
- ▶ Pagat janë raportuar si burimi kryesor i të ardhurave nga 57% e PZHBV të anketuar serbë në banesa private dhe 17% e banorëve në qendra kolektive. Përfitimet sociale janë raportuar si burim kryesor i të ardhurave nga 13% të ekonomive familjare në banesa private dhe 27% e atyre në qendra kolektive.
- ▶ Në total prej 66% të individëve të punësuar me banim në banesa private dhe 82% e tyre në qendra kolektive kanë raportuar të ardhura mujore në shumë prej 300 EUR ose më pak; për 42% të individëve të punësuar me banim në banesa private, rrogat e tyre janë në shumë prej 150 EUR.
- ▶ Totali i 40% e ekonomive familjare në banesa private dhe 70% e ekonomive familjare në qendrat kolektive deklaruan që nuk kanë asnjë anëtar me të ardhura.

Qasja në mekanizmat e kthimit të banesës, tokës dhe pronës

- ▶ Në total 72% e ekonomive familjare të PZHBV-ve serb në banesa private dhe 47% e atyre në qendra kolektive raportuan se kanë lënë pasuri në vendin e tyre të origjinës. Nga këto, 93% dhe 86%, respektivisht, kanë raportuar të jenë në posedim të dokumenteve relevante pronësore.
- ▶ Në total 363 ekonomi familjare raportuan se prona e tyre në vendin e origjinës ishte uzurpuar, ndërkohë që 295 ekonomi familjare raportuan se prona e tyre ishte e dëmtuar dhe në nevojë për rindërtim / riparime.
- ▶ Mekanizmat e kthimit të pronave ekzistojnë dhe 68% e ekonomive familjare të PZHBV në banesa private dhe 23% e atyre në qendrat kolektive (në të dyja rastet nga grupi me pasuri të lëna prapa) kanë parashtruar kërkesa për kthim të pronës. Një total prej 11 kërkesash janë raportuar si të zbatuara, ku ekonomitë familjare kanë rimarrë pronat e tyre.

Lokacioni i preferuar i banimit

- ▶ Zgjidhja e preferueshme e qëndrueshme e raportuar në lidhje me vendin e banimit është integrimi lokal për 95% të ekonomive familjare në banesa private dhe 84% të atyre në qendra kolektive.
- ▶ Në total 83% dhe 91%, respektivisht, do ta konsideronin integrimin lokal si një zgjidhje e qëndrueshme kryesisht nëse do të ofrohej banim në tokën komunale (për 43% dhe 84% apo të anketuarve në grupet përkatëse). Në total 38 ekonomi familjare (5% nga totali i mostrës së PZHBV serbe) do të konsideronin kthimin një zgjidhje të qëndrueshme.

PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Mostra e PZHBV-ve serb është ndarë në dy nëngrupe sipas llojit të akomodimit në mënyrë që të kapen dallimet midis atyre që banojnë në banesë private dhe atyre që banojnë në qendrat kolektive.

Mostra e PZHBV-ve serbë në banesa private përbëhet nga 567 ekonomi familjare ose 1,907 individë. Mostra është e shpërndarë kryesisht në vendet si në vijim: Graçanicë (146 ekonomi familjare), veri i Mitrovicës (130 ekonomi familjare), Shtërpçë (75 ekonomi familjare) dhe Zveçan (145 ekonomi familjare) - për një shpërndarje të detajuar të mostrës referohuni në tabelën 2 në kapitullin e hyrjes. Mostra e ekonomive familjare të PZHBV që banojnë në banesa private është e shpërndarë më tutje në mes të dy shtresave gjeografike për të lejuar për një krahasim brenda grupit. Shtresa A përfshin katër komuna të veriut dhe shtresa B përfshin të gjitha komunat tjera. Janë aplikuar ponderimet në këto dy shtresa kur janë përdorur si mostër e përgjithshme e PZHBV-ve serbë në banesa private.

Mostra e të PZHBV serbë në qendrat kolektive përbëhet nga 135 ekonomi familjare ose 285 individë. Mostra është shpërndarë kryesisht në vendet si në vijim: Leposaviq (24 ekonomi familjare), Shtërpçë (87 ekonomi familjare) dhe Zubin Potok (14 ekonomi familjare). Duke pasur parasysh madhësinë e kufizuar të mostrës në qendra kolektive, disa tema nuk mund të hulumtohen në po aq detaje siç bëhet për PZHBV-të në banesa private. Kurdo që nëngrupet e disagreguara bëhen shumë të vogla, vetëm numri i ekonomive familjare paraqitet.

Për një shpërndarje të detajuar gjeografike të mostrës, referohuni në tabelën 2 në kapitullin e hyrjes. Kurdo që gjetjet rrjedhin nga një nën-mostër në ndonjë nga tre grupet e përshkruara më lart (PZHBV-të në një banesë private në shtresën A, PZHBV-të në banesë private në shtresën B, PZHBV-të në qendra kolektive), kjo do të tregohet, duke përfshirë madhësinë e nën-mostrës në formë të numrit të ekonomive familjare si shtese me përqindje.

TË DHËNAT THEMELORE DEMOGRAFIKE DHE MODELI I ZHVENDOSJES

Të dhënat themelore të popullsisë

Piramidat e mëposhtme të popullsisë ilustrojnë shpërndarjen sipas moshës dhe gjinisë të PZHBV-ve serbë të anketuar.

PZHBV serbë në banesa private dhe qendra kolektive tregojnë piramida të popullsisë shumë të ndryshme. Përderisa e para tregon një shpërndarje më të rregullt të popullsisë, e fundit ka një përqindje shumë të madhe të personave mbi 60 vjet (30% e meshkujve dhe 37% e femrave).

Madhësia mesatare e familjes është 3.3 anëtarë në mesin e PZHBV që jetojnë në banesa private dhe 2.1 në mesin e atyre që jetojnë në qendrat kolektive.

Anëtarët e ekonomisë familjare	PZHBV BP	PZHBV QK
1	13%	41%
2	18%	27%
3	21%	15%
4	26%	12%
5	13%	4%
6	6%	1%
7+	2%	0%
Gjithsej	100%	100%

Tabela 23: Shpërndarja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV serbë në banesa private (BP) dhe qendra kolektive (QK) sipas madhësisë




Figura 21: Popullsia e anketuar serbe PZHBV në banesa private sipas moshës dhe gjinisë




Figura 22: Popullsia e anketuar serbe PZHBV në qendrat kolektive sipas moshës dhe gjinisë

Përqindja e ekonomive familjare me femra kryefamiljare është 43% në mesin e banorëve të qendrës kolektive dhe 28% në mesin e atyre në banesa private.

Kur merret parasysh raporti i varësisë së moshës, PZHBV serbë në banesa private tregojnë një raport prej 33%, ndërsa ai i PZHBV serbë në qendra kolektive është 50%. Kjo pasqyron faktin se ekonomitë familjare në qendrat kolektive përbëjnë një pjesë relativisht të madhe të personave të moshës mbi 64 vjeç. Raporti i varësisë së moshës tregon raportin midis popullsisë produktive në moshë pune (15-64 vjeç), dhe të popullsisë jo në moshë pune (0-14 dhe 65+ vjeç) të cilët konsiderohen si të varur. Sa më i lartë që është raporti, aq më shumë persona të varur duhet të mbështeten nga anëtarët produktiv të ekonomisë familjare.

Nivelet e shkrim leximit dhe edukimit

Proporcionet e individëve të anketuar mbi 15 vjeç, të cilët janë deklaruar analfabet është 1% në mesin e PZHBV serbë në banesa private (të gjitha femra) dhe 3% në mesin e banorëve të qendrës kolektive (pa dallim në mes meshkujve dhe femrave).

Një rishikim i shkallës me nivel më të lartë të arsimimit paraqiti se, në të gjitha grupmoshat, shumica e 1,785 individëve përmbi 18 vjeç (nga totali 1,808 në këtë grupmoshë nga mostra) të cilët ofruan informatë në këtë




Figura 23: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV-të e anketuar serbë në banesa private sipas grup-moshës




Figura 24: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV-të e anketuar serbë në qendra kolektive sipas grup-moshës

lëmi raportuan se kanë se paku një diplomë të shkollës së mesme, vecanërisht në popullatë e cila banon në banesa private, dhe më shumë është e shprehur në mesin e brezit të ri. Në ekonomitë familjare në banesa private ashtu dhe në qendra kolektive, femrat kanë arritur nivël më të ulët të arsimit se mashkujt. Duhet të theksohet se një numër i të anketuarve nga të dyja grupet kanë raportuar se kanë kompletuar vetëm katër klasat e para të arsimit fillor. Përqindjet e paraqitura përfshijnë të anketuarit që kanë raportuar se nuk kanë kryer asnjë cikël të arsimit përfshin këta individ.

Modeli i zhvendosjes

Shumica e PZHBV të anketuar serbë në banesa private banojnë në rajonin e Graçanicës, veri të Mitrovicës, Shtërpçës dhe Zveçanit, dhe kanë raportuar se janë zhvendosur kryesisht nga rajoni i Ferizajt, jugu i Mitrovicës, Obiliqi, Prishtina dhe Vushtrria. Shumica e PZHBV-ve të anketuar serbë në qendrat kolektive banojnë në zonat e Leposaviqit, Shtërpçës dhe Zubin Potokut, dhe kanë raportuar se janë zhvendosur kryesisht nga zonat e Ferizajit dhe Prizrenit (për një pasqyrë të detajuar të modelit të zhvendosjes së popullatës së anketuar referojuni Shtojcës 3).




Figura 25: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV e anketuar serbë në banesa private sipas gjinisë




Figura 26: Niveli më i lartë arsimor i përfunduar nga PZHBV e anketuar serbë në qendra kolektive sipas gjinisë

Të gjitha ekonomitë familjare PZHBV-ve serbë të anketuara përpos dy ofruan informatë për vitin e zhvendosjes së tyre origjinale. Pjesa më e madhe e tyre kanë raportuar të jenë zhvendosur në vitin 1999, me 12% të PZHBV-ve në banesa private dhe 8% e atyre në qendrat kolektive kanë raportuar të jenë zhvendosur në vitin 2004. Pjesa më e madhe e të gjitha ekonomive familjare kanë jetuar si të zhvendosur për rreth 17 vjet, me 15% të PZHBV-ve në banesa private (nga 1,820 responentë nga totali 1,907 në mostër) dhe 9% të banorëve në qendra kolektive (nga 276 responentë nga totali 285 në mostër) të lindur në kushte të zhvendosjes.

Ngjashëm, të gjitha ekonomitë familjare PZHBV-ve serbë të anketuara përpos dy ofruan informatë për numrin e herave që janë zhvendosur nga hera e parë. Në total 25% nga ata në banesa private dhe 33% nga ata të qendrës kolektive raportuan se janë zhvendosur direkt në vendin aktual të banimit, përderisa 68% dhe 58%, respektivisht, raportuan se janë zhvendosur një ose dy herë pas zhvendosjes së parë. Kështuqë, 71% e PZHBV-ve në banesa private dhe 78% e atyre në qendrat kolektive kanë jetuar në këtë mënyrë më shumë se 16 vjet në lagjen e tyre aktuale në kohën e shkruarjes.

STANDARDI JETESËS DHE QASJA NË DOKUMENTACION

Kushtet e banimit

Nga PZHBV-ve të e anketuar serbë në banesa private, 51% banojnë në shtëpi individuale, ndërsa shumica e mbetur (43%) banojnë në apartamente. Nga PZHBV-ve në banesa private, 33% raportuan se kanë në pronësi shtëpinë e tyre aktuale, 31% banojnë pa pagesë, ndërsa pjesa e mbetur kryesisht me qira (26%). Të gjithë banorët e anketuar në qendrën kolektive banojnë pa-pagesë.

PZHBV-të e anketuar serbë në banesa private janë të shpërndarë midis zonave urbane (63%) dhe zonave rurale (37%). PZHBV-të e anketuar në qendrën kolektive janë të vendosur kryesisht në vende rurale, me 17% të ekonomive familjare në zonat urbane. PZHBV-të në banesa private të gjithë banojnë në banesa me mure të forta, ndërsa 17% e banorëve të qendrës kolektive jetojnë në ndërtime të varfra të improvizuara (këta ishin të vendosur në Zubin Potok dhe Graçanicë).




Figura 27: Kohëzgjatja e qëndrimit të PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private (BP) dhe qendra kolektive (QK) në lagjen e tanishme

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Të gëzuarit e një standardi të duhur të jetesës pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme gëzojnë, pa diskriminim, një standard adekuat të jetesës, përfshirë së paku strehimin, kujdesin shëndetësor, ushqimin, ujin dhe mjetet tjera të mbijetesës

Kriteri: Qasja në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër pa diskriminim

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme kanë qasje në dokumentacionin personal dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm për qasje në shërbimet publike, rikthimin e pronës dhe posedimeve, votim apo ndjekjen e qëllimeve tjera të ndërlidhura me zgjidhjet e qëndrueshme.

Jo të gjithë PZHBV-të serbë në banesa private kanë qasje në ujë të rrjedhshëm dhe energji elektrike, ose janë të lidhur me sistemin e kanalizimit. Kushte më sfiduese janë vërejtur në raport me banorët e qendrës kolektive, ku 27% nuk kanë qasje në ujë të rrjedhshëm dhe 27% nuk janë të lidhur me sistemin e kanalizimit.

	PZHBV serbë në banesa private	PZHBV serbë në qendra kolektive
Ujë të rrjedhshëm	99%	73%
Energji elektrike	99%	99%
Plin	2%	0%
Sistem kanalizimi	94%	73%

Tabela 24: Përqindja e ekonomive familjare të anketuara sipas grupit të cilat kanë qasje në shërbimet e renditura

Qasja në arsim

Qasja në arsim është hulumtuar në lidhje me vijueshmërinë e rregullt në shkollim (që do të thotë pesë ditë në javë). Tabela e mëposhtme paraqet normat e zërthyer sipas nivelit të arsimit dhe gjinisë për 189 fëmijë të moshës fillore (nga totali 203 në mostër)⁴⁸ dhe 111 fëmijë/të rinj të moshës së shkollës së mesme për të cilët të dhënat janë mbledhur në grup PZHBV-ve serbë në banesa private, dhe kjo vë në pah:

- ▶ Norma pak më e lartë e vijueshmërisë për djem sesa për vajzat;
- ▶ Norma pothuajse identike e vijueshmërisë për secilin grup gjinor nëpër dy nivelet e arsimit, duke treguar pothuajse asnjë braktisje të shkollës nga arsimi fillor në arsimin e mesëm (fare në mesin e vajzave).

Në mesin e popullatës së përgjithshme në Kosovë, norma e vijueshmërisë është 98% për shkollën fillore dhe 82% për shkollën e mesme⁴⁹.

Të gjithë 27 fëmijët e takuar në mesin e banorëve të qendrës kolektive për të cilët të dhënat janë mbledhur (nga totali 29 në këtë grup) vijnë shkollën.

	Meshkuj	Femra
Norma e vijueshmërisë në shkollën fillore	91%	85%
Norma e vijueshmërisë në shkollën e mesme	89%	85%

Tabela 25: Normat e vijueshmërisë të PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private sipas nivelit (shkolla fillore dhe shkolla e mesme) dhe gjinisë

Qasja në kujdesin shëndetësor

Në total 12% e ekonomive familjare të PZHBV-ve serbë në banesa private dhe 42% e banorëve të qendrës kolektive raportuan se nuk mund të qasen në kujdesin shëndetësor, kur kanë nevojë. Shumica e këtyre ekonomive familjare jetojnë në zonat rurale. Pjesa më e madhe në të dyja grupet raportuan si arsye kryesore të mos pasjes

48 Vini re se shkolla fillore sipas sistemit të Serbisë mund të fillojë në mes të moshës gjashtë dhe shtatë vjeç.

49 UNICEF Kosovo (UNSCR1244). Monitoring the Situation of Children and Women - Multiple Indicator Cluster Survey 2013-2014 (Kosovë) (UNSCR 1244). Monitorimi i Situatës së Grave dhe Fëmijëve - Anketa e Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë 2013-14.

së mundësisë së qasjes në kujdesin shëndetësor se shërbimet e kërkuara nuk ishin në dispozicion në afërsi dhe në qendrën e qasshme shëndetësore.

Dokumentacioni personal

Nga totali i mostrave të PZHBV serbë, dy individë raportuan se nuk posedojnë asnjë formë të dokumenteve personale. Në total 10% raportuan se nuk posedojnë as pasaportë e as ID - por raportuan që posedojnë një çertifikatë të lindjes. Nga këta individ, 99% ishin nën moshën 24 vjeçare dhe shumica (80%) theksuan që planifikonin për të aplikuar për dokumente personale.

Vëreni se, 76% e individëve të cilët banojnë në banesa private dhe të cilët posedojnë dokumentin e letërnjoftimit të lëshuar në Kosovë, përderisa për 86% është lëshuar në Sërbë; proporcionet për banorët e qendrave kolektive janë 78% dhe 88%, respektivisht. Kjo tregon se një pjesë e popullatës i posedon dokumentat personale të lëshuara në Kosovë dhe Sërbë.

PUNËSIMI: QASJA DHE KUSHTET

Duke pasur parasysh disponueshmërinë e programeve të mirëqenies publike, aftësia për të përmbushur nevojat socio-ekonomike për PZHBV-ve serbë është hulumtuar nga perspektiva e qasjes njëloj si në tregun e punës dhe në mirëqenie. Ky kapitull shqyrton qasjen e mostres se synuar në tregun e punës dhe në kushtet e punësimit. Megjithatë, për shkak të numrit të vogël të hasur të individëve ekonomisht aktiv në qendrat kolektive, analiza për këtë grup të zhvendosur nuk mund të shkojë përtej statistikave themelore, dhe të eksplorojë detaje rreth asaj që karakterizon të punësuarit dhe të papunët. Situata e përgjithshme ekonomike e ekonomive familjare serbe të PZHBV-ve, duke përfshirë qasjen e tyre në përfitime sociale, vijon në kapitullin e ardhshëm.

Qasja në punësim

Qasja në punësim është analizuar përmes indikatorëve në vijim:

- ▶ Pjesëmarrja e fuqisë punëtore, që do të thotë përqindja e popullsisë në moshë pune ekonomisht aktive (ata që janë duke punuar ose duke kërkuar punë)
- ▶ Shkalla e punësimit, që do të thotë përqindja e popullsisë në moshë pune të punësuar
- ▶ Shkalla e papunësisë, që do të thotë përqindja e fuqisë punëtore që nuk është aktualisht e punësuar dhe është duke kërkuar një punë

Të tre indikatorët marrin parasysh popullsinë në moshë pune (15-64 vjeç), e cila për popullatën PZHBV serbë të anketuar korrespondon me 1,414 persona në banesa private dhe 191 persona në qendrat kolektive. Duhet të theksohet se termi "punësim" mund të përbëjë situata shumë të ndryshme, duke përfshirë edhe punësimin informal dhe nën-punësimi. Prandaj kushtet e punësimit do të hulumtohen gjithashtu.

Duke analizuar qasjen në punësim të PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private dhe në qendra kolektive sipas indikatorëve të sipërpërmendur, mund të vërehet se, ndonëse pjesëmarrja e përgjithshme e fuqisë punëtore e PZHBV-ve serbë në banesa private dhe në qendra kolektive është e ngjashme, një hendek më i madh gjinor është vërejtur në grupin e fundit. Ndryshe nga kjo, përqindjet e punësimit ndryshojnë (33% në mesin e PZHBV në banesa private dhe 24% në mesin

e PZHBV në qendra kolektive), dhe një hendek i madh gjinor është vërejtur përsëri në lidhje me punësimin e banorëve të qendrës kolektive. Numri i vogël i popullatës në moshë pune në qendrat kolektive (191 individë) megjithatë, duhet të kihet parasysh.

Në mesin e të rinjve në banesa private (15-24 vjeç; gjithsej 311 individë), pjesëmarrja në fuqinë punëtore qëndron në 28% kundrejt 64% e vërejtur për popullsinë e përgjithshme në moshë pune, ndërsa shkalla e papunësisë është 71% kundrejt 48%. Shkalla e papunësisë tek gratë e reja (68%) është më e ulët se tek mashkujt e rinj (75%).

Për shkak të numrit të vogël të të rinjve të takuar në qendrat kolektive të synuara (30 individë), nuk mund të kryhen analiza mbi pjesëmarrjen e fuqisë punëtore, punësimin dhe papunësinë.

Marrëveshjet e punësimin dhe sektori

Prej 459 PZHBV-ve serb në banesa private të cilët ofruan informata në llojin e kontratës aktuale – të cilët përfaqësojnë 98% nga 466 individë të cilët raportuan se janë të punësuar – 92% raportuan se kanë kontratë me shkrim. Dallimi mes meshkujve dhe femrave të punësuar në këtë pikë është i vogël (tre pikë përqindje në favor të meshkujve). Prevalenca e kontratave me shkrim në mesin e të punësuarve në grupin e qendrës kolektive (44 responentë nga 46 individë të anketuar në total) qëndron në 66% (madhësia shumë më e vogël e mostrës së të punësuarve në këtë grup duhet të kihet parasysh).

Nga 459 individë nga mostra në banesa private dhe 44 individë në qendra kolektive të cilët ofruan informata më të hollësishme mbi kushtet e punësimin të tyre, 89% dhe 70% respektivisht kanë raportuar se janë të angazhuar në punë me kohë të plotë, duke mos i dhënë kështu indikacione të forta nën-punësimin.

Moshë: 15–64		Mashkuj	Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Serb në banim privat	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	68%	59%	64%	1414
	Shkalla e punësimin	37%	30%	33%	1414
	Shkalla e papunësisë	46%	50%	48%	904
PZHBV Serb në qendrat kolektive	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	74%	47%	61%	191
	Shkalla e punësimin	30%	16%	24%	191
	Shkalla e papunësisë	59%	65%	62%	117

Tabela 26: Qasja në punësim sipas moshës së punës (15-64) të PZHBV të anketuar serb në në banesa private dhe në qendra kolektive sipas gjinisë⁵⁰

50 Kolona "Totali N/Emëruesi" tregon emëruesit të përdorur për përqindjet e llogaritura: për llogaritjen e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore dhe shkallën e punësimin, nën-mostra (emëruesi) relevante përfshinë 1,414 ose 191 (në bazë të grupit) individë në moshë të punës (15-64 vjeç); për shkallën e papunësisë nën-mostra relevante (emëruesi) përfshinë 904 ose 117 (në bazë të grupit) individë që marrin pjesë në fuqinë punëtore.

Moshë: 15–24		Mashkuj	Femra	Total %	Total N/ Denominatori
PZHBV Serb në banim privat	Pjesëmarrja në fuqinë punëtore	24%	31%	28%	311
	Shkalla e punësimin	6%	11%	8%	311
	Shkalla e papunësisë	75%	68%	71%	61

Tabela 27: Qasja në punësimin e të rinjve të anketuar (15-24 vjeç) në mesin e PZHBV-ve serbë në banesa private sipas gjinisë

Në total 66% nga 470 e PZHBV-ve serbë në banesa private të cilët ofruan informata për rrogat e tyre raportuan se fitojnë nën 300 euro, ku femrat marrin mesatarisht rreth 6 euro më pak se meshkujt. Nga 45 respondentë të qendrave kolektive, 42% raportuan se marrin më pak se 150 euro në muaj.

	PZHBV-të serbë në banesa private	PZHBV-të serbë në qendrat kolektive
Më pak se 100 EUR	6%	24%
101-150 EUR	6%	18%
151- 200 EUR	10%	22%
201- 250 EUR	19%	11%
251- 300 EUR	25%	7%
301- 400 EUR	27%	13%
400+ EUR	8%	4%
Totali %	100%	100%
Totali N	470	45

Tabela 28: Vargu mujor i pagave i PZHBV-ve serbë të punësuar të anketuar në banesa private dhe në qendra kolektive

Referenca në kornizën e IASC

Kriter: Qasja në mjete të jetesës dhe punësim

Punësimi dhe mjetet e jetesës në dispozicion të PZHBV duhet të lejojë të paktën që ata të përmbushin nevojat e tyre kryesore socio-ekonomike.

Shumë pak diversifikim është vërejtur në mesin e PZHBV-ve serbë në banesa private në aspektin e punësimit në sektorin publik apo privat. Nga 465 individ të cilët ofruan informata në këtë lëmi nga 466 të cilët raportuan se janë të punësuar, 90% raportuan që punojnë në sektorin publik, me një shumicë femrash në krahasim me meshkujt.

Për shkak të numrit të vogël të PZHBV-ve të punësuar në qendra kolektive, nuk mund të bëhet analizë e mëtutjeshme mbi shpërndarjen e tyre sipas sektorëve.




Figura 28: Marrëveshjet e punës të PZHBV-ve të punësuar serbë në banesa private

Kush janë të papunëuarit?

Përderisa popullsia e papunësuar tashmë është hulumtuar duke shikuar në karakteristikat kryesore demografike, të tilla si gjinia dhe mosha, ajo është hulumtuar më tej këtu duke shikuar në nivelin e tyre arsimor dhe vendin e banimit. Të gjithë këta faktorë kanë qenë të kontrolluar në një analizë të regresionit që mbështet përfundimet e mëposhtme:

- ▶ Femrat dhe meshkujt PZHBV serbë kanë norma relativisht të ngjashme të papunësisë (46% për meshkujt dhe 50% për femrat në banesa private; 59% për meshkujt dhe 65% për femrat në qendrat kolektive).
- ▶ Shkalla e papunësisë në mesin e të rinjve PZHBV serbë në banesa private (71%) është më e lartë se sa në mesin e popullsisë së përgjithshme në moshë pune të serbëve në banesat private (48%).
- ▶ Edhe pse papunësia është më e lartë në mesin e atyre me arsim fillor, rënia e parë në mesin e atyre me arsim të lartë nuk është veçanërisht signifikante. Për më tepër, ata me arsim më të lartë në të vërtetë kanë papunësi disi më të lartë në krahasim me ata me shkollë të mesme.
- ▶ Normat e larta të papunësisë u gjetën në zonat rurale si dhe në shtresën B⁵¹ të mostrës.

51 Shtresa B përfshin të gjitha lokacionet e anketuara përpos katër komunave të veriut. municipalities.

Përveç analizës së mësipërme, u zbulua se 2% dhe 12% e popullatës së papunë në mesin e PZHBV-ve serbë në banesa private dhe banorëve të qendrës kolektive, respektivisht, kanë raportuar se nuk janë të regjistruar në një zyrë papunësie.

Në fund, është hulumtuar perceptimi i të papunëve mbi arsyen kryesore se pse nuk kanë gjetur punë, ku 78% e banorëve në banesa private dhe 79% e banorëve të qendrës kolektive përmendën "numër tepër i madh i njerëzve janë në kërkim të një pune" si arsye. Respektivisht, 13% dhe 18%, përmendën "mungesën e lidhjeve personale".

		Shkalla e papunësisë	
PZHBV Serb në banesa private	Fillor		56%
	Mesëm		41%
	Kolegj ose më lartë		47%

Tabela 29: Shkalla e papunësisë e PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private sipas nivelit arsimor




Figura 29: PZHBV-të e punësuar serbë në banesa private sipas sektorit të punës dhe gjinisë

SITUATA EKONOMIKE

Situata ekonomike e ekonomive familjare të PZHBV-ve serbë të synuar është hulumtuar duke shikuar në burimet kryesore të të ardhurave, si dhe shpenzimet e tyre.

Burimet e të ardhurave

Nga të anketuarit u kërkua të radhisin burimin më të rëndësishëm dhe të dytin më të rëndësishëm të të ardhurave për familjen e tyre. Nga PZHBV-ve serbë në banesa private, 57% raportuan pagat si burimin e tyre kryesor të të ardhurave, ndërsa ky është rasti për 17% të banorëve të qendrave kolektive, për të cilët pensioni ose përfitimet sociale janë burimi kryesor i të ardhurave në 45% dhe 27% të rasteve, respektivisht. Megjithatë, kjo duhet të lexohet në dritën e përqindjes së lartë të personave të moshës mbi 60 vjeçare (33%) në mesin e banorëve të qendrës kolektive.

	PZHBV-të serbë në banesa private	PZHBV-të serbë në qendrat kolektive
Pagat	57%	17%
Pagat e parregullta (të ardhura nga aktivitete të përkohshme)	2%	7%
Bujqësia	0%	0%
Të ardhurat nga bizneset (përfsh. ndërmarrjet e EF)	1%	0%
Pensionet	27%	45%
Përfitimet sociale	13%	27%
Remitancat	0%	0%
Të tjera	0%	1%
Asnjë burim të të ardhurave	1%	1%

Tabela 30: Burimi kryesor i të ardhurave të PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private dhe qendra kolektive

Sa i përket burimeve dytësore të të ardhurave, 65% e banorëve të qendrave kolektive dhe 43% e PZHBV-ve në banesa private raportuan se nuk kanë burim dytësor. Nga PZHBV-ve në banesa private, 24% raportuan pagat si burime dytësore.

Bazuar në gjetjet nga kapitulli i mëparshëm në lidhje me qasjen në punësim, është konstatuar se 40% e ekonomive familjare të synuara në banesa private nuk kishin person me të ardhura, ndërsa pjesa e mbetur prej 60% raportuan që kanë ndërmjet një dhe tre anëtarë të punësuar. Këto përqindje pasqyrojnë dhe konfirmojnë mënyrën se si ekonomitë familjare radhitën varësinë e tyre në burime të të ardhurave, me një 40% të kombinuar që paraqitën pensionet ose përfitimet sociale si burimet e tyre kryesore të të ardhurave, si dhe një 60% të kombinuar që paraqitën pagat, meditet apo të ardhurat e biznesit si burim kryesor të të ardhurave të tyre.

Në mesin e banorëve të anketuar të qendrës kolektive, 70% e ekonomive familjare raportuan që nuk kanë person me të ardhura; përsëri, kjo reflekton varësinë e tyre mbi pensionet dhe përfitimet sociale (të raportuara si burimet kryesore të të ardhurave nga një 72% i kombinuar).




Figura 30: Përqindja e ekonomive familjare të anketuara të PZHBV-ve serbë në banesa private sipas numrit të anëtarëve të punësuar

Expenditures

Ekonomitë familjare të PZHBV-ve serbë në banesa private raportuan shpenzime mesatare mujore prej 306 euro⁵² andërsa banorët e qendrës kolektive raportuan 261 euro. Shpenzimet mesatare mujore për person janë 122 euro për banorët në banesa private⁵³, dhe 144 euro për banorët e qendrës kolektive.

52 Qiraja nuk përfshihet në shpenzimet e përgjithshme pasi që vetëm disa ekonomi familjare kanë raportuar që i paguajnë ato, e cila do të mund të shtrembëronte totalin. Ekonomitë familjare të PZHBV-ve serbë në banesa private që raportuan se paguajnë qiranë paraqesin një kosto mesatare mujore prej 80 Euro.

53 Mesatarja për kokë banori në muaj janë 103 Euro për banorët e shtresës A dhe 133 Euro për banorët e shtresës B. Kur llogariten shpenzimet mesatare është e rëndësishme që të sillen vëmendja në konceptin e devijimit standard (sasia që shpreh se për sa pjestarët e një grupi dallojnë nga vlera mesatare për grupin; sa më të shpërndara të dhënat, devijimi më i lartë). Devijimi standard në këtë rast është 94 Euro, që është afër mesatares (122 Euro). Kjo zbulon se shtrirja e shpenzimeve për kokë banori ndryshon në masë të madhe, duke aluduar kështu në gjendje mjaft të ndryshme ekonomike, siç shqyrtohet në seksionin pasues.

Duke shikuar në përqindjen e shpenzimeve mujore dedikuar për ushqim, e cila është një përcaktues i fleksibilitetit ekonomik, një normë mesatare prej 53% është vënë re për PZHBV-të serbë në banesa private. Sa më i lartë që të jetë raporti i ushqimit, aq më pak fleksibilitet ekonomik pritet të ketë familja⁵⁴.

54 Raporti i ushqimit për qendrat kolektive nuk është llogaritur për shkak të specifikave të pronësisë së strehimit dhe llojet e tjera të përkrahjes së dhënë që shtrembërojnë totalin e shpenzimeve dhe shpërndarjen e tij.




Figura 31: Shpenzimet mujore për kokë banori të PZHBV-ve të anketuar serbë të paraqitura sipas llojit në Euro

Faktorët e mirëqenies ekonomike të familjes

Analiza e gjendjes ekonomike të ekonomive familjare të PZHBV-ve serbë në banesa private zbuloi një variacion të madh brenda popullatës së anketuar. Për të kuptuar më mirë se çfarë i karakterizon ekonomitë familjare që jetojnë në situata të ndryshme ekonomike, të katër nën grupet e mëposhtme janë formuar në bazë të shpenzimeve të raportuara (Shih kutinë në grupimin e shpenzimeve për detaje). E njëjta analizë nuk mund të kryhej tek banorët e qendrës kolektive për shkak të numrit të kufizuar të personave të punësuar.

Një të kuptuar i asaj se çfarë i karakterizon këto grupe mund të ndihmoj të kuptuarit se kush janë më të rrezikuarit ekonomikisht. Faktorët e mëposhtëm janë hulumtuar: rëndësia e punësimit, vendndodhja, kohëzgjatja e qëndrimit në lagjen aktuale, niveli arsimor i kryefamiljarit dhe pronësia e strehimit aktual. Dolën gjetjet në vijim:

- ▶ **Ndikimi i kufizuar i pagave në mirëqenien sociale:** Përqindje të konsiderueshme të ekonomive familjare në grupet me shpenzime mesatare dhe shpenzimet më të larta raportuan që nuk kanë asnjë anëtar të punësuar (43% dhe 38%, respektivisht), gjë që tregon varësinë në burime të tjera të të ardhurave të tilla si përfitimet sociale, të cilat u treguan nga 65% dhe 50% të këtyre dy grupeve, respektivisht.
- ▶ **Polarizim më i madh në mirëqenien ekonomike në zonat urbane:** Në zonat rurale janë gjetur më pak ekonomi familjare në grupin me shpenzimet më të ulëta (13%) në krahasim me vendet urbane (26%).

Për më tepër, në vendet urbane është vërejtur një polarizim më i madh, ku jo vetëm që më shumë ekonomi familjare bien në grupin më të ulët, por 40% bien në grupin me shpenzimet më të larta (shih tabelën III në Shtojcën 4).

- ▶ **Pronësia e strehimit nuk është vendimtare për mirëqenien sociale:** Nuk është vërejtur asnjë lidhje e qartë ndërmjet grupeve të shpenzimeve dhe situatës së pronësisë së strehimit në kuptim të pasjes në pronësi ose marrjes me qira. E njëjta përqindje (24%) e atyre që mbajnë në pronësi dhe atyre që marrin me qira strehimin e tyre bie në grupin më të ulët, ndërsa përqindje shumë të ngjashme janë të shpërndara përgjatë grupeve me shpenzime tjera po ashtu. Megjithatë, një përqindje më e vogël e ekonomive familjare që janë të strehuara pa pagesë bien brenda grupit më të ulët (shih tabelën III në Shtojcën 4).
- ▶ **Ndikimi pozitiv i nivelit arsimor të kryefamiljarit në mirëqenien ekonomike:** Nga 82% e ekonomive familjare, kryefamiljarët e të cilëve kanë një diplomë të shkollës së mesme, 25% dhe 37% gjinden në grupet me shpenzime mesatare dhe më të larta, respektivisht. Ndër ekonomitë familjare, kryefamiljari i të cilave ka një diplomë kolegj si minimum (15 në total), asnjë nuk bie brenda grupit më të ulët, por ato shpërndahen më tepër në mënyrë të barabartë në mesin e grupeve me shpenzimet e dyta më të larta, mesatare dhe më të larta (shih tabelën III në Shtojcën 4).

PZHBV-të serbë në banesa private	0 anëtarë të punësuar	1 anëtar i punësuar	2 anëtarë të punësuar	3 anëtarë të punësuar	Totali %	Totali N
Grupi me shpenzimet më të ulëta	38%	34%	23%	5%	100%	113
Grupi i dytë më i ulët	43%	39%	12%	6%	100%	105
Grupi me shpenzime mesatare	43%	36%	19%	3%	100%	145
Grupi me shpenzimet më të larta	38%	41%	20%	1%	100%	202

Tabela 31: Numri i anëtarëve të punësuar në ekonomitë familjare të anketuara të PZHBV-ve serbë në banesa private sipas grupit të shpenzimeve

Grupimi i shpenzimeve

Janë formuar katër grupe të mirëqenieve të ndryshme ekonomike në bazë të shpenzimeve ditore të ekonomive familjare për kokë banori. Informacionet mbi shpenzimet janë ofruar nga pothuajse e gjithë mostra e synuar (565 nga 567 ekonomi familjare). Grupi më i ulët përbëhet nga ekonomitë familjare shpenzimet e të cilave janë nën kufirin e varfërisë prej 1.90 USD në ditë (që korespondon me 1.79 Euro në momentin e shkrimit, siç është përcaktuar nga Banka Botërore në vitin 2015 në aspektin e fuqisë blerëse – shih <http://www.worldbank.org/en/topic/poverty/brief/global-poverty-line-faq>). Ekonomitë familjare të mbetura ndahen në tri grupe të gamave të barabarta, siç paraqitet në tabelën më poshtë. Pothuajse 40% e familjeve të PZHBV-ve serbe të anketuara bien në dy grupet më të ulëta.

	PZHBV-të serbë në banesa private
Grupi me shpenzimet më të ulëta: Shpenzojnë nën 1.79€ për kokë/ditë	20%
Grupi me shpenzimet e dyta më të ulëta: Shpenzojnë ndërmjet 1.8 dhe 2.9€ për kokë / ditë	19%
Grupi me shpenzime mesatare: Shpenzojnë ndërmjet 3 dhe 4.6€ për kokë /ditë	26%
Grupi me shpenzimet më të larta: Shpenzojnë më shumë se 4.6€ për kokë /ditë	36%
Totali %	100%
Total N (ekonomive familjare)	565

Tabela 32: Shpërndarja e familjeve të PZHBV-ve serbe në banesa private për nga niveli i shpenzimeve (totali për kokë për ditë)

Strategjitë e përballjes ekonomike

Ekonomitë familjare të anketuara janë pyetur edhe për perceptimin vetanak të gjendjes së tyre ekonomike, për të parë nëse ata kishin vështirësi të paguajnë qiranë ose më në përgjithësi t'ia dalin mbanë. Nga 25% e PZHBV-ve serbë në banesa private të marra me qira, 28% kanë raportuar se iu është dashur të marrin hua në gjashtë muajt e mëparshëm për të paguar qiranë. Dalja mbanë në fund të muajit është raportuar të jetë një sfidë e rreth 64% të ekonomive familjare të synuara. Shumica e këtyre ekonomive familjare (82% e atyre në banesa private dhe 84% e atyre të qendrës kolektive) treguan se mekanizmi

kryesor i zgjedhur për përballje 'huamarrja nga miqtë/të afërmit ose anëtarët e tjerë të komunitetit' (p.sh. pronari i dyqanit).

Referenca në kornizën e IASC

Kriteri: Mekanizmat efektiv dhe të arritshëm për të rikthyer strehimin, token dhe pronën

PZHBV-të që kanë arritur një zgjidhje të qëndrueshme, kanë qasje në mekanizma efektiv për kthimin në kohë të strehimit, tokës dhe pronës së tyre, pavarësisht nëse ata kthehen apo zgjedhin të integrohen në nivel lokal apo të vendosen diku tjetër në vend. Procesi përmes të cilit bëhet kthimi i banesave, tokës dhe pronës dhe kompensimi i ndërlidhur mund të jetë kompleks dhe të konsumojë kohë. Nuk është e nevojshme që ky proces të përfundohet plotësisht para se të mund t'u thuhet se PZHBV kanë gjetur një zgjidhje të qëndrueshme. Faktori përcaktues është se ata kanë qasje në një mekanizëm efektiv dhe të arritshëm për kthimin dhe kompensimin e pronave (duke përfshirë, aty ku është e nevojshme, ndihmë ligjore falas) dhe janë në gjendje të jetojnë në mënyrë të mbrojtur dhe të siguruar në ndërkohë.

QASJA NË MEKANIZMAT E KTHIMIT TË STREHIMIT, TOKËS DHE PRONËS

Në Kosovë kthimi e pronës administrohet nga Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, e cila është mandatuar me marrjen, përpunimin dhe zgjidhjen e kërkesave që lidhen me pronat e paluajtshme. Lloji i pronës në pronësi në vendin e origjinës nga ana e popullatës së anketuar, si dhe niveli i qasjes ndaj saj, janë hulumtuar më poshtë.

Pasuritë e lëna në vendin e origjinës

Te gjitha ekonomitë familjare te synuara te grupeve respektive ofruan informate se a kane prone ne vendin e origjines. Nga grupi në banesa private, 72% raportuan se posedojnë të paktën një pasuri në vendin e origjinës. Për 68% kjo është strehim, ndërsa për 22% tokë bujqësore. Në mesin e PZHBV-ve serbë në qendrat kolektive, 47% kanë raportuar se posedojnë së paku një pasuri në vendin e origjinës, ku kjo është strehim në 44% të rasteve.

Ekonomitë familjare të anketuara përshkruan gjendje të ndryshme të pronës së lënë pas në vendin e origjinës siç është paraqitur në tabelën më poshtë. Nga informata e ofruar del se, në kohën e të shkruarit, 363 ekonomi familjare raportuan se prona/t ishin uzurpuar, 295 kanë nevojë të rindërtohen/riparohen, dhe 39 ekonomi familjare nuk janë në dijeni të gjendjes së pronës së tyre.

Lloji i pronës në vendin e origjinës	EF të PZHBV-ve serbë në banesa private		EF të PZHBV-ve serbë në qendra kolektive	
	%	Numri	%	Numri
Strehimi	68%	389	44%	59
Tokë bujqësore	22%	125	13%	18
Tokë jobujqësore	8%	45	1%	2
EF në total me pronë në vendin e origjinës	72%	408*	47%	64

Tabela 33: Ekonomitë familjare të PZHBV-ve serbë të anketuara, me pronë në vendin e origjinës, sipas llojit të pasurisë dhe sipas totalit

* Disa ekonomi familjare raportuan të kenë lënë pas më shumë se një pasuri, pra totali në numër dhe në përqindje korrespondon në numrin/përqindjen e ekonomive familjare të cilat kanë raportuar së paku një pasuri në vendin e origjinës (408 ekonomi familjare ose 72% nga totali 502 respondent në banesa private, dhe 62 ekonomi familjare ose 47% nga totali 135 respondentë në qendra kolektive) dhe nuk korrespondon në shumën e tërë numrave/përqindjeve të listuara më lart sipas llojit të pasurisë së lënë pas.




Figura 32: Gjendja e pasurive në vendin e origjinës siç raportohet nga PZHBV-të e anketuar serbë në banesa private (BP) dhe në qendra kolektive (QK) - të gjitha pronat e raportuara të paraqitura si numër

Qasja në pasuritë

Nga numri i totalit të ekonomive familjare të cilët raportuan se posedojnë pronë në vendin e origjinës, 93% nga ata me banesë private dhe 86% nga qendrat kolektive raportuan se kanë dokumente të pronësisë. Nga ata, 68% të atyre në banesa private dhe 23% nga banorët në qendra kolektive kanë raportuar se kanë paraqitur një kërkesë për kthimin.

Nga kërkesat të paraqitura nga PZHBV-të serbë në banesa private (278 në total), 26% ishin raportuar si të pranuar, ndërsa 23% (63 kërkesa) ishin raportuar se janë ende në proces. Nga ekonomitë familjare të anketuara, 49% raportuan se nuk janë në dijeni të rezultateve të kërkesave të tyre. Në total, 10 kërkesa u raportuan si të zbatuara.

Në mesin e PZHBV-ve të qendrës kolektive, shumë pak përgjigje janë dhënë mbi statusin e kërkesave: dy kërkesa janë raportuar si të pranuar, katër në proces, ndërsa gjashtë ekonomi familjare nuk ishin në dijeni të rezultateve të kërkesës së tyre. Në total, një kërkesë është raportuar si e zbatuar.

LOKACIONI I PREFERUAR I BANIMIT

Hyrje

Ky kapitull shqyrton planet dhe qëllimet e PZHBV-ve të anketuar serbë në lidhje me zgjidhjen e tyre të qëndrueshme, të preferuar në aspektin e vendndodhjes së banimit në të ardhmen, bazuar në tri opsione të konsideruara nga Korniza e IASC-së:

- ▶ **Kthimi në vendin e origjinës**
- ▶ **Integrimi në vendin e zhvendosjes (vendndodhja aktuale)**
- ▶ **Banimi në një lokacion të tretë (brenda ose jashtë Kosovës)**

Sipas kornizës së IASC-së, një lëvizje e thjeshtë fizike nuk përbën një zgjidhje të qëndrueshme më vete. Prandaj, këto tri rrugë për zgjidhje të qëndrueshme duhet të udhëhiqen nga principet themelore dhe kriteret e përcaktuara në Kornizë, të cilat mund të përdoren për të përcaktuar shkallën në të cilën një zgjidhje e qëndrueshme është arritur.

	PZHBV-të serbë në banesa private		PZHBV-të serbë në qendra kolektive	
	Numri (EF)	Përqindja (%)	Numri (EF)	Përqindja (%)
EF me pasuri të lëna pas (një ose më shumë) në vendin e origjinës	408	72% e mostrës totale	64	47% e mostrës totale
EF me dokumente të pronësisë (për të paktën një prej pasurive të tyre)	380	93% e EF me pasuri të lëna pas	55	86% e EF me pasuri të lëna pas
EF të cilat kanë paraqitur kërkesë(a) për kthimin	278	68% e EF me pasuri të lëna pas	15	23% EF me pasuri të lëna pas
EF kërkesa e të cilëve është zbatuar	10	4% EF që kanë paraqitur kërkesë	1	/

Tabela 34: Paraqitja e pronës në vendin e origjinës, të pasurit e dokumenteve të pronësisë dhe kërkesat e paraqitura për pasuritë siç janë raportuar nga ekonomitë familjare të PZHBV serb të anketuar (EF)

Duhet, po ashtu të mbahet në mend se këto vendime dhe synime që kanë të bëjnë me vendin e banimit nuk bëhen në një vakum, por janë të ndërthurura ngushtë me faktorë të tjerë vendimtarë si mundësitë e punësimit dhe edukimit, qasja në pronë, fleksibiliteti ekonomik, marrëdhëniet e komunitetit dhe perceptimet e qetësisë dhe sigurisë.

Sondazhi i profilizimit dhe DFG-të iu qasën temës së qëllimeve dhe planeve të ardhshme nga tri perspektiva, duke pyetur ekonomitë familjare:

- ▶ Cili ishte opsioni i tyre i preferuar për vendbanim të përhershëm;
- ▶ Çfarë kushte konsideronin ata si të nevojshme për rikthim ose integrim lokal, dhe si i priorizuan ata këto kushte;
- ▶ Nëse ata tashmë kishin plane konkrete për të lëvizur vendin e banimit në gjashtë muajt e ardhshëm.

Duke parë në konsideratat në lidhje me vendndodhjen e ardhshme të banimit, është e rëndësishme të theksohet se të gjitha ekonomitë familjare u pyetën edhe nëse ata do të merrnin në konsideratë të qëndronin, si dhe në qoftë se ata do ta konsideronin kthimin në kushte të caktuara; kjo do të thotë se ekonomitë familjare mund të marrin parasysh të dy opsionet, dhe njëri nuk përjashton tjetrin.

Zgjidhja e qëndrueshme e preferuar pamvarësisht nga kushtet

Ekonomitë familjare PZHBV serbe të anketuara u pyetën në lidhje me lokacionin e tyre të preferuar të vendbanimit, pavarësisht kushteve. Ata dhanë këto përgjigje:

- ▶ 95% e PZHBV-ve serbë në banesa private do të preferonin integrimin lokal në vend të zhvendosjes – proporcioni sipas shtresës është 97% në shtresën A dhe 89% në shtresën B⁵⁵; 1.4% do të preferonin kthimin në vendin e origjinës, përderisa ekonomitë familjare të mbetura preferuan të lëvizin në një vend të tretë, ose nuk ishin në gjendje të japin një preferencë.
- ▶ 84% e PZHBV-ve serbë në qendra kolektive do të preferonin integrimin lokal në vend të zhvendosjes, ndërkohë që 9% do të preferonin të lëvizin jashtë Kosovës dhe 1.5% do të preferonin kthimin në vendin e origjinës. Ekonomitë familjare të mbetura preferuan të lëvizin në një vend të tretë, ose nuk mund të jepnin një preferencë.

Pjesëmarrësit e DFG nuancuan gjetjet e mësipërme të

⁵⁵ Shtresa A përmban katër komunat e veriut dhe shtresa B përmban të gjitha komunat tjera të anketuara.

studimit, pasi që shumë prej tyre shprehën dëshirën për t'u rikthyer në vendin e origjinës dhe i atribuuan zgjedhjes së tyre të raportuar për të qëndruar në vendin e zhvendosjes, perceptimin e tyre për sigurinë e pamjaftueshme, mundësitë e pakta për punësim, si dhe mungesën e pronës apo qasjen në të.

Konsiderata për të qëndruar ose për t'u kthyer sipas kushteve të caktuara

Në total prej 83% të PZHBV-ve të anketuar serbë në banesa private⁵⁶ dhe 91% e atyre në qendra kolektive do të merrnin në konsideratë të mbeten në lokacionin e tanishëm. Konsiderimi për të qëndruar në vendndodhjen e tanishme nuk do të thotë patjetër qëndrim në strehimin e tanishëm por të mbesin në lokacionin e njëjtë.

Faktorët më të rëndësishëm apo më të favorshëm për të qëndruar janë listuar 493 ekonomi familjare në banesa private dhe 127 ekonomi familjare në qendra kolektive. Prej tyre, 55% e grupit në banesa private i kanë dhënë prioritet mbështetjes së banimit (me një përqindje të konsiderueshme prej 43% iu kanë referuar sigurimit të strehimit në tokën komunale) dhe 26% i kanë dhënë prioritet disponueshmërisë së mundësive konkrete të punësimit. Shumica e konsiderueshme e PZHBV-ve serbë në qendra kolektive (91%) gjithashtu i kanë dhënë prioritet mbështetjes së banimit, me 84% iu kanë referuar sigurimit të strehimit në tokën komunale.

Kushtet aktuale të pronësisë së strehimit të PZHBV-ve në banesa private nuk mund të thuhet që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme preferencën e ekonomisë familjare për të qëndruar në lokacionin e tanishëm, pasi është vënë re se 94% e atyre që janë me qira, 90% e atyre që strehohen falas dhe, e papritur, një përqindje pak më e vogël (76%) prej atyre që kanë në pronësi strehimin e tyre aktual do të konsideronin integrimin lokal.

Përveç faktorëve të lartpërmendur që ndikojnë në vendimin për të qëndruar, përvoja e incidenteve të sigurisë, perceptimi i sigurisë në vendin aktual të banimit, si dhe kohëzgjatja e qëndrimit në zhvendosje dhe aftësitë gjuhësore janë gjithashtu të rëndësishme në konsiderimin gjatë analizimit të qëndrueshmërisë së integritetit lokal. Në total prej 4% e PZHBV-ve serbë në banesa private dhe 1.5% e PZHBV-ve serbë në qendra kolektive raportuan se kanë përjetuar incidente të sigurisë, si dhunë dhe kërcënime, brenda gjashtë muajve para anketës.

Siguria e perceptuar në kuptim të lirisë së lëvizjes ishte

⁵⁶ Të dhënat i referohen 566 ekonomive familjare nga gjithsejtë 567 në mostër.

konsideruar në lidhje me qarkullimin brenda lagjes së tyre dhe më gjerë brenda komunës/zonës. Nivelet e perceptuara të sigurisë ulen në mesin e PZHBV-ve si në banesa private, po ashtu dhe në qendra kolektive kur krahasojmë lëvizjen brenda lagjes së tyre me atë brenda komunës dhe komunat fqinje. Në total prej 20% e PZHBV-ve në banesa private dhe 14% e PZHBV-ve në qendra kolektive raportuan se ndihen të 'pasigurt' kur qarkullojnë brenda komunës së zhvendosjes (kundrejt 3% dhe 1% respektivisht, kur lëvizin përrreth në të lagje).

Nga PZHBV-të serbë në banesa private, 6% (34 ekonomi familjare) do të konsideronin kthimin në vendin e origjinës sipas kushteve të caktuara. Prej tyre, gati tri të katërtat iu kanë referuar mbështetjes së strehimit, ku më shumë se një e katërta iu kanë referuar niveleve më të larta të sigurisë në zonën e kthimit. Në mesin e banorëve të qendrës kolektive, katër ekonomi familjare në total shfaqën një konsideratë për t'u kthyer.

Njohja e gjuhës shqipe mund të ndikojnë në mundësinë e PZHBV-ve për të komunikuar me komunitetet në vendin e origjinës pas kthimit, pasi kjo do të ndodhë në zonat me shumicë shqiptare dhe gjuha serbe është gjuha amtare e PZHBV-ve të anketuar. U vu re se kjo ndryshonte në masë të madhe ndërmjet gjeneratave të reja dhe atyre

më të vjetra: 65% të PZHBV-ve të moshës 32 dhe më lart dhe 7% e PZHBV-ve të moshës ndërmjet 15 dhe 31 vjeçare raportuan se flasin shqip.

Kohëzgjatja e qëndrimit në zhvendosje është një faktor që mund të ndikojë në preferencën për të qëndruar apo për t'u kthyer. Siç është treguar më parë, pjesa më e madhe e ekonomive familjare të anketuara kanë jetuar në zhvendosje për rreth 17 vjet në kohën kur është bërë anketimi, që do të thotë se 31% e individëve kanë lindur në zhvendosje. Sipas pjesëmarrësve të fokus grupeve, një prej faktorëve që ndikon në vendimin për t'u kthyer është ai se nëse familja përbëhet nga fëmijë dhe të rinj të lindur në zhvendosje ose që kanë formuar rrjete të forta në zhvendosje, dhe që kështu do të përballëshin me sfida të mëdha të ri-integrimit në vendin e origjinës.




Figura 33: Ekonomive familjare e PZHBV serbë në banesa private (BP) dhe qendra kolektive (QK) që do të mendonin qëndrimin në vendndodhjen aktuale me kusht parësor të favorshëm

Planet konkrete për të lëvizur

Në total prej 3% e PZHBV-ve serbë në banesa private (13 ekonomi familjare) dhe 10% e PZHBV-ve serbë në qendra kolektive (12 ekonomi familjare) raportuan të kenë bërë plane konkrete për t'u larguar nga vendndodhja aktuale brenda gjashtë muajve pas anketës. Në rastin e banorëve të qendrës kolektive, kjo i referohet kryesisht lëvizjes brenda së njëjtës komunë.




Figura 34: Perceptimi i sigurisë të ekonomive familjare të PZHBV-ve serbë të anketuara gjatë lëvizjes përreth lagjes së tyre dhe në zonën më të gjerë

KONKLUZIONET

Gjetjet nga mostra e profilizimit të popullatës së zhvendosur në Kosovë konfirmojnë se ekziston një nevojë urgjente për të trajtuar situatën e zhvendosjes që nxiti autoritetet qeveritare dhe aktorët ndërkombëtarë për të zbatuar këtë ushtrim. Nga 1,327 ekonomi familjare të anketuara, pothuajse 92% kanë raportuar se kanë jetuar në zhvendosje për 17 vjet në kohën e grumbullimit të të dhënave, dhe deri më tani nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një zgjidhje të qëndrueshme. Si rezultat i kësaj situatë të zhvendosur të zgjatur, gati një e pesta e 4,932 individëve të anketuar kanë lindur në zhvendosje.

Këto të dhëna përcaktojnë vetëm madhësinë e çështjes, dhe njohuri të mëtejshme sigurohen nga trendet e vëzhguara kur shqyrtohen kriteret e Kornizës së IASC për të vlerësuar masën në të cilën është arritur një zgjidhje e qëndrueshme.

Për të arritur plotësisht objektivin e tretë të ushtrimit të profilizimit⁵⁷, këto konkluzione janë shprehur në dy seksione, përkatësisht duke paraqitur:

- ▶ Një pasqyrë e zgjidhjeve të preferuara të qëndrueshme në lidhje me vendndodhjen e ardhshme të qëndrimit të përhershëm, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë arritjes së tyre.
- ▶ Tiparet që karakterizojnë popullatat e anketuara, me fokus në dobësitë e tyre specifike.

57 Të rritet aftësia e institucioneve për të avokuar dhe dizajnuar programe të përbashkëta për të mbështetur zgjidhje të qëndrueshme për PZHBV përmes identifikimit të dobësive të tyre specifike dhe përmes koordinimit të zgjeruar të analizave humanitare dhe të zhvillimit.

KTHIMI OSE INTEGRIMI LOKAL - VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I ZGJIDHJEVE TË PREFERUARA TË QËNDRUESHME DHE SFIDAVE

Preferencat e të zhvendosurve brenda Kosovës nga aspekti i asaj që ata e konsiderojnë si zgjidhje të qëndrueshme për vendin e tyre të ardhshëm të qëndrimit të përhershëm janë hulumtuar nga dy perspektiva të ndryshme.

Së pari, atyre iu kërkua të tregonin se ku do të preferonin vendbanimin e tyre të përhershëm, duke zgjedhur midis mundësive të kthimit në vendin e origjinës, zhvendosjes në një vend tjetër në Kosovë, duke u integruar në vendin aktual të zhvendosjes dhe largimi nga Kosova.

Kjo siguron njohuri në dëshirat e tyre pavarësisht nga kushtet dhe mjetet për të arritur zgjidhjen e tyre të qëndrueshme për vendin e banimit. Siç shihet në grafikun më poshtë, tendenca që del në pah se, ndërsa shumica dërrmuese e popullsisë rom/ ashkali / egjiptian dhe PZHBV serbë konsiderojnë integrimin në vendin aktual të zhvendosjes si një zgjidhje të qëndrueshme, mbi gjysma e popullsisë PZHBV shqiptare dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës, me një pjesë të konsiderueshme (mbi një të pestën) duke preferuar integrimin lokal.




Figura 35: Përmbledhje e preferencave të ekonomive familjare të anketuara (EF) për vendbanimin e përhershëm të qëndrimit pavarësisht nga kushtet

Së dyti, popullsitë e anketuara u nxitën të reflektonin nëse do të konsideronin kthimin në vendin e tyre të origjinës dhe nëse ata do të konsideronin të mbeteshin në vendin aktual të zhvendosjes nëse kushtet e caktuara, për të cilat u kërkua të jepnin prioritete, ishin në vend. Kjo siguron informacion mbi mundësitë e dy opsioneve të zgjidhjes së qëndrueshme, si dhe mbi mbështetjen e nevojshme për arritjen e tyre. Ju lutem vini re se ekonomive familjare u janë bërë të dyja pyetjet, dhe ata mund të tregojnë se do të konsideronin të dy opsionet (kthimin dhe integrimin lokal) – kjo shpjegon pse përqindjet e përgjithshme për secilin grup tejkalojnë 100.

Perspektiva për të parë se çfarë konsiderojnë ata si kushte më të rëndësishme në vendimin e tyre për t'u kthyer në vendin e origjinës ose të integrohet në vendin e zhvendosjes duket të ndikojë në përgjigjet e mbledhura në mënyra mjaft të ndryshme. Ndër PZHBV shqiptarë, rom/ashkalin/egjiptian dhe PZHBV serbë në qendrat kolektive, përafërsisht e njëjta përqindje deklaruan se dëshirojnë të kthehen pavarësisht nga kushtet dhe të marrin në konsideratë kthimin nën kushte të caktuara; dallimi është pak më i madh në mesin PZHBV serbë në strehim privat, ku ajo është pesë pikë përqindje në favor të alternativës së dytë (duke pasur parasysh kushtet e

favorshme). Një trend i ngjashëm është vërejtur në lidhje me integrimin lokal në mesin e PZHBV-ve romë/ashkali/egjiptian dhe PZHBV serb, edhe pse dallimi është disi më i shprehur; nga ana tjetër, dallimi midis ekonomive familjare që dëshirojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes pavarësisht nga kushtet dhe ato që do të konsideronin integrimin lokal nën kushte të caktuara, është i konsiderueshëm në mesin e PZHBV-ve shqiptar. Është e dukshme që një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare të PZHBV-ve shqiptar që dëshirojnë të kthehen në vendin e origjinës do të konsideronin integrimin lokal nëse do të ekzistojnë disa kushte; tendenca e njëjtë mund të vërehet, megjithëse në një masë shumë më të vogël, në mesin e të PZHBV serbë në qendrat kolektive. Është interesante të theksohet se ky trend nuk aplikohet për PZHBV-të rom/ashkali/egjiptian dhe PZHBV-të serbë në strehim privat, ku numri i ekonomive familjare të cilët konsiderojnë integrimin lokal nën kushte të caktuara është më i ulët se ata që dëshirojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes pamvarësisht kushteve.




Figura 36: Përmbledhje e ekonomive familjare të anketuara (EF) duke konsideruar kthimin në vendin e origjinës dhe qëndrimin në vendin aktual nën kushte të caktuara – Vini re se të dy Ns i referohen përgjigjeve për secilën nga dy pyetje/variabla të ndryshëm

Mund të vijmë në përfundim se shumica dërrmuese e popullatave joshqiptare të zhvendosur brenda vendit në Kosovë dëshirojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes dhe nuk do të konsideronin kthimin edhe nëse ofroheshin lloje të ndryshme të mbështetjes (si ndërtimi i shtëpive dhe riposedimi i pronave), përderisa 36% e popullsisë shqiptare preferon të kthehet në vendin e origjinës, por do të konsideronte integrimin lokal nën kushte të caktuara. Kushtet dhe mbështetja e përmendur janë paraqitur në grafikun më mëposhtë:

Ngjashëm, grafiku më poshtë paraqet kushtet e prioritizuara sipas ekonomive familjare që konsiderojnë integrimin.

Një formë e mbështetjes për strehim del qartë si faktor kyç për arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme në lidhje me vendndodhjen e vendbanimit, qoftë kthimi në vendin e origjinës ose të integrimi në vendin e zhvendosjes. Duhet të theksohet se si kjo konsiderohet vendimtare nga të pesë ekonomitë familjare rome/ashkali/egjiptiane




Figura 37: Ekonomitë familjare të anketuara (EF) të cilat e konsiderojnë mundësinë e kthimit në kushte të caktuara të përcaktuara si të favorshme - N tregon numrin total të ekonomive familjare të cilët konsiderojnë mundësinë e kthimit. Vini re totalin N shumë të ulët të PZHBV-ve romë/ashkali/egjiptian dhe PZHBV-ve serbë në qendrat kolektive.




Figura 38: Ekonomitë familjare të anketuara (EF) të cilat e konsiderojnë mundësinë që të qëndrojnë në lokacionet aktuale të zhvendosjes të përcaktuara me kushte të favorshme - N tregon numrin total të ekonomive familjare të cilët konsiderojnë mundësinë e qëndrimit

që konsiderojnë kthimin, ndoshta për shkak të pjesës relativisht të ulët të ekonomive familjare të cilat posedojnë vendbanim në vendin e origjinës nga ky grup i popullsisë, dhe pothuajse tërë popullsia serbe që banon në qendrat kolektive dhe konsideron integrimin lokal, për shkak të natyrës së zgjidhjes aktuale të akomodimit. Gjithashtu duhet të theksohet se qasja në mundësitë më të mira të punësimit duket të jetë thelbësore për shumicën e ekonomive familjare që marrin parasysh integrimin lokal në mesin e popullatës romë/ashkali/egjiptiane dhe në mesin e popullatës serbe në strehim privat sesa në mesin e grupeve të tjera, megjithëse duhet të rikujtohet mosha mesatare relativisht e lartë e popullsisë serbe që banon në qendra kolektive kur e konsiderojnë këtë, pasi mos shprehja e dëshirës për mundësi më të mira punësimi

nuk mund të konsiderohet si një tregues i mungesës së nevojës për të rritur gjenerimin e të ardhurave. Për më tepër, duhet të theksohet se kthimi i familjeve të tjera të zhvendosura në të njëjtën zonë duket të jetë thelbësore për gjysmën e popullsisë serbe në mënyrë që të konsiderojnë kthimin. Së fundi, rëndësia që i atribuohet sigurisë në fushën e kthimit nga të gjithë popullatat e synuara, PZHBV-të romë/ashkali/egjiptiane është e konsiderueshme.

Për shkak të rëndësisë kryesore që i atribuohet mbështetjes për strehim, përmbledhja e llojeve të mbështetjes për vendbanim që doli nga studimi është përmbledhur më poshtë.

	Rikthimi i vendbanimit	Rindërtimi i vendbanimit	Ndërtimi i vendbanimit në tokën e tyre	Sigurimi i vendbanimit në tokën komunale	Numri total i EF të cilët kërkojnë mbështetje për vendbanim
PZHBV Shqiptar	152	62	29	15	258
PZHBV Rom/Ashkali/Egjiptian	0	3	3	3	9
PZHBV Serb në banesa privat	0	6	6	0	12
PZHBV Serb në qendra kolektive	0	1	1	0	2

Tabela 35: Numrat e ekonomive familjare të cilat i japin përparësi mbështetjes për vendbanim si kusht për kthimin, sipas llojit specifik të mbështetjes për vendbanim

	Rindërtimi i vendbanimit	Ndërtimi i vendbanimit në tokën e tyre	Sigurimi i vendbanimit në tokën komunale	Numri total i EF të cilët kërkojnë mbështetje për vendbanim
PZHBV Shqiptar	103	55	19	177
PZHBV Rom/Ashkali/Egjiptian	10	8	28	46
PZHBV Serb në banesa privat	35	35	210	280
PZHBV Serb në qendra kolektive	2	2	207	11

Tabela 36: Numri i ekonomive familjare që i japin përparësi mbështetjes për vendbanim si kusht për të qëndruar në vendin e zhvendosjes, sipas llojit specifik të mbështetjes për vendbanim

Me qëllim të promovimit të arritjes së zgjidhjes së qëndrueshme nga ekonomitë familjare që do të konsideronin kthimin në vendin e origjinës, nevojiten burime për (ri)ndërtimin e shtëpive/banesave për 129 ekonomi familjare të anketuara, në 18 raste prej të cilave gjithashtu duhet të ndahen tokat komunale. Përveç kësaj, procesi i riposedimit të pronës së tyre në vendin e origjinës duhet të finalizohet për 152 familje të PZHBV shqiptar.

Ngjashëm, për të mbështetur ekonomitë familjare që do të konsideronin integrimin në vendin aktual të zhvendosjes, 150 shtëpi/banesa duhet të riparohen dhe 100 duhet të ndërtohen në tokën në pronësi të ekonomive familjare të zhvendosura, ndërsa 364 duhet të ndërtohen në parcela të tokën komunale që do të përcaktohet

Siguria dhe liria e lëvizjes u shqyrtuan gjithashtu në stërvitjen e profilizimit, megjithëse nga perspektiva të ndryshme, për të dy ekonomitë familjare që dëshirojnë të kthehen dhe ata të cilët dëshirojnë të integrohen në nivel lokal. Të gjitha të dhënat e paraqitura në grafikun më poshtë i referohen përqindjeve të numrit të ekonomive familjare që raportuan duke marrë parasysh kthimin në vendin e origjinës ose integrimin në vendin e zhvendosjes.

Në lidhje me grupin që preferon të kthehet në vendin e origjinës, u mblodhën informata mbi frekuencën e vizitave të bëra në vendin e origjinës, në nivelin dhe cilësinë e ndërveprimit me bashkësinë lokale në zonën e kthimit, si dhe për rëndësinë e bashkëjetesës paqësore në vendimin për kthim.

Siç është paraqitur në tabelë, një analizë mund të bëhet vetëm për grupet e PZHBV shqiptarë dhe PZHVB serbë në venbanim privat, pasi që numri i ekonomive familjare që konsiderojnë kthimin në mesin e popullatës rome/ashkali/egjiptiane dhe PZHBV serbë në qendrat kolektive (pesë dhe katër, përkatësisht) janë shumë të vogla për të mundësuar nxjerrjen e ndonjë përfundimi të rëndësishëm. Mund të vërehet se sa e rëndësishme është që të dy grupet e mbetura kanë raportuar se nuk kanë vizituar vendin e origjinës 12 muaj para studimit. Vlen gjithashtu të theksohet se më pak se gjysma e ekonomive familjare shqiptare që vizituan vendin e origjinës raportuan se mbanin diskutime me banorët vendas, kundrejt tre të katërtave të ekonomive familjare serbe; përveç kësaj, reagimet e raportuara nga shumica janë pozitive për grupin e parë dhe negative për këtë të fundit. Të dy faktet se një numër i konsiderueshëm i ekonomive familjare shqiptare nuk iu afruan komunitetit

	Proporcioni i EF sipas numrit të vizitave në vendin e origjinës në 12 muajt e kaluar				Proporcioni i EF të cilët zhvilluan diskutime me fqinjët potencial (të atyre që vizituan vendin e origjinës)	Proporcioni i EF të cilët diskutuan me fqinjët, nga reagimet e marra nga fqinjët potencial	
	0	1-2	3-10	11+		PO	pozitive
PZHBV-të Shqiptar N=325	29%	32%	21%	18%	45%	91%	7%
PZHBV-të Serb në banesa private N=32	25%	43%	16%	16%	75%	11%	78%

Tabela 37: Ekonomitë familjare të anketuara (EF) të cilët preferojnë të kthehen në vendin e origjinës sipas hapave të ndërmarra në lidhje me eksplorimin e fizibilitetit të kësaj - N tregon numrin e familjeve që japin këtë informacion

lokal dhe se shumica e familjeve serbe që morën reagime negative mund të tregojnë se nevojiten përpjekje për të hapur rrugën për kthimin e qëndrueshëm të këtyre familjeve në drejtim të forcimit të lidhjeve ndërmjet komuniteteve të mbetura dhe të kthyerve.

Në lidhje me grupin që preferon të integrohet në vendin aktual të zhvendosjes, informacioni është mbledhur për çdo incident të përjetuar gjatë gjashtë muajve para anketimit, si dhe mbi nivelet e sigurisë së perceptuar brenda lagjes dhe zonës më të gjerë (p.sh. komunë dhe/ose komunat fqinje).

Nga mësipër mund të konkludohet se numri i incidenteve të sigurisë të përjetuara gjatë periudhës gjashtëmuajore para anketimit është përgjithësisht i ulët, PZHBV shqiptarë dhe PZHBV serbë në qendrat kolektive nuk raportuan asnjë incident. Perceptimet e sigurisë në nivel lagje ndryshojnë shumë në mesin e grupeve të ndryshme, me pothuajse shumicën e familjeve shqiptare që raportojnë se ndihen shumë të sigurt, kundrejt përafërsisht gjysmës së atyre të popullatës serbe në qendrat kolektive dhe një e treta në mesin e popullsisë rome/ashkali/egjiptianë dhe popullatës serbe në banesa private. Duke pasur parasysh proporcionet e larta të ekonomive familare në tre grupet e fundit që dëshirojnë të

integrohen në vendin e zhvendosjes, kjo mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e integritit lokal dhe theksohet më tej nga ekonomitë familare që kanë raportuar mungesë të sigurisë së mjaftueshme përtej nivelit të lagjes, proporcion ky i cili është përafërsisht tre të katërtat në grupet rome/ashkali/egjiptiane.

	Përqindja e incidenteve të sigurisë të raportuara nga EF në gjashtë muajt e mëparshëm	Nivelet e perceptuara të sigurisë në nivelin e lagjes		Niveli i perceptuar i sigurisë në nivel më të gjerë	
		Shumë sigurte	Mesatarisht i sigurt	I pasigurtë	Fare i sigurtë
PZHBV Shqiptar N=291	0%	95%	6%	1%	0%
PZHBV Rom/Ashkali/Egjiptian N=93	5%	31%	66%	25%	70%
PZHBV Serb në BP N=485	5%	38%	59%	19%	3%
PZHBV Serb në QK N=123	0%	55%	48%	13%	4%

Tabela 38: Ekonomitë familare të anketuara që preferojnë të mbeten në vendndodhjen aktuale të zhvendosjes nga perceptimet lidhur me sigurinë - N tregon numrin e ekonomive familare që japin informacion mbi këtë temë

VEÇORITË SPECIFIKE DHE DOBËSITË E POPULLATËS SË ZHVENDOSUR BRENDA VENDIT

Arsimi

Zhvendosja ka ndikuar negativisht në qasjen në arsim për popullsinë e anketuar. Me përjashtim të PZHBV serbë që banojnë në qendra kolektive, të gjitha grupet e tjera tregojnë shkallë më të ulët të ndjekjes së shkollimit sesa mesatarja e Kosovës (98% për shkollën fillore dhe 91% për shkollën e mesme). Shkalla e ndjekjes së shkollimit është veçanërisht e ulët në grupin rom/ashkali/egjiptian, brenda të cilit edhe analfabetizmi është dukshëm më i përhapur se sa në mesin e popullatës së përgjithshme të

Kosovës (ku ndikohen 3.85% individ), dhe një përqindje e konsiderueshme e individëve romë/ashkali/egjiptianë të moshës 15 vjeç e më lart kanë raportuar se nuk kanë përfunduar ndonjë arsimim formal.

Siç është paraqitur në grafikun e mësipërm, sfidat që lidhen me arsimin prekin veçanërisht popullsinë e PZHBV femra, me përjashtim të shkallës së ndjekjes së shkollimit, shkallës së analfabetizmit dhe përqindjes së individëve pa arsim formal midis PZHBV serbë që banojnë në qendrat kolektive, si dhe shkalla e individëve që kanë minimum diplomë të shkollës së mesme brenda grupit rom/ashkali/egjiptian, ku nuk shihen dallime midis burrave dhe grave.

		Shkalla e pjesëmarrjes në shkollën fillore	Shkalla e pjesëmarrjes në shkollën e mesme	Përqindja e popullsisë 18+ që mban minimum diplomë të shkollës së mesme	Përqindja e popullsisë 15+ që është analfabet	Përqindja e popullsisë 15+ pa arsimim
PZHBV Shqiptar	Djem/burra	83%	78%	83%	1%	2%
	Vajza/gra	79%	70%	69%	3%	3%
PZHBV Rom/Ashkali/Egjiptian	Djem/burra	75%	67%	20%	13%	17%
	Vajza/gra	66%	53%	19%	24%	27%
PZHBV Serb në BP	Djem/burra	91%	89%	91%	0%	1%
	Vajza/gra	85%	85%	84%	1%	2%
PZHBV Serb në QK	Djem/burra	100%	100%	80%	3%	2%
	Vajza/gra	100%	100%	60%	3%	2%

Tabela 39: Ekonomitë familare të anketuara sipas pjesëmarrjes në shkollim, analfabetizmit dhe nivelit të arsimit sipas gjinisë. Vëreni numrin e ulët të fëmijëve në Qendrat Kolektive (N=27).

Të hyrat

Zhvendosja ka ndikuar negativisht në qasjen në mundësitë e jetesës për popullsinë e anketuar, të cilët gjinden në kushte më të këqija ekonomike sesa popullsia e përgjithshme e Kosovës, me shkallë më të lartë të papunësisë dhe të ardhura më të ulëta mujore. Grafiku i mëposhtëm paraqet një pasqyrë të normave të papunësisë dhe përqindjeve të individëve të ardhurat mujore të të cilave janë nën mesatare më të ulët të Kosovës (300⁵⁸ euro).

58 Anketa e Fuqisë Punëtore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Pavarësisht dallimeve të konsiderueshme në të gjitha grupet e popullsisë, të gjitha normat e papunësisë janë shumë më të larta se mesatarja e Kosovës (27.5%⁵⁹), veçanërisht në mesin e PZHBV romë/ashkali/egjiptianë. Ngjashëm, përqindjet e të anketuarve që raportojnë se fitojnë 300 euro në muaj ose më pak e tejkalojnë mesataren e Kosovës (38.3% në mesin e meshkujve dhe 37.2% në mesin e femrave⁶⁰), që përfaqësojnë të paktën

59 Anketa e Fuqisë Punëtore 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

60 Anketa e Fuqisë Punëtore 2015, Agjencia e Statistikave të Kosovës - të dhënat e krahasueshme nuk përfshihen në Anketën e Fuqisë Punëtore 2016.




Figura 39: Shkalla e papunësisë e individëve të anketuar (përqindja e personave të papunë jashtë fuqisë punëtore totale) - N tregon numrin e personave të papunë




Figura 40: Përqindja e individëve të punësuar që fitojnë deri në 300 euro në muaj - N tregon numrin total të punësuarve

gjysmën e të anketuarve në të gjitha grupet, duke qenë mbi dy herë më e lartë se mesatarja e Kosovës në grupin e PZHBV serb në qendrat kolektive, dhe që karakterizojnë pothuajse tërësinë e të anketuarve në grupin rom/ashkali/egjiptian.

Cenueshmëria ekonomike e popullsisë së anketuar të zhvendosur brenda vendit gjithashtu është theksuar nga përmasa e ekonomive familjare që raportojnë se mbështeten nga përfitimet sociale si burim kryesor i të ardhurave dhe atyre që kanë raportuar se nuk kanë ndonjë anëtar të punësuar, siç përmbledhet në grafikun më poshtë.

Përqindjet e familjeve të PZHBV të cilët mbështeten në ndihmat sociale si burimi kryesor i të ardhurave janë të gjitha më të larta se përqindja e popullsisë së përgjithshme në Kosovë (4%)⁶¹, me më të ultën dy herë më të madhe sipas krahasimit, dhe është vërejtur një mbështetje për popullsinë rome/ashkali/egjiptiane. Vlen të theksohet se nuk vërejtur mbështetje nga remitancat në mesin e familjeve të zhvendosura brenda vendit, kundrejt një mesatare në Kosovë prej 8%.

Përkundër mungesës së një termi mbi krahasimin e ekonomive familjare që kanë raportuar se nuk kanë persona të punësuar në mesin e anëtarëve të tyre, përqindjet janë veçanërisht më të larta në mesin e

61 Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2016, Agjencia e Statistikave të Kosovës.

popullatës rome/ashkali/egjiptiane dhe PZHBV serbë që banojnë në qendrat kolektive (mosha mesatare më e lartë në këtë grup duhet të merret parasysh).

Të gjitha të gjeturat mbi situatën ekonomike tregojnë një nivel të lartë të pasigurisë të përjetuar nga një pjesë e konsiderueshme e popullsisë të anketuar të zhvendosur, dhe veçanërisht nga grupi romë/ashkali/egjiptian. Përqindjet e individëve në këtë grup që raportojnë se janë në punësim me orar të plotë dhe me një kontratë me shkrim janë shumë më të ulëta se ato në mesin e grupeve të tjera të synuara. Në anën tjetër, një përqindje shumë më e lartë e individëve romë/ashkali/egjiptianë janë të angazhuar në punësim të parregullt. Vlen gjithashtu të theksohet se, ndonëse nuk është mbledhur asnjë informatë në këtë kuptim, një rishikim i burimeve dytësore të informatave zbulon se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së anketuar të zhvendosur brenda vendit mbështetet në burime më pak të qëndrueshme të të ardhurave, siç janë përfitimet sociale, pagat për punësimin publik dhe paga minimale për punonjësit e ish-ndërmarrjeve shtetërore të ndërlidhura me Serbinë. Kjo e prek veçanërisht popullsinë serbe, por besohet të ketë lidhje edhe me grupe të tjera.




Figura 41: Cenueshmëria ekonomike e ekonomive familjare të anketuara (EF) sipas mbështetjes së përfitimeve sociale dhe mospunësimit të anëtarëve - N tregon numrin total të ekonomive familjare në mostër

Kushtet e jetesës

Të dhënat e mëposhtme mbi zgjidhjet aktuale të akomodimit kontribuojnë në nxjerrjen në pah të cenueshmërisë së popullatës të anketuar të zhvendosur brenda vendit.

Duke marrë parasysh familjet që nuk u gjetën në shtëpi individuale ose apartamente mund të paraqet cenueshmërinë e individëve të vendosur sipas zgjidhjeve më pak të qëndrueshme dhe adekuate, siç janë qendrat kolektive, vendbanimet joformale dhe strehimore të improvizuara.

Në 217 e ekonomive familjare që nuk banojnë në shtëpi individuale ose apartamente kryesisht përfshijnë të gjithë popullsinë e anketuar të PZHBV serbë në qendrat kolektive, por një numër i ekonomive familjare nga secili grup tjetër i synuar gjithashtu bien në të njëjtën kategori, me një përqindje të dukshme afër 20% në mesin e PZHBV romë/ashkali/egjiptianë.

Nëse shiqojmë ekonomitë familjare që raportojnë se nuk zotërojnë dhe nuk marrin me qira vendbanimin e tyre të tanishëm na ndihmon të kuptojmë sfidat me të cilat ballafaqohet popullsia e zhvendosur brenda vendit në aspektin e aftësisë së tyre për të përmbushur nevojat e tyre themelore, siç janë kostot që lidhen me akomodimin. Duket se, në kohën e anketimit, një numër i konsiderueshëm u akomodua falas, u vendosën në banesa sociale, ose kishin okupuar akomodimin e tyre. Duhet të theksohet se, ndërkohë që kjo ndikon në ekonomitë familjare në të gjitha grupet e popullsisë, kjo gjë bëhet në nivele shumë të ndryshme, me totalin e PZHBV të intervistuar serb në qendrat kolektive që bien në këtë kategori së bashku me mbi 40% të PZHBV-ve romë/ashkali/egjiptianë dhe PZHBV serbë në strehim privat, ndërkohë që përqindja në mesin e PZHBV shqiptarë është dukshëm më e ulët.




Figura 42: Cenueshmëria e strehimit të ekonomive familjare (EF) të anketuara sipas llojit të banimit dhe kushteve të mbajtjes - N tregon numrin e përgjithshëm të familjeve në mostër.

Vini re që të gjitha ekonomitë familjare në qendrat kolektive nuk posedojnë vendbanim e as nuk kanë vendbanim me qira, dhe 1% që mungon nga totali ka më shumë gjasa që t'i atribuohet një gabimi në mbledhjen e të dhënave.

Nga këto 507 ekonomi familjare:

- ▶ 126 ekonomi familjare raportuan që nuk kanë asnjë anëtar të punësuar. Ata përfaqësojnë 16% të popullsisë shqiptare, 21% të popullsisë rome/ashkali/egjiptiane, 18% të popullatës serbe në banesa private dhe 41% të popullsisë serbe në qendra kolektive (ku mosha mesatare e përgjithshme kontribuon në shpjegimin e kësaj) që i përkasin kësaj kategorisë.
- ▶ 145 ekonomi familjare raportuan që mbështeten kryesisht në ndihmat sociale si një burim të ardhurash. Ato përfaqësojnë 22% të popullsisë shqiptare, 68% të popullsisë rome/ashkali/egjiptiane, 20% të popullsisë serbe në banesa private dhe 28% të popullsisë serbe në qendra kolektive (ku mosha mesatare e përgjithshme kontribuon në shpjegimin e kësaj) që bien në këtë kategori.
- ▶ 173 ekonomi familjare raportuan se kanë fituar më pak se 300 euro në muaj. Ndër familjet që kanë raportuar të paktën një anëtar të punësuar, ato përfaqësojnë 29% të popullsisë shqiptare, 20% të popullsisë rome/ashkali/egjiptiane, 42% të popullsisë serbe në banesa private dhe 23% të popullatës serbe në qendra kolektive.

Përveç kësaj, mungesa e qasjes në shërbimet themelore (si uji i pijshëm dhe energjia elektrike) dhe infrastruktura (si sistemet e ngrohjes dhe kanalizimit) janë vërejtur në disa raste. Trendi aplikohet për të gjitha grupet e popullsisë, megjithëse në nivele të ndryshme, siç përmbledhet në grafikun më poshtë:

Mungesa e ujit të rrjedhshëm, energjisë elektrike dhe sistemit të kanalizimit i afektojnë të gjitha grupet. Sfidat më të mëdha për të gjitha grupet paraqiten në lidhje me sistemin e kanalizimit dhe ndikojnë veçanërisht PZHBV romë / ashkalinjë / egjiptianë dhe PZHBV serbë në qendrat kolektive. Vetëm PZHBV romë / ashkalinjë / egjiptian kanë një pjesë të ekonomive familjare në secilën prej tre grupeve të paraqitura më sipër dhe, me përjashtim të pjesës së ekonomive familjare që nuk kanë ujë të rrjedhshëm, përqindjet janë më të larta se tek popullatat e tjera, të dy faktorët tregojnë për cenueshmërinë e përgjithshme të kësaj popullate.




Figura 43: Ekonomitë Familjare të anketuara (EF) përmes qasjes në infrastrukturën dhe shërbimet bazë të banimit - N tregon numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare në mostër

Qasja në pronë në vendin e origjinës

Qasja në pronë në vendin e origjinës është hulumtuar për të gjitha ekonomitë familjare të zhvendosura brenda vendit, pavarësisht nga preferencat e tyre për vendndodhjen e zgjidhjes së qëndrueshme. Tabela në vijim përmbledh të dhënat e mbledhura mbi pronësinë dhe sfidat në qasjen e saj.

Siç mund të vërehet, pamvarësisht nga ekonomitë familjare të cilët kanë një ose më shumë prona në vendin e origjinës, qasja pengohet nga disa faktorë.

Nga njëra anë, përqindjet e kërkesave për riposedim të pronave janë jashtëzakonisht të ulëta. Ndërsa përqindjet e ekonomive familjare në grupet e ndryshme të synuara që kanë raportuar se kanë paraqitur kërkesë ndryshojnë, ata të gjithë tregojnë sfida gjatë këtij procesi. Këto mund t'i atribuohen vetëm pjesërisht pengesave me të cilat ballafaqohet pjesa e ekonomive familjare që kanë raportuar se nuk posedojnë dokumentet e pronësisë (veçanërisht në grupet rom/ashkali/egjiptiane) - i cili faktor, në asnjë rast, nuk duhet të parandalojë përpjekjet për të rifituar qasjen e pronës së vet.

Nga ana tjetër, pronat që janë raportuar si të uzurpuara

ose të dëmtuara janë të konsiderueshme. Në përgjithësi, 928 ekonomi familjare në mostër raportuan 530 prona të uzurpuara dhe 801 prona të shkatërruara ose të dëmtuara dhe ende të rindërtuara/riparuara në kohën e intervistës. Siç mund të vërehet, me përjashtim të grupit rom/ashkali/egjiptian (për të cilin përqindja e ekonomive familjare që posedojnë prona në vendin e origjinës është shumë i vogël për t'u analizuar më tej sipas kushteve të pronës në fjalë), qasja në venbanim në vendin e origjinës për përafërsisht gjysmën e secilës grup të popullsisë nuk mundësohet për shkak të shkatërrimit ose dëmtimit të shtëpisë. Përqindjet e ekonomive familjare, qasja e të cilëve pengohet nga okupimi i paligjshëm janë të ngjashme me PZHBV shqiptarë dhe me PZHBV serbë në qendrat kolektive, ndërkohë që pothuajse tre të katërtat e popullsisë serbe të PZHBV në strehim privat janë të prekur.

	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar pronën në vendin e origjinës (nga grupi i përgjithshëm i mostrës)	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar se posedojnë dokumentet e pronësisë (ata që posedojnë prona)	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar se kanë paraqitur kërkesën e riposedimit (ata që posedojnë prona)	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar se kërkesa e tyre është zgjidhur (ata që paraqesin kërkesë)	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar se pasuria e tyre është okupuar (ata që posedojnë pronë)	Përqindja e EF të cilët kanë raportuar se prona është shkatërruar / dëmtuar (ata që posedojnë prona)
PZHBV Shqiptar N=502	83%	93%	34%	11%	39%	50%
PZHBV Rom/Ashkali/Egjiptian N = 123	31%	45%	3%	/	/	
PZHBV Serb në BP N=567	72%	93%	68%	4%	74%	50%
PZHBV Serb në QK N=134	47%	86%	33%	7%	44%	48%

Tabela 40: Ekonomitë familjare të anketuara (EF) me posedimin dhe qasjen në pronë në vend të origjinës - N tregon numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare në mostër

REKOMANDIMET

Profilizimi i PZHBV në Kosovë përbënte përpjekjen e parë të madhe për të trajtuar në mënyrë sistematike sfidat që rrjedhin nga zhvendosja e brendshme. Angazhimi që ka çuar drejt zbatimit të tij duhet të vazhdojë, dhe momenti i ndërtuar përmes qasjes pjesëmarrëse të miratuar nga të gjitha palët e interesuara duhet të kapitalizohet. Prandaj, duhet të jetë prioritet për të gjithë përgjegjësit – duke përfshirë autoritetet qeveritare, komunitetin e donatorëve dhe organizatat ndërkombëtare joqeveritare aktive në mbështetjen e arritjes së zgjidhjeve të qëndrueshme – për të planifikuar një përpjekje të përbashkët për të zgjidhur situatën e zgjatur të zhvendosjes me të cilën ballafaqohen PZHBV në Kosovë. n ballafaqohen PZHBV në Kosovë.

Kjo kërkon këto më poshtë:

1. Informimi i saktë mbi të gjitha ekonomitë familjare të PZHBV-ve në nivel qendror dhe komunal, në mënyrë që ndërhyrjet të mund të dizajnohen në mënyrë të përshtatshme sipas nevojave aktuale, dobësive, preferencave individuale dhe kontekstin specifik. Ky hap i parë është thelbësor për zhvillimin e një platforme programore të tërësishme dhe të bazuar në dëshmi, e cila do të mundësojë optimizimin e burimeve, priorizimin e bazuar në dobësi, efikasitet dhe efektivitet – të gjitha këto janë çelës për zgjidhjen e qëndrueshme dhe politikave përkatëse. Këto të dhëna gjithëpërfshirëse për PZHBV-të në Kosovë do të duhet të tejkalojnë vlerësimet e përgjithshme të vendosura para implementimit të profilizimit dhe tendencat që ushtrimi i theksoi, në mënyrë që të përfshihen në tiparet specifike në çdo ekonomi familjare dhe të përshtasin mbështetjen e nevojshme bazuar në to si dhe në vendin e zgjedhur si vendbanim i përhershëm. Si rezultat, autoritetet qendrore dhe lokale do të përfitojnë nga krijimi i një sistemi të menaxhimit të të dhënave.

2. Hartimi në kohë nga MKK i Strategjisë për Komunitete dhe Kthim për periudhën 2019—2023, dhe përfshirja e seksioneve të fokusuara veçanërisht në zhvendosjen e brendshme. Këto seksione duhet të përfshijnë:

- ▶ Mundësitë e kthimit në vendin e origjinës, duke u integruar në vendin e zhvendosjes, dhe rivendosjen në një vend tjetër përveç vendit të zhvendosjes në Kosovë;
- ▶ Masat për sigurimin e qasjes në pronë për të gjithë PZHBV-të, përfshirë ata që dëshirojnë të integrohen në vendin e zhvendosjes;
- ▶ Masat për të siguruar krijimin e një mjedisi të favorshëm për kthim, integrimin lokal ose zhvendosjen e

PZHBV;

- ▶ Masat për të mbështetur mbylljen e çdo sfide arsimore ose të lidhur me jetesën me të cilën ballafaqohen PZHBV si pasojë e zhvendosjes së zgjatur;
- ▶ Masat për të mbështetur familjet dhe individët më të prekshëm të PZHBV.

3. Miratimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës në qasjen në temën e zgjidhjeve të qëndrueshme (në Strategjinë në fjalë dhe në çdo dokument tjetër zyrtar) për të llogaritur plotësisht synimet dhe nevojat e të zhvendosurve, preferencat e komuniteteve që presin, si dhe për kontekstin aktual politik dhe socio-ekonomik, duke përfshirë një analizë të riskut të zhvillimeve të mundshme përkatëse. Përveç lehtësimit të qasjes në një zgjidhje të përshtatshme akomodimi të lidhur me zgjedhjen e kthimit ose integrimin lokal, mbështetja në lidhje me mjetet e jetesës, qasja në shërbime dhe të drejta, kujdesi shëndetësor dhe arsimit duhet të përfshihen në hartimin e një sistemi fleksibil. Kjo do të lejojë përshtatjen e asistencës për nevoja dhe kontekst ekzistues, duke siguruar maksimizimin e rezultateve dhe parandalimin e alokimit të pavend të burimeve.

